



Komisioneri për Mbrojtjen
nga Diskriminimi

Commissioner for Protection
from Discrimination

KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

PËRMBLEDHJE E VENDIMEVE TË KOMISIONERIT PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Me mbështetjen e:



Empowered lives.
Resilient nations.

Ky botim është realizuar me mbështetjen e Kombeve të Bashkuara në Shqipëri, Programit të Kombeve të Bashkuara për Zhvillim në Shqipëri dhe Qeverisë Suedeze, në zbatim të Projektit “Zbatimi i parimit të barazisë gjinore dhe programit të dhunës me bazë gjinore”

Pregatitën materialin:

Irma Baraku	Komisionere
Vilfrida Bushati	Drejtoreshë në Drejtorinë e Hetim-Inspektimit
Artan Xhindi	Inspektori në Drejtorinë e Hetim-Inspektimit
Enejda Shyti	Inspektore në Drejtorinë e Hetim-Inspektimit
Rudina Hoxha	Inspektore në Drejtorinë e Hetim-Inspektimit
Rigert Babaj	Inspektori në Drejtorinë e Hetim-Inspektimit
Klodiana Kamberaj	Specialiste në Drejtorinë e Çështjeve Procedurale Ligjore dhe Marrëdhënieve me Jashtë
Kalirro Martiko	Specialiste në Drejtorinë e Çështjeve Procedurale Ligjore dhe Marrëdhënieve me Jashtë
Amarda Çoku	Specialiste në Drejtorinë e Çështjeve Procedurale Ligjore dhe Marrëdhënieve me Jashtë

Varianti anglisht u përgatit nga:

Jola Haxhistasa	Përkthyes
Blerina Pirani	Specialiste në Drejtorinë e Çështjeve Procedurale Ligjore dhe Marrëdhënieve me Jashtë

Opinionet e përfshira në këtë botim u përgatitën nga Bordi i Ekspertëve pranë KMD-së:


Prof.Dr. Arta Mandro	Pedagoge në Shkollën e Magjistraturës
Prof.Asoc.Evis Alimehmeti	Pedagoge në Fakultetin e Drejtësisë në Universitetin e Tiranës
Dr.Entela Hoxhaj	Pedagoge në Fakultetin e Drejtësisë në Universitetin e Shkodrës
	"Luigj Gurakuqi"

ISBN:978-9928-4169-9-9

Shtypur nga “Albania”

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi
Informacion mbi institucionin mund të gjeni në internet

Tiranë, 2014



KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGË DISKRIMINIMI

PËRMBLEDHJE E VENDIMEVETË KOMISIONERIT PËR MBROJTJEN NGË DISKRIMINIMI

Me mbështetjen e:



PËRMBAJTJA

I. ÇËSHTJE TË DISKRIMINIMIT PËR SHKAK TË GJINISË.

I.1. Ankesa e znj. S.Ç. ankesën kundër z. A.K, Drejtor Ekzekutiv i Fondacionit “Harry Fultz” dhe znj. B. B Drejtoreshë e Shkollës Teknike “Harry Fultz”, ku pretendohet për diskriminim për shkak të gjinisë si dhe për shkak të denoncimit nga ana e saj të drejtuesve të shkollës për afëra korruptive (Vendim Nr. 11/ 2012).....7

II. ÇËSHTJE TË DISKRIMINIMIT PËR SHKAK TË AFTËSISË SË KUFIZUAR.

II.1. Çështje ex-officio, iniciuar nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, mbi bazën e publikimeve të bëra në media, me informacionin e marrë nga gazeta Shqiptarja.com, e datës 18.09.2013, ku pretendohet për diskriminim të nxënësës së klasës së parë të Liceut Artistik “Jan Kukuzeli”, për shkak se është prekur nga autizmi (Vendimi Nr.92/25.09.2013).....12

II.2. Ankesa e Znj. H.H. paraqitur pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, kundër Drejtorit të Konvikteve të Shkollave të Mesme Tiranë për ndërprerjen e marrëdhënieve të punës nga punëdhënësi, për shkak të shoqërimit të të birit, kujdesi i të cilit është siguruar kryesisht nga punëmarrësi (Vendim nr. 54/2014).....20

III. ÇËSHTJE TË DISKRIMINIMIT PËR SHKAK TË ORIENTIMIT SEKSUAL.

III.1. Ankesa e z. V.N, në të cilën pretendohet për diskriminim për shkak të orientimit seksual, nga Televizionet “News-24”, “ABC News” si dhe gazetat “Panorama”, “Shqiptarja.Com” dhe “Koha Jonë” (Vendim Nr. 97/2013).....23

IV. ÇËSHTJE TË DISKRIMINIMIT PËR SHKAK TË ETNISË, RACËS, GJUHËS.

IV.1. Çështja ex-officio “për monitorimin e shpërndarjes së nxënësve rom në shkollat 9-vjeçare në Tiranë” (Vendim Nr. 95/2013).....30

V. ÇËSHTJE TË DISKRIMINIMIT PËR SHKAK TË BINDJEVE POLITIKE.

V.1. Ankesa e paraqitur nga subjekti V.M kundër subjektit publik Drejtoria e Shëndetit Publik Mat, në të cilën pretendohet për diskriminim për shkak të “Bindjes Politike” në fushën e punësimit (Vendimi Nr. 140 / 2014).....34

VI. ÇËSHTJE TË DISKRIMINIMIT PËR SHKAK TË BINDJEVE FETARE.

VI.1. Çështje ex-officio, iniciuar nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, mbi bazën e publikimeve të bëra në Gazetën Shqiptare, të datës 06.06.2013, në artikullin me titull “*Mjekja refuzon të punojë me infermieren me shami në kokë*” (Vendim Nr. 86/2013).....37

VII. ÇËSHTJE TË DISKRIMINIMIT NË FUSHËN E ARSIMIT.

VII.1. Ankesën e bërë nga Ambasada PINK/LGBT PRO Shqipëri kundër autorëve të librit “Mjekësia Ligjore”, z. S.M. dhe z. B.Ç. në të cilën pretendohet se tekstet universitare diskriminojnë dhe paragjykojnë hapur komunitetin LGBT në Shqipëri (Vendim Nr. 27/2012).....43

VIII. ÇËSHTJE TË DISKRIMINIMIT NË FUSHËN E PUNËSIMIT.

VIII.1. Ankesa e znj. F. K. kundër z. A.Sh, Drejtor, Drejtoria Rajonale Shëndetësore Fier, ku pretendohet për diskriminim në punësim për shkak të gjendjes arsimore, gjendjes shëndetësore dhe çdo shkak tjetër (Vendim Nr.13/2012).....47

IX. ÇËSHTJE TË DISKRIMINIMIT NË FUSHËN E TË MIRAVE DHE SHËRBIMEVE.

IX.1. Ankesa e paraqitur nga organizata “Aleanca Kundër Diskriminimit LGBT” kundër subjektit privat Restorant Pizzeri “K” për pretendimin për diskriminim për shkak të orientimit seksual në fushën e të mirave dhe shërbimeve (Vendimi Nr. 5 / 2014).....53

IX.2. Çështje ex-officio, e iniciuar nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, mbi bazën e publikimeve të bëra në media, mbi ankesat e disa grave të strehuara në Qendrën Kombëtare të Trajtimit të Viktimave të Dhunës në Familje (Vendim Nr. 9/2012).....56

X. OPINIONE TË BORDIT TË EKSPERTËVE

X.1. Opinion i Bordit të Ekspertëve për kërkesën e GJK ndaj KMD për një koment me shkrim lidhur me kërkesën e KKPak dhe Shoqatës së të Verbërve të Shqipërisë me objekt: “Deklarimin si të papajtueshëm me Kushtetutën, Konventën e OKB “Për të drejtat e personave me aftësi të kufizuara”, KEDNJ dhe Kartën Sociale Europiane i pikave 7 dhe 9 të nenit 3 të Ligjit nr. 10221/04.02.2010 “Për mbrojtjen nga Diskriminimi”61

X.2. Opinion i Bordit të Ekspertëve për trajtimin e ankesës së shtetasës A.Ç., kundër CEZ Shpërndarje sh.a. në të cilën pretendohet diskriminim për shkak të gjinisë, shtatzënisë, gjendjes martesore dhe gjendjes civile.....69

HYRJE

Në shkurt të vitit 2010 është miratuar nga Parlamenti i Republikës së Shqipërisë Ligji “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”. Ky ligj synon të garantojë ndihmë për viktimat e diskriminimit. Ligji “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi” parashikon disa mundësi për tu mbrojtur nga sjelljet diskriminuese, duke shfrytëzuar instrumente e struktura të ndryshme ligjore dhe institucionale. Ai parashikon mbrojtjen nga sjelljet diskriminuese pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi dhe trajtimin e çështjeve të diskriminimit në gjykatë si rrugët më efikase për tu ndjekur. Pavarësisht mjeteve ligjore që viktima e sjelljes diskriminuese përdor, është e rëndësishme që institucionet që e trajtojnë çështjen të njohin mirë legjislacionin në fuqi, të dinë të evidentojnë elementet që ka një sjellje diskriminuese në çështjen që shqyrtojnë, në mënyrë që të japin një vendim apo zgjidhje ligjore me një nivel të lartë profesionalizmi. Duke qenë se në Shqipëri kemi të bëjmë me zbatimin e një ligji të ri dhe në mungesë të një praktike ligjore administrative dhe gjyqësore, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi ka mbajtur parasysh aktet ndërkombëtare të ratifikuara me ligj dhe në mënyrë të veçantë jurisprudencën e mekanizmave ndërkombëtare që sigurojnë zbatimin e këtyre akteve.

Duke qenë se trajtimi i çështjeve të diskriminimit përfshin aktorë të ndryshëm si: stafin e KMD-së, përfaqësues të institucioneve qendrore e vendore, përfaqësues të OJF-ve, prokurorë e gjyqtarë, e çmuam të rëndësishëm realizimin e botimit të një përmbledhjeje të vendimeve të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi dhe Opinione të Bordit të Ekspertëve.

Disa nga vendimet e KMD, sipas fushave dhe shkaqeve të ndryshme për të cilat garantohet mbrojtje në ligj, janë përzgjedhur për këtë botim si vendimet më kyçe tek të cilat është bazuar edhe për raste të tjera analoge vendimmarrja e Komisionerit, duke krijuar në këtë mënyrë një praktikë administrative të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi.

Gjatë vitit 2013, veprimtaria e KMD është asistuar nga një Bord Ekspertësh i përberë nga pesë ekspertë të fushës së mbrojtjes së të drejtave të njeriut, të cilët kanë hartuar opinione për KMD, sipas rasteve specifike në shqyrtim dhe që kërkonin një ekspertizë më të kualifikuar. Këto opinione kanë ndikuar në marrjen e vendimeve të kualifikuara dhe me profesionalizëm nga Komisioneri dhe krijimin e një praktike të konsoliduar për çështje të tjera analoge.

Falenderojmë UNDP dhe veçanërisht Znj. Entela Lako (Oficere programi) dhe Znj. Emira Shkurti (Koordinatorë) e Programit “Barazia gjinore dhe dhuna me bazë gjinore” që na kanë mbështetur në realizimin e veprimtarisë së Bordit të Ekspertëve, por edhe të këtij botimi në kuadër të një bashkëpunimi më të gjërë.

Irma Baraku
Komisionere për Mbrojtjen nga Diskriminimi
Dhjetor 2014



ÇËSHTJE TË DISKRIMINIMIT PËR SHKAK TË GJINISË

ANKESA E ZNJ. S.Ç., KUNDËR Z. A.K, DREJTOR EKZEKUTIV I FONDACIONIT
 “HARRY FULTZ” DHE ZNJ. B. B. DREJTORESHË E
 SHKOLLËS TEKNIKE “HARRY FULTZ”, KU PRETENDOHET PËR DISKRIMINIM
 PËR SHKAK TË GJINISË SI DHE PËR SHKAK TË DENOCIMIT NGA ANA E SAJ
 TË DREJTUESVE TË SHKOLLËS PËR AFERA KORRUPTIVE.

VENDIM Nr. 11/ 2012

1. PROCEDURA E NDJEKUR

- 1.1** Znj. S.Ç ka paraqitur pranë Zyrës së Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ankesën nr. 16, datë 14.11.2011, kundër z. A.K, Drejtor Ekzekutiv i Fondacionit “Harry Fultz” dhe znj. B.B. Drejtoreshë e Shkollës Teknike “Harry Fultz”, ku pretendohet për diskriminim për shkak të gjinisë si dhe për shkak të denoncimit nga ana e saj të drejtuesve të shkollës për afera korruptive. Sipas shpjegimeve të dhëna rezulton se znj.S.Ç. ushtron profesionin e mësueses së anglishtes në shkollën teknike “Harry Fultz. Ankuesja shprehet se ka bërë denoncime së bashku me bashkëshortin e saj për afera korruptive në këtë shkollë që, sipas saj është shkollë shtetërore dhe trajtohet si shkollë private nga drejtuesit e shkollës. Ankuesja solli para Komisionerit një sërë shkresash drejtuar institucioneve më të larta shtetërore si: Kryeministrit të Republikës së Shqipërisë, Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Drejtores së Drejtorisë Arsimore Rajonale të Qytetit, Tiranë.
- 1.2** Për shkak të këtyre qëndrimeve, ankuesja pretendon se diskriminohet me mënyra të ndryshme.
- Është nën një diskriminim të vazhdueshëm, nëpërmjet dhunës psikologjike të përditshme, fjalëve ofenduese, përhapjes së informacioneve disinformuese me qëllim dëmtimin e imazhit të saj në kolektiv dhe tek nxënësit, nga ana e drejtoreshës së shkollës;
 - Është përjashtuar nga aktivitetet që kryen trupa mësimore, nuk ka përfituar shtesë në page, ndryshe nga pjesa tjetër e mësuesve, nuk përfiton orët shtesë në mësimdhënie ndryshe nga sa ndodh me pjesën tjetër të mësuesve.

- Ankuesja nuk është paguar si pjesëmarrëse me urdhër të Ministri të Arsimit dhe Shkencës, për pesë ditë në korigjimët e provimeve të maturës shtetërore ndryshe nga mësuesit e tjerët në të njëjtën situatë me të sajën.
- Ankuesja ngre pretendimin se shqetësimet dhe sjelljet diskriminuese ushtrohen edhe ndaj djalit të saj, i cili është nxënës në këtë shkollë në vitin e pestë. Sjelljet diskriminuese ndaj tij konsistojnë në faktin se nuk i janë nxjerrë në kohë si nxënësve të tjerë rezultatet e provimeve, nuk i lëshohet dëftesa e vitit të katërt apo provokohet me qëllim nxitjen e tij për kryerjen e veprimeve të caktuara për përjashtimin e tij nga shkolla.
- I është dhënë masë disiplinore në kundërshtim me Rregulloren e Menaxhimit të Stafit, për të cilën ka paraqitur observacionin pranë drejtorisë së shkollës dhe nuk ka marrë asnjë përgjigje nga ana e tyre.

- 1.3** Në zbatim të nenit 32 dhe 33, të ligjit nr.10 221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, me datën 10/11/2011, është bërë njoftimi i z. A. K dhe znj B.B në lidhje me ankesën e drejtuar ndaj tyre me pretendimin për diskriminim të znj S.Ç. Me datën 25/11/2011 me shkresë nr. Prot 197, drejtuar znj. B.B. është kërkuar informacion në lidhje me pretendimin e Znj. S. Ç. Me datë 21/12/2011, u mbajt një takim nga inspektorët e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi me znj. S.Ç. dhe bashkëshortin e ankueses.
- 1.4** Me shkresë nr.2 datë 06/01/2012 të Komisionerit, u bë njoftimi i palëve për seancë dëgjimore. Me datë 16/02/2012 pranë zyrës së Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi u paraqiten znj. V.B. dhe znj. V.C. të autorizuar nga z. A. K. Në cilësinë e bashkëshortit, z. F. Ç, pretendonte të përfaqësonte bashkëshorten e tij në mungesë për arsye se kishte mbledhje të këshillit pedagogjik në shkollë. Seanca u shty për shkak se z.F.Ç. nuk kishte prokurë të posaçme për të përfaqësuar znj. S.Ç. Me konsensusin e të dyja palëve seanca u zhvillua me datën 23/02/2012.
- 1.5** Me datën 08/05/2012 me shkresë nr prot. 170, drejtuar znj B.B. iu kërkuar informacion shtesë mbi pagesat e punonjësve, në përgjigje të së cilës është dërguar shkresa nr.451 dt.15.5.2012, ku theksohet se: “Për sa i përket listë-pagesave të personelit, siç ju kemi vënë në dijeni ky informacion ka karakter konfidencial dhe mbrohet si e dhënë personale e individit nga ligji 9887 datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”.
- 1.6** Me datën 21/05/2012, lëshohet Urdhëri nr. 27 për kryerjen e inspektimit pranë shkollës teknike “Harry Fultz” me objekt “*verifikimi i fakteve si më poshtë*”: 1.Verifikimin e listëpagesave të personelit në shkollën teknike “Harry Fultz” për periudhën 2010 dhe në vazhdim. 2. Bazën ligjore mbi të cilën bëhen pagesat e mësuesve, praktikën që ndiqet për vlerësimin e mësuesve, praktikën që ndiqet për rritjen e pagave të mësuesve. 3.Vlerësimet e performancës së znj. S.Ç për periudhën 2009-2010.

2. FAKTE TË KONSTATUARA

- 2.1** Përfaqësuesi i subjektit të kontrolluar gjatë inspektimit u shpreh se kërkesa e ankueses është abuzive. Lidhur me pretendimin e ankueses për rritje page, ato vlerësuan se kjo varet nga performanca individuale dhe politikat e institucionit. Lidhur me mospagesën e ditëve si vlerësuese në provimet e maturës shtetërore, drejtuesit shpjeguan se nuk kishte marrë leje dhe si pasojë i janë hequr ditët e punës. Znj.S. Ç. është vënë në dijeni për vërejtjen e dhënë brenda afateve ligjore. Lidhur me pretendimin për mosdhënien e dëftesës djalit të ankueses, u shprehën se diploma do t’i jepet sapo të bëjë pagesën e plotë të tarifës së shkollës.

- 2.2 Duke krahasuar vlerësimet e 2010-2011 të znj. S.Ç. me mësuesit R. M., A. D., formulari i vlerësimit i znj S.Ç. rezultoi i plotësuar ndryshe. Në formularin e znj S.Ç. nuk ka vlerësim me pikë nga 1-4 sipas rregullit, por kutitë janë bosh dhe në fletën e fundit bëhet një vlerësim me shkrim për mësuesen duke evidentuar faktin që *“stafi drejtues nuk ka mundur të vlerësojë mësuesen pasi ajo refuzon çdo element vlerësimi”*, gjë që bie në kundërshtim të plotë me procedurën e rregullores së menaxhimit të stafit. *Kujtojmë këtu se rregullorja parashikon se vlerësimi duhet të bazohet edhe në tërheqjen e mendimeve të nxënësve.*
- 2.3 Në vlerësimet për vitin 2010-2011 vërejmë: *“Refuzon të kryejë të gjitha detyrimet e mësuesit kujdestar ndaj prindit si telefonata e njoftime” (2010-2011); “...Në ambiente publike, Këshill pedagogjik, sallë mësuesish e klasë sjellja e saj është fyese e denigruese në adresë të stafit menaxhues”(2010-2011).* Ndërkohë gjejmë vlerësimet e mëparshme si: *“Ka frymën e bashkëpunimit në department dhe ruan marrëdhënie korrekte me kolegët dhe eprorët”(2004-2005); “Ka punuar me përkujdesjen e duhur me klasën kujdestare dhe dokumentacionin shkollor”(2004-2005).* Ndërsa në vlerësimin për vitin 2007-2008 mësuesja vlerësohet me notën 1 ose 2 për të gjithë komponentët e procesit mësimor edukativ.
- 2.4 Me dt.16 Mars 2011 me shkresë nr.prot.392, B.B., drejtore e shkollës “Harry Fultz”, L.N. zv/drejtore dhe D.T., shefe e departamentit, i kanë propozuar Drejtorit të Përgjithshëm z. A.K. masë disiplinore “vërejtje me shkrim” për mësuesen me argumentet:
- Nga data 06.09.2010 zhvillon mësim pa përparësi në kundërshtim me rregulloren e brendshme të Institutit dhe Udhëzimit përkatës nga MASH, për paraqitjen e personelit të shkollës në mjediset shkollore.
 - Refuzon të punojë me nxënësit e talentuar (klubet) dhe të konsultojë nxënësit e dobët brenda orarit të kontratës prej 40 orë pune të firmosur prej saj.
 - Ka vënë në vështirësi dhe ka penguar në mënyrë të përsëritur e publike Ekipin Menaxhues të Shkollës të zhvillojë detyrën funksionale që ka.
- 2.5 Me datë 17 Mars 2011 z.A.K ka firmosur vërejtjen me shkrim për znj. S. Ç. Vërejtja disiplinore daton pas mbledhjes së këshillit pedagogjik me temë “Analiza e semestrit të parë”, dt.16 shkurt 2011, ku pati një debat me znj.S.Ç. dhe drejtoreshën e shkollës. Në këtë debat znj. S.Ç., ka kërkuar nga drejtoresha të shpjegojë nëse shkolla është publike apo private dhe si pasojë drejtoresha ka mbyllur mbledhjen.
- 2.6 **Në observacionin e znj. S.Ç., dt.21 Mars 2011, mbi dhënien e masës disiplinore, përveç kundërshtive lidhur me argumentet e dhënies së vërejtjes është paraqitur ankesa dhe shqetësimi i saj se po diskriminohet nga drejtuesit e shkollës përmes¹:** *mossigurimit të bazës materiale didaktike për zhvillimin e mësimin dhe infrastrukturën e nevojshme ashtu si edhe mësuesve të tjerë; përjashtimin nga çdo aktivitet që mësuesit e tjerë e zhvillojnë edhe në orën e mësimin; izolimit nga çdo lloj informacioni i shkollës; heqja e së drejtës së fjalës në takimet me trupën mësimore...etj.*
- 2.7 Gjithashtu ankuesja, në observacion kërkon të dëgjohet nga bordi i fondacionit sipas legjislacionit që rregullon funksionimin e fondacionit si dhe Kodit të Punës neni 10/1 ku cilësohet: ***“çdo mase ose sanksion administrativ i pajustifikuar, që është marrë ndaj punonjësve, të cilët kanë arsye të dyshojnë për korrupsion e që këtë***

¹ Referuar observacionit dt.21 Mars 2011

dyshim ua paraqesin personave përgjegjës ose autoriteteve kompetente, është i pavlefshëm...”.

- 2.8** Ankuesja nuk është paguar si pjesëmarrëse për pesë ditë në korrigjimet e provimeve të maturës, ndryshe nga mësuesit e tjerë në të njëjtën situatë me të sajën. Nga inspektimi i Komisionerit për këtë çështje është siguruar vërtetimi Agjencisë Kombëtare të Provimeve datë.12.07.2011 nr.254, që provon faktin se z. S.Ç ka qenë vlerësuese në Maturën Shtetërore 2011, për testet e gjuhës së huaj angleze, nga 03.07.2011 deri më 08.07.2011. Me shkresë nr.prot.395 dt.14.05.2012, në përgjigje të kërkesës së Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, Agjencia Kombëtare e provimeve konfirmon pjesëmarrjen e znj. S.Ç. si vlerësuese për periudhën 3-8 korrik 2011 së bashku me katër kolegë të saj nga Instituti “Harry Fultz”.

3. BAZA LIGJORE

- 3.1** Ligji ka parashikuar në nenin 2/5 të ligjit se : një sjelljeje e padëshiruar, e cila lidhet me cilindo nga shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji, që ka për qëllim apo efekt cenimin e dinjitetit të personit dhe krijimin e një mjedisi frikësues, armiqësor, përcmues, poshtëruës a ofendues për atë person, si dhe në rastin e një trajtimi më pak të favorshëm, i kryer si rezultat i kundërshtimit ose i mosnënshtrimit nga ana e personit të cënuar ndaj një sjelljeje të tillë, përbën diskriminim.
- 3.2** Ligji në nenin 1 të tij ka parashikuar shprehimisht shkaqet për të cilat ofron mbrojtje. Sipas kësaj dispozite, shkaqet e treguara janë orientuese dhe jo shteruese, pasi në këtë nen është parashikuar edhe shprehja *“për çdo shkak tjetër”*.
- 3.3** Në nenin 2, pika 8, të ligjit nr.10221 date. 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi” parashikohet se “trajtimi i disfavorshëm apo pasoja negative, që vjen si reagim ndaj një ankimi a një procedimi që synon zbatimin e parimit të barazisë, përbën diskriminim”.
- 3.4** Në nenin 5 të ligjit nr.10221 date. 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, parashikohet “ ndalohet diskriminimi për shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji dhe mosmarrja në shqyrtim, sipas rasteve të përmendura në nenin 3 të këtij ligji, e një ankimi ose procedure, si dhe çdo formë sjelljeje që pengon zbatimin e parimit të trajtimit të barabartë.
- 3.5** Ligji për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ka bërë parashikime të posaçme për sa i përket mbrojtjes nga diskriminimi në fushën e punësimit.
- Në nenin 12/1 të tij parashikohet se: *“Ndalohet diskriminimi i personit në lidhje me të drejtën e tij për punësim. Diskriminimi përfshin çdo dallim, kufizim ose përjashtim që bazohet në shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji dhe që, ndër të tjera, ka lidhje me: c) trajtimin e punëmarrësve në vendin e punës, duke përfshirë trajtimin e tyre gjatë vendosjes ose ndryshimit të kushteve të punës, shpërblimin, përfitimet dhe mjedisin e punës, trajtimin lidhur me trajnimet profesionale ose gjatë procesit disiplinor apo lidhur me pushimin nga puna ose zgjidhjen e kontratës së punës”*.
 - Bazuar në nenin 13, pika e ligjit “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, punëdhënësi është i detyruar “t’u përgjigjet efektivisht dhe në përputhje me këtë ligj ankimeve të marra për shkak të diskriminimit të kryer nga punëmarrësit e tij, brenda një muaji nga marrja e tyre.”

- 3.6 Bazuar në nenin 19, pika c e ligjit, një nga detyrat e drejtuesit të institucionit arsimor është: “trajtimi efektiv i ankesave për diskriminim në institucion duke shqyrtuar çdo ankim brenda 30 ditëve nga paraqitja e tij”.

4. OPINION

- 4.1 Vlerësimi i punës për mësuesit në Insitutin “Harry Fultz” është parashikuar në Rregulloren e Menaxhimit të Stafit. Parashikohet vlerësim për një periudhë 12 mujore dhe realizohet bazuar në vlerësimin e punës nga shefi i departamentit si dhe nga tërheqja e mendimit të nxënësve. Gjatë inspektimeve kemi mundur të sigurojmë vlerësimet për vitet 2010-2011, 2007-2008, 2004-2005, ndërkohë që vlerësimet për vitin shkollor 2009-2010 nuk na u vunë në dispozicion, me pretendimin se nuk është bërë për asnjë mësues të shkollës. **Mosvënja në dispozicion e vlerësimeve të ngjashme, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, përbën diskriminim të drejtpërdrejtë.**
- 4.2 Mos trajtimi i ankesës për diskriminim që ankuesja shpreh në observacionin drejtuar Drejtorit të Përgjithshëm përbën diskriminim sipas ligjit nr.10221 date.04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi.
- 4.3 Ankuesja nuk është paguar si pjesëmarrëse për pesë ditë në korrigjimet e provimeve të maturës, ndryshe nga mësuesit e tjerë në të njëjtën situatë me të sajën. Dallimi që i bëhet ankueses në pagesën për ditët e vlerësimit është një argument tjetër që i shtohet argumenteve të mësipërm lidhur me trajtimin ndryshe të ankueses.
- 4.4 Mbështetur në nenin 32, pika 1, germa a) dhe c) e pika 3 e këtij neni, nenin 33, pikat 10 të Ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, Komisioneri konstaton diskriminimit të znj. S. Ç, nga z. A.K dhe znj B.B., në formën e viktimizimit.

5. REKOMANDIM

- 5.1 Rekomandojmë marrjen e të gjitha masave që znj. S.Ç. të trajtohet njëjloj me kolegët e tjerë të shkollës, të bëhet vlerësimi i mësueses sipas të njëjtave procedura me mësuesit e tjerë; marrjen e të gjitha masave për vendosjen e një fryme bashkëpunimi të znj. S.Ç. dhe kolegëve apo trupës drejtuese të shkollës, për sa kohë ankuesja të jetë pjesë e stafit të mësuesve.
- 5.2 Rregullat e parashikuara në Rregulloret apo Kodet e Institucionit të zbatohen njëjloj si për mësuesit meshkuj ashtu edhe për mësueset femra duke mos krijuar kushte që këto të fundit të vendosen në kushte te pabarabarta dhe më pak të favorshme me mësuesit meshkuj dhe si pasojë të diskriminohen për shkak të gjinisë.
- 5.3 Bazuar në nenin 33 pika 11, brenda 30 ditëve duhet të raportoni para Komisionerit për masat e marra me qëllim stabilizimin e marrëdhënieve duke eliminuar elementët diskriminues.

II.ÇËSHTJE TË DISKRIMINIMIT PËR SHKAK TË AFTËSISË SË KUFIZUAR

ÇËSHTJE EX-OFFICIO, INCIUAR NGA KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI, MBI BAZËN E PUBLIKIMEVE TË BËRA NË MEDIA, ME INFORMACIONIN E MARRË NGA GAZETA SHQIPTARJA.COM, E DATËS 18.09.2013, KU PRETENDOHEJ PËR DISKRIMINIM TË NXËNËSES SË KLASËS SË PARË TË LICEUT ARTISTIK “JAN KUKUZELI”, PËR SHKAK SE ËSHTË PREKUR NGA AUTIZMI.

VENDIMI Nr. 92/25.09.2013

Mbështetur në publikimin në media të një artikulli ku pretendohet për diskriminim të nxënësës së klasës së parë të Liceut Artistik “Jan Kukuzeli”, për shkak se është prekur nga autizmi.

1. PROCEDURA E NDJEKUR

- 1.1. Në gazetën Shqiptarja.com, të datës 18 shtator 2013, është botuar një shkrim me titull “*Është autike, mësuesja: të ike*”. Sipas këtij artikulli, A.XH., një vogëlushe 6 vjeçare nga rrethi i Durrësit po përballet me një rast flagrant diskriminimi. Mësuesja e klasës së parë ka kërkuar largimin e vogëlushes nga shkolla me pretendimin se ajo është e prekur nga autizmi.
- 1.2. Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, mbështetur në nenin 32/c të Ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “*Për mbrojtjen nga diskriminimi*”, bazuar në urdhërin nr.74, datë 18.09.2013 “*Për fillimin e procedurave për ndjekjen ex-officio të çështjes së nxënësës së Liceut Artistik “Jan Kukuzeli” Durrës*”, filloi procedurën e shqyrtimit të çështjes administrative.
- 1.3. Për të verifikuar këtë ngjarje, Bazuar në urdhërin nr.75, date 18.09.2013, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi zhvilloi një takim ku merrnin pjesë drejtoresha e Liceut Artistik “Jan Kukuzeli” Durrës, prindër të nxënësve të klasës së parë, si dhe mësuesja kujdestare dhe mësuesja e muzikës. Gjithashtu u zhvillua edhe një takim i Komisioneres me mësuesit e shkollës.

2. FAKTE TË KONSTATUARA DHE OPINIONI I KOMISIONERIT MBI TO.

2.1 Nga informacioni që u dha nga drejtoresha e shkollës, rasti i A.XH. njihet nga ajo që para një viti dhe A.XH. ishte e pranishme në Liceun Artistik “Jan Kukuzeli”, Durrës që nga muaji gusht. Pranimi i nxënësve në Liceun Artistik “Jan Kukuzeli” Durrës zhvillohet me konkurs. A.XH. ishte pjesë e audicionit të këtij viti, duke fituar vendin e 29 nga 37 pjesëmarrës. Duhet theksuar fakti që A.XH. u pranua në konkurs në një seancë të dytë pasi herën e parë nxënësja shfaqti mospërqendrim. A.XH. filloi bashkëpunimin me mësuesen e violonçelit para se të fillonte mësimi. Drejtoresha e shkollës pohon se, pas njoftimit që i është bërë mësueses së klasës së parë ajo është interesuar pranë Institutit të fëmijëve autikë, ku është njohur me rastet më të rënda. Ajo theksoi faktin se, ky ishte rasti i parë i një fëmije me elementë autikë në shkollë gjatë 54 viteve të ekzistencës së saj, edhe pse pranë kësaj shkolle ndjekin mësimin fëmijë të tjerë me aftësi të kufizuara në dëgjim. Pavarësisht frikës së mësueses së klasës së parë, drejtoresha shpjegoi se, u vendos:

- Të provohej gjithçka për integrimin e A.XH. në klasë.
- Javën e parë të qëndronte psikologja e shkollës në klasë me të. Për këtë është marrë leje nga Drejtori i DAR Durrës, pasi psikologja ushtron veprimtarinë edhe në një shkollë tjetër.
- Është rënë dakord me prindërit për ta monitoruar së bashku gjatë gjithë javës.
- Është vendosur në fund të rreshtit sepse ishte në bankë me psikologjen dhe mund të pengonte fëmijët e tjerë për të ndjekur mësimin.
- Është thirrur një takim i dytë (më 20 shtator, ora 12:00) për të vendosur për vazhdimësinë, pasi një ditë më parë disa prindër kanë kërkuar largimin e A.XH., përndryshe do të largonin fëmijët e tyre. Gjatë seancës dëgjimore, Drejtoresha theksoi edhe një herë se ata po e provonin në javën e parë dhe do të vendosnin në fund të javës për vazhdimësinë, por nuk u lanë të qetë nga mediat. Sipas Drejtoreshës, A.XH. ka marrë pjesë rregullisht dhe është trajtuar pa asnjë diskriminim në klasë nga mësuesja.

2.2 Nga informacioni i marrë nga psikologja e shkollës mësohet se ajo ka qëndruar me A.XH. në një bankë ditën e parë të shkollës, ndërsa në ditët e tjera ka qëndruar në distancë duke qenë e gatshme për ta ndihmuar. Ajo pohon faktin se: *“Është një luftë të arrish ta përqendrosh. Kryen vetë nevojat personale, por ka momente kur kërkon me këmbëngulje diçka dhe nervozohet nëse nuk i plotësohet. Gjatë këtyre ditëve kanë hyrë mësues e prindër në klasë”*.

2.3 Ndërsa mësuesja kujdestare u shpreh e shqetësuar: *“Jam informuar me 20 gusht, para konkurrimit për praninë e A.XH. në klasë të parë. Megjithëse e dija që kishim detyrim ligjor që ta ndiqte shkollën rregullisht, i kam kërkuar prindërve nëse do të ishte më mirë për vajzën që të shkonte në një shkollë tjetër me numër më të vogël nxënësish dhe ku mund të kujdesen më mirë. Ndjehem e shqetësuar si do bëj kur të mos kem psikologjen, për tu marrë me A dhe për të mos cënuar nivelin e mësimi edhe për fëmijët e tjerë. Megjithatë, kam punuar*

normalisht dhe nuk e kam diskriminuar. Nuk kemi një plan individual për A.XH. U frikësova, sepse u interesova dhe u njoha me rastet më të rënda të fëmijëve me autizëm”.

- 2.4 Në takim ishin të pranishëm edhe disa prindër të cilët shprehnin shqetësimin se mësuesja nuk do të kishte kohën e mjaftueshme t’i kushtojë fëmijëve të tjerë. Një prind, i cili ishte edhe mësues në shkollë kishte shfaqur dëshirën që fëmija i saj të qëndronte në një bankë me A.XH.
- 2.5 Prindërit e A.XH u shprehën të shqetësuar për fatin e A.XH, pasi dyshonin tek mënyra se si mësuesja do të sillej në vazhdim. Sipas saj mësuesja i kishte thënë se nuk mund të punonte me A.XH dhe i kishte propozuar t’a dërgonte në një shkollë private. Prindërit ankoreshin për mungesën e vullnetit të mësueses për të bashkëpunuar me to. Nëna e A.XH. u shpreh se: *“Fëmija nuk ka sjellë shqetësim, por situata po bëhet alarmante. Nga vizitat është diagnostikuar me elemente autizmi në fazë fillestare. Raporti mjekësor na është kërkuar 4 ditë pas fillimit të shkollës. A.XH. kryen vetë të gjitha nevojat gjë që konfirmohet edhe nga psikologjia e shkollës”.*

3. BAZA LIGJORE

- 3.1 Shqipëria pas miratimit në datë 15 nëntor 2012, të ligjit nr. 108/2012 *“Për Ratifikimin e Konventës së OKB për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara”*, u bë vendi i 127 që e ratifikoi këtë Konventë të rëndësishme. Konventa i ofron personave me aftësi të kufizuara një nivel të paprecedent mbrojtjeje, duke ndryshuar, para së gjithash, trajtimin e aftësisë së kufizuar nga ai bazuar në modelin mjekësor ose bamirës, në trajtimin sipas modelit social. Kjo Konventë është hartuar me qëllim që të nxisë, të mbrojë dhe të sigurohet që të gjithë personat me aftësi të kufizuar të gëzojnë plotësisht dhe në mënyrë të barabartë të gjitha të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, si dhe të nxisë respektin për dinjitetin e tyre. Në nenin 24 të Konventës është parashikuar detyrimi i shteteve palë për të garantuar të drejtën e personave me aftësi të kufizuara për arsim, ndër të tjera duke mos lejuar që ata të përjashtohen nga arsimi i përgjithshëm, arsimi pa pagesë dhe i detyruar fillor për shkak të aftësisë së kufizuar. Konventa mbështetet në disa parime të rëndësishme, ndër të cilat edhe parimi i mosdiskriminimit, pranimi i personave me aftësi të kufizuara si pjesë e diversitetit njerëzor dhe humanizmit dhe respekti për të drejtat e fëmijëve me aftësi të kufizuara. Konventa ofron një mbrojtje të posaçme për fëmijët me aftësi të kufizuara, për të siguruar që këto fëmijë të gëzojnë të gjitha të drejtat dhe liritë themelore të njeriut njësoj sit ë gjithë fëmijët e tjerë.² **Në kuptim të kësaj Konvente, personat me aftësi të kufizuara përfshijnë individët me dëmtime fizike, mendore, intelektuale apo shqisore afatgjata, të cilat në ndërveprim me barriera të ndryshme, mund të pengojnë pjesëmarrjen e tyre të plotë dhe efektive në shoqëri njësoj si pjesa tjetër e shoqërisë.**
- 3.2 Aftësia e kufizuar është një nga shkaqet për të cilat Ligji Nr.10/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, ofron mbrojtje. Në nenin 1 të tij përcaktohet objekti i këtij ligji: *“Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e*

² Neni 7 i Konventës *“Për Mbrojtjen e të Drejtave të Personave me Aftësi të Kufizuara”*.

parimit të barazisë në lidhje me gjininë, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzaninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicione gjenetike, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.

- 3.3** Sipas Klasifikimit Ndërkombëtar të Funkcionimit, Aftësisë së Kufizuar dhe Shëndetit (ICF), që bëhet nga Organizata Botërore e Shëndetësisë, klasifikim i cili shërben për matjen e shëndetit dhe aftësisë së kufizuar, autizmi përfshihet tek “*Global psychosocial functions*”. Shqipëria e ka formalizuar vullnetin e vet për zbatimin e këtyre detyrimeve në fushën e arsimit, përmes miratimit të ligjit 69/2012 “Për Sistemin Arsimor Parauniversitar në Republikën e Shqipërisë” ku në nenin 5, “E drejta për arsimim”, parashikohet se: “Në Republikën e Shqipërisë garantohet e drejta për arsimimin e shtetasve shqiptarë, të huaj dhe personave pa shtetësi, **pa u diskriminuar** nga gjinia, raca, ngjyra, etnia, gjuha, orientimi seksual, bindjet politike ose fetare, gjendja, ekonomike apo sociale, moshë, vendbanimi, **aftësia e kufizuar ose për arsye të tjera që përcaktohen në legjislacionin shqiptar**”.
- 3.4** Gjithashtu, në nenin 6, “Parime të përgjithshme”, parashikohet: “...3. Në sistemin arsimor parauniversitar, nxënësve dhe punonjësve u ofrohet mbrojtje nga çdo formë veprimi ose mosveprimi, që mund t’u shkaktojë diskriminim, dhunë, keqtrajtim ose dëm moral. 4. Në institucionet arsimore zbatohet parimi i gjithpërfshirjes së nxënësve. 5. Çdo nxënësi i sigurohet e drejta për arsimim cilësor, si dhe shanse të barabarta për arsimim. 6. **Nxënësve të familjeve në nevojë, nxënësve me aftësi të kufizuara dhe atyre me vështirësi në të nxënë u ofrohet përkujdesje e posaçme, sipas përcaktimeve në këtë ligj.....**”.
- 3.5** Po ky ligj në kreun XI të tij parashikon qartë arsimimin e fëmijëve me aftësi të kufizuara. Në nenin 64 me titull: “Ndjekja e institucioneve arsimore nga fëmijët me aftësi të kufizuara”, në pikat 3, 4 parashikohet: “3. Njësia arsimore vendore krijon një komision, të përbërë nga mjekë, psikologë, mësues dhe specialistë për fëmijët me aftësi të kufizuara, i cili, pasi shqyrton kërkesën e prindit ose të drejtorit të një institucioni arsimor, jep rekomandimet përkatëse për ndjekjen nga fëmija të një institucioni arsimor të zakonshëm a të specializuar. 4. Prindërit vendosin nëse fëmija e tyre me aftësi të kufizuara do të ndjekë një institucion të specializuar ose të zakonshëm të arsimit bazë. Prindërit mund të largojnë në çdo kohë nga shkolla fëmijën, kur e gjykojnë se ai nuk përfiton nga mësimet ose ka mundësi të tjera më të mira. 5. Ministria, në bashkëpunim me njësinë bazë të qeverisjes vendore dhe në këshillim me prindërit e komisionin, siguron arsimimin e fëmijëve me aftësi të kufizuara në njërin nga dy llojet e institucioneve arsimore, të zakonshme ose të specializuara.”
- 3.6** Në nenin 65 me titull: “Organizimi i arsimimit të fëmijëve me aftësi të kufizuara”, po ky ligj parashikon: “1. Nxënësit me aftësi të kufizuara mësojnë sipas planit mësimor e programeve lëndore të zakonshme, të përshtatura për ta, ose sipas planit mësimor e programeve lëndore të specializuara për ta. 2. Në institucionet arsimore të zakonshme, programi i personalizuar për nxënësin me aftësi të kufizuara hartohet nga një komision, në përbërje të të cilit janë mësues të fushave të ndryshme të të nxënësve të institucionit e psikologë. Hartimi i këtij programi bëhet në bashkëpunim me prindërit e nxënësit. Ndryshimi i programit të personalizuar brenda një institucioni arsimor vendoset nga komisioni brenda institucionit, në bashkëpunim me prindërit e fëmijës.

3. Nxënësve me aftësi të kufizuara u sigurohen mësues ndihmës dhe shërbim rehabilitues, sipas kritereve të përcaktuara me udhëzim të ministrit. Punonjësit arsimorë të institucioneve, që kanë nxënës me aftësi të kufizuara, certifikohen në programe trajnimi për trajtimin e këtyre nxënësve. 4. Njësia përkatëse bazë e qeverisjes vendore u siguron nxënësve me aftësi të kufizuara mjediset e përshtatshme të mësimdhënies e të të nxënësve, sipas standardeve të përcaktuara nga ministria”. Këto parashikime ligjore janë zbërthyer në mënyrë të hollësishme edhe në Dispozitat Normative për sistemin arsimor para universitar 2013, miratuar me Urdhërin 343, datë 19.08.2013 të Ministrit të Arsimit. Në këtë akt nënligjor parashikohet një kre i veçantë (Kreu XV) “Arsimimi i fëmijëve me aftësi të kufizuara”, ku përcaktohen qartë detyrimet e të gjitha strukturave për të garantuar të drejtën e fëmijëve me aftësi të kufizuara për tu arsimuar dhe për të garantuar një arsim gjithëpërfshirës.

- 3.7** Referuar Dispozitave Normative për Arsimin para-universitar 2013, shohim se është përcaktuar detyrimi i DAR /ZA-së për të ngritur një : *“Komision multidisiplinar të përbërë nga një mjek pediatër (kur është e mundur, mjek pediatër zhvillimi), një psikolog, një punonjës social, një mësues (kur është e mundur, mësues ikualifikuar për arsimin e specializuar)dhe drejtuesi i njësisë së shërbimit psiko-social”*. Ky Komision *“me kërkesën e prindit të fëmijës ose të drejtorit të institucionit arsimor, ku fëmija është regjistruar, vlerëson nevojat arsimore e shoqërore të fëmijës dhe ecurinë e tij”*⁴. Komisioni fton të paktën një prind gjatë vlerësimit të fëmijës, dhe po të jetë e nevojshme, të afërm të tij. Kur fëmija është në kopsht/shkollë, përveç prindit marrin pjesë: punonjësi i shërbimit psiko-social në institucionin arsimor, mësues të fëmijës të caktuar nga drejtori i institucionit arsimor⁵.
- 3.8** Nga ana tjetër, edhe pranë institucionit arsimor ngrihet një komision (në përbërje të të cilit janë tre mësues të lëndëve të fushave të ndryshme të të nxënësve dhe psikologu/punonjësi social.) Në komision merr pjesë, të paktën një nga mësuesit e nxënësve me AK dhe mësuesi ndihmës (kur ka dhe kryesohet nga punonjësi i shërbimit psiko-social⁶, me të cilin Drejtori i institucionit arsimor këshillohet para se t’i drejtohet komisionit pranë DAR/ZA-së. Drejtori duhet të bashkëpunojë me prindërit e fëmijës për të paraqitur kërkesën e tij⁷. Ky Komision luan një rol të rëndësishëm, sepse bazuar në vlerësimin e komisionit pranë DAR/ZA, ka këto kompetenca : udhëzon mësuesit për hartimin e PEI-ve dhe i miraton; ndihmon mësuesit gjatë zbatimit të PEI-ve; c) ndjek ecurinë e fëmijëve me AK; paraqet pranë komisionit të DAR/ZA-së, raportin e ecurisë së nxënësve me AK⁸.
- 3.9** Komisioni njofton me shkrim drejtorin e institucionit të zakonshëm arsimor se cilët nga fëmijët me AK do të mësojnë me plan mësimor dhe programe lëndore të zakonshme, të përshtatura ose individuale⁹. Komisioni pranë DAR/ZA-së udhëzon komisionet e institucioneve arsimore për punën me nxënësve me AK¹⁰. Në nenin 94, pika 5, këto dispozita

³ “Dispozitat normative për Arsimin parauniversitar” miratuar me Urdhërin 343, datë 19.08.2013, neni 93, pika 1

⁴ Po aty neni 93, pika 2.

⁵ Po aty, neni 93, pika 8.

⁶ Neni 95, pika 1

⁷ Neni 93, pika 4

⁸ Neni 95, pika 2 dhe 3.

⁹ Neni 93, pika 11.

¹⁰ Neni 93, pika 12.

parashikojnë detyrimin e DAR/ZA-së për të organizuar “nëpërmjet njësisë së shërbimit psiko-social pranë DAR/ZA-së, bashkëpunimin e mësuesve të shkollave të specializuara me mësuesit e shkollave të zakonshme, për hartimin dhe vënien në jetë të planeve edukative individuale (PEI) të nxënësve me AK”.

- 3.10** Në bazë të ligjit “Për mbrojtjen nga diskriminimi” në nenin 3, pika 1, diskriminimi përkufizohet si: “çdo dallim, përjashtim, kufizim apo preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim apo pasojë pengesën apo bërjen e pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe me ligjet në fuqi. Sipas pikës 2, të nenit 3, të po këtij ligji përcaktohet si diskriminimi i drejtpërdrejtë: “ajo formë diskriminimi që ndodh kur një person apo grup personash trajtohen në mënyrë më pak të favorshme sesa një person tjetër, apo një grup tjetër personash në një situatë të njëjtë a të ngjashme, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji.”
- 3.11** Në nenin 7 të tij ligji “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, parashikohet: “1. Çdo veprim ose mosveprim i autoriteteve publike ose i personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe të tjera personash, përbën diskriminim. 2. Eliminimi i të gjitha privilegjeve dhe i diskriminimit të padrejtë, garantohet për cilindo, në bazë të të drejtave vetjake, politike, ekonomike, shoqërore dhe kulturore të siguruara nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë dhe aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe nga ligjet në fuqi.” Në bazë të nenit 7, të ligjit “Për mbrojtjen nga diskriminimi” sjellja diskriminuese mund të konsumohet si me veprim ashtu edhe me mosveprim.

4. OPINION

- 4.1** Komisioni ndërdisiplinor pranë DAR/ZA-ve rekomandon ndjekjen e shkollës së specializuar vetëm kur gjykon se ndjekja e një shkolle të zakonshme nuk do të zhvillonte sa duhet fëmijën me aftësi të kufizuara (AK)¹¹.
- 4.2** Në monitorimin e veprimtarisë së Komisionit të institucionit arsimor ka një rol kyç Drejtori i institucionit arsimor të zakonshëm. Gjithashtu vlen të theksohet rëndësia që i kushtohet veprimtarive ndërgjegjësuere për përvojat me fëmijët me AK, trajnimit të mësuesve për t’u kujdesur dhe për arsimimin e fëmijëve AK¹². Kanë një rol të rëndësishëm në gjithë procedurat për regjistrimin dhe arsimimin e fëmijës me AK, prindërit, të cilët sipas këtyre dispozitave “Pas marrjes së rekomandimit nga komisioni pranë DAR/Z A, vendosin nëse fëmija e tyre me AK do të ndjekë

¹¹ Po aty, neni 93, pika 9

¹² Neni 96, pika 1 dhe 2.

një institucion të specializuar ose të zakonshëm të arsimit bazë. Prindërit mund të largojnë në çdo kohë nga shkolla fëmijën, kur gjykojnë se fëmija nuk përfiton nga mësimet ose ka mundësi të tjera më të mira”¹³.

- 4.3 Nga sa rezultoi nga inspektimi dhe seanca dëgjimore të realizuara pranë Liceut Artistik “Jan Kukuzeli” Durrës, procedurat e mësipërme nuk janë respektuar për nxënësen e klasës së parë A. Xh.** Nuk rezultoi të jetë ngritur ndonjë komision për të vlerësuar nevojat e A.XH. dhe nëse ajo do të duhej të ndiqte shkollën e zakonshme apo një shkollë të specializuar. Drejtuesi i institucionit arsimor ka patur dijeni për nevojat e veçanta të A. XH., informacion të cilin ia ka përcjellë edhe DAR/ Durrës. DAR/ Durrës dhe Drejtuesi i institucionit arsimor duhet të kishin respektuar parashikimet e bëra në aktet ligjore dhe nënligjore që rregullojnë arsimimin e fëmijëve me aftësi të kufizuara. **Mosrespektimi i këtyre parashikimeve ligjore ka sjellë që A.XH. të mos gëzojë në baza të barabarta me fëmijët e tjerë të drejtën për t’u arsimuar, e drejtë kjo që i garantohet nga aktet ligjore në fuqi, pikërisht për shkak të aftësisë së kufizuar.**
- 4.4 Për shkak të mosrespektimit të procedurave të mësipërme të parashikuara për arsimimin e fëmijëve me aftësi të kufizuara, rezultoi se nuk ishte përgatitur asnjë plan mësimor i përshtatur për nevojat e A.XH. Gjithashtu edhe mësuesja kujdestare që do të ndiqte A.XH. nuk kishte marrë asnjë trajnim për mënyrën dhe trajtimin e fëmijëve që kanë nevojë për një përkujdesje të veçantë.** Gjatë seancës dëgjimore mësuesja për shkak të mungesës së njohurive lidhur me fëmijët me elementë autikë, u shpreh se ishte ndjerë e frikësuar në momentin e parë dhe e paafte për t’u përballur dhe përshtatur nevojat e A.XH. Rezultoi gjatë inspektimit se Drejtuesi i institucionit arsimor për t’i ardhur në ndihmë mësueses kishte kërkuar nga DAR/Durrës prezencën e psikologes pranë A.XH. për gjatë gjithë kohës që ajo ishte në klasë. Ditën e parë të shkollës A.XH., për shkak se duhet të shoqërohej në bankë nga psikologjia, me justifikimin se kjo e fundit bëhej pengesë për shkak të shtatartësisë, u vendos në bankë të fundit. Gjatë javës së parë të shkollës prindër dhe mësues, përfaqësues të mediave ndërprisnin shpesh mësimin duke hapur derën e klasës. **Pra, A.XH. përbënte kuriozitet, u bë qendra e vëmendjes, ndërkohë që ishte një fëmijë si shumë të tjerë që kishte filluar shkollën për herë të parë. Këto sjellje dhe veprime krijojnë rreth A një mjedis frikësues dhe jo miqësor, duke shfaqur tek ajo shenja stresi.**
- 4.5 Drejtuesi i institucionit arsimor, duke mos respektuar procedurat ligjore për të garantuar arsimimin e A.XH. si person me aftësi të kufizuara, ka marrë kompetenca që me ligj i takojnë Komisionit multidisiplinar, që duhet të ishte ngritur pranë DAR /ZA, në bazë të nenit 64 të Ligjit “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë” dhe nenit 93 të Dispozitave Normative për sistemin arsimor parauniversitar 2013, duke bërë që A.XH të trajtohet në mënyrë jo profesionale, që ka rezultuar jo efikas.** Gjithashtu Ministria e Arsimit dhe e Shkencës në Udhëzimin nr.46 dt.23.08.2013 “Për vitin shkollor 2013- 2014 në sistemin arsimor para-universitar”, ka sjellë në vëmendje të DAR/ZA-ve dhe drejtorive të shkollave detyrimet që ata kanë për arsimimin e fëmijëve me aftësi të kufizuara dhe marrjen e masave për regjistrimin e tyre, identifikimin dhe mbështetjen me plane edukative individuale, duke krijuar të gjitha kushtet e përshtatshme për integrimin e fëmijëve me aftësi të kufizuara në shkollat e zakonshme të arsimit bazë, që është parësore.

¹³ Neni 97, pika 6 dhe 7.

- 4.6** Pavarësisht masave për një trajtim ndryshe, me qëllim integrimin e fëmijëve me nevoja të veçanta, nuk është arritur t'i ofrohet A.XH. arsim në përputhje me standartet që kërkojnë aktet ndërkombëtare dhe legjislacionin shqiptar në fuqi.
- 4.7** Mosveprimi i subjekteve DAR/Durrës dhe Drejtuesit të Liceut Artistik "Jan Kukuzeli", Durrës në përputhje me parashikimet ligjore që garantojnë arsimimin e fëmijëve me aftësi të kufizuara ka bërë që A për shkak të aftësisë së kufizuar të mos gëzojë në baza të barabarta me fëmijët e tjerë të drejtën për t'u arsimuar. Dështimi i këtyre dy institucioneve për të marrë të gjitha masat efektive për të siguruar vlerësimin individual të nevojave të A. XH. për të garantuar në këtë mënyrë integrimin e saj në shkollë përbën diskriminim të drejtpërdrejtë sipas parashikimit të bërë në nenin 3, pika 2 të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 "Për mbrojtjen nga diskriminimi".
- 4.8** Komisioneri konstaton diskriminimin e A.Xh, nxënëse në Liceun Artistik "Jan Kukuzeli", Durrës nga ana e Drejtorisë Rajonale Arsimore Durrës dhe Drejtuesi i Liceut Artistik "Jan Kukuzeli", Durrës.

5. REKOMANDIME

- Drejtoria Rajonale Arsimore Durrës duhet të marrë urgjentisht masa për të bërë funksional Komisionin multidisiplinor, sipas parashikimeve ligjore për arsimimin e fëmijëve me aftësi të kufizuar, të sipërcituara, për vlerësimin e nevojave arsimore e shoqërore të nxënësit A. Xh dhe ecurinë e saj.
- Drejtuesi i Liceut Artistik "Jan Kukuzeli", Durrës, duhet të marrë urgjentisht masa për të ngritur Komisionin për nxënësit me aftësi të kufizuar brenda Liceut Artistik "Jan Kukuzeli", sipas parashikimeve ligjore të sipërcituara, për arsimimin e fëmijëve me aftësi të kufizuar.
- Deri në momentin e krijimit dhe funksionimit të komisioneve dhe planeve individuale për nxënësen A.Xh, Drejtuesi i Liceut Artistik "Jan Kukuzeli", Durrës dhe mësuesja kujdestare të rrisin bashkëpunimin me prindërit e fëmijës për të përshtatur dhe plotësuar sa më mirë nevojat aktuale të saj.
- Drejtoria Rajonale Arsimore Durrës dhe Drejtuesi i Liceut Artistik "Jan Kukuzeli", Durrës duhet të bashkëpunojnë ngushtësisht për të ndjekur të gjitha procedurat ligjore për arsimimin e fëmijëve me aftësitë e kufizuar për të gjithë nxënësit e tjerë që ndjekin mësimin pranë këtij institucioni arsimor.
- Brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga marrja dijeni për këtë vendim Drejtoria Arsimore Rajonale Durrës dhe Drejtuesi i Liceut Artistik "Jan Kukuzeli" Durrës, të njoftojnë Komisionerin, lidhur me masat e marra për zbatimin e këtij vendimi.
- Në referim të nenit 33, pika 11 e ligjit nr. 10 221, datë 04. 02. 2011, "Për mbrojtjen nga diskriminimi", moszbatimi i këtij vendimi sjell si pasojë ndëshkimin me gjobë sipas parashikime të bëra në pikën 13 të po këtij neni.

ANKESA E ZNJ. H.H. PARAQITUR PRANË KOMISIONERIT PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI, KUNDËR DREJTORIT TË KONVIKTEVE TË SHKOLLAVE TË MESME TIRANË PËR NDËRPRERJEN E MARRËDHËNIEVE TË PUNËS NGA PUNËDHËNËSI, PËR SHKAK TË SHOQËRIMIT TË TË BIRIT KUJDESI I TË CILIT ËSHTË SIGURUAR KRYESISHT NGA PUNËMARRËSI.

VENDIM Nr. 54/2014

1. PROCEDURA E NDJEKUR

- 1.1** Znj. H. H. në ankesën e saj, shpjegon se: *“Kam qenë punonjëse e konviktit të shkollave të mesme në Tiranë, që prej vitit 1998. Sapo z. I. D. është emëruar në pozicionin e Drejtorit të Konvikteve të Shkollave të Mesme Tiranë, është vënë në dijeni nga unë, mbi gjendjen shëndetësore të djalit dhe i kam kërkuar leje për t’u larguar nga orari zyrtar i punës, vetëm për dy orë, gjatë dy ditëve në javë, për shkak se më duhej të shoqëroja djalin në Qendrën Spitalore Universitare “Nënë Tereza”, për të bërë dializën, por ai nuk ka pranuar absolutisht të largohesha gjatë orarit të punës. Gjatë ditëve që shoqëroja djalin për të bërë dializën, kthehesha sërish në punë dhe qëndroja deri në orët e vona të pasdites, në mënyrë që të isha sa më korrekte. Edhe pse komisioni i KEMP-it, më kishte caktuar që të punoja 6 orë në ditë, punoja si gjithë të tjerët 8 orë në ditë, në mënyrë që të mos gjenin shkak për të më larguar nga puna. Z. I. D., në përfundim më pushoi nga puna duke mos marrë parasysh gjendjen shëndetësore të djalit dhe timen njëkohësisht. Mendoj se largimi nga orari zyrtar i punës, për të shoqëruar djalin në Qendrën Spitalore Universitare “Nënë Tereza”, ka sjellë dhe pushimin tim nga puna.”*
- 1.2** *Në zbatim të parashikimeve ligjore, të përcaktuara në nenet 32 dhe 33, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, me shkresën Nr. 746/1 prot, datë 19.12.2013 njoftoi Drejtorin e Konvikteve të Shkollave të Mesme z. I. D., duke e vënë në dijeni për fillimin e procedurave të shqyrtimit të ankesës dhe kërkoi informacion, mbi pretendimet e ngritura nga znj. H. H.. Përmes shkresës nr. 53 prot., datë 17.01.2014, z. I. D. i përgjigjet kërkesës për informacion.*
- 1.3** *Më datë 04.11.2013 u zhvillua inspektimi pranë Drejtorisë së Konvikteve të Shkollave të Mesme Tiranë.*

2. FAKTE TË KONSTATUARA

- 2.1** Nga konsultimi me dosjen personale të znj. H. H., u evidentua se ajo nuk kishte depozituar kopje të vërtetimit të Komisionit Mjekësor të Caktimit të Aftësisë për Punë, në Drejtorinë e Konvikteve të Shkollave të Mesme, fakt i cili

tregon se ajo nuk ka vënë në dijeni me shkrim, z. I. D. mbi gjendjen shëndetësore të saj.

- 2.2 Gjatë inspektimit të zhvilluar më datë 04.11.2013, në kuadër të shqyrtimit të ankesës nr. 38 rregj., datë 31.07.2013 të znj. H. H., në Drejtorinë e Konvikteve të Shkollave të Mesme, z. I. D. ka informuar grupin e inspektimit si më poshtë vijon: *“Kam pasur dijeni që znj. H.H. ka pasur djalin me probleme shëndetësore dhe për këtë shkak ajo mungonte e nuk paraqitej në punë dy herë në javë.”* Referuar procesverbalit të sipërcituar, rezulton që z. I. D., ka pohuar se ka pasur dijeni që znj. H. H., largohej nga orari zyrtar i punës dy herë në javë pasi kishte të birin me probleme shëndetësore, për këtë shkak ajo ka marrë masë disiplinore¹⁴.
- 2.3 Referuar dokumentacionit të administruar, vërejmë se në materialin bashkëngjitur vendimit për ndërprerjen e marrëdhënieve të punës, është vërejtja me paralajmërim, e dhënë për shkak të mosparaqitjes në punë të znj. H.H. Referuar këtyre provave, konstatojmë se ndërprerja e marrëdhënieve të punës si punonjëse e pastrimit të Konviktit të Mjeshtërisë Sportive në Kamëz, ka ardhur si rezultat i performancës jo të mirë dhe mosparaqitjes në punë.
- 2.4 Mbështetur në provat dhe faktet e grumbulluara nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, rezulton që znj. H. H., shoqëronte të birin në Qendrën Spitalore Universitare “Nënë Tereza”, Tiranë, tre herë në javë (ditëve të marta, të enjte dhe të shtuna), për të bërë dializë dhe për këtë shkak i duhej të largohej nga orari zyrtar i punës. Shoqërimi i të birit për shkak të gjendjes së tij shëndetësore, ka qenë një nga arsyet që znj. H. H. i janë ndërprerë marrëdhëniet e punës, nga Drejtoria e Konvikteve të Shkollave të Mesme.

3. BAZA LIGJORE

- 3.1 Në nenin 3, pika 2 të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, parashikohet se: ***“Diskriminim i drejtpërdrejtë është ajo formë diskriminimi që ndodh kur një person apo grup personash trajtohen në mënyrë më pak të favorshme sesa një person tjetër, apo një grup tjetër personash në një situatë të ngjashme, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji”.***
- 3.2 Theksojmë se diskriminimi për shkak të shoqërimit është një formë diskriminimi i parashikuar nga ligji *“Për mbrojtjen nga diskriminimi”* në nenin 3, pika 4, ku sanksionohet: ***“Diskriminim për shkak të shoqërimit, është ajo formë diskriminimi që ndodh kur ka një dallim, kufizim ose preferencë, për arsye të shoqërimit me persona që u përkasin grupeve të përmendura në nenin 1 të këtij ligji, si dhe për shkak të supozimit për një shoqërim të tillë”.***
- 3.3 Jurisprudenca e Gjykatës së Drejtësisë së Bashkimit Europian (GJDBE), në çështjen me nr. C-303/06, të S. Coleman kundër Ligji Attridge dhe Ligji Steve, është shprehur se ***“sjellja e padëshiruar e ngacmimeve e cila pësohet nga një punonjës i cili nuk është vetë me aftësi të kufizuara ka të bëjë me aftësinë e kufizuar të fëmijës së tij, kujdesi i të cilit është siguruar kryesisht nga ai punonjës, një sjellje e tillë është në kundërshtim me ndalimin e ngacmimit përcaktuar në nenin 2 (3) të Direktivës 2000/78”.*** GJDBE, gjatë trajtimit të kësaj

¹⁴ Mbështetur në shkresën Nr. 68 prot., datë 06.09.2011, të Drejtorit të Konvikteve të Shkollave të Mesme, z. I. D.

çështje, ka konstatuar se punëdhënësi ka trajtuar një punonjës i cili nuk është vetë me aftësi të kufizuara, në mënyrë më pak të favorshme se një tjetër punonjës, për shkak të aftësisë së kufizuar të fëmijës së tij, kujdesi i të cilit është siguruar kryesisht nga ai punonjës dhe trajtimi i tillë është në kundërshtim me ndalimin e diskriminimit të drejtpërdrejtë përcaktuar me nenin 2 (2) (a) të Direktivës 2000/78.

- 3.4.** Në çështjen Thlimmenos kundër Greqisë¹⁵, Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut, ka mbajtur qëndrimin se: *“.....e drejta për të mos u diskriminuar në gëzimin e të drejtave të garantuara nga Konventa për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut është shkelur gjithashtu kur shteti pa një justifikim objektiv dhe të arsyeshëm dështon për të trajtuar personat ndryshe kur situatat e të cilëve janë dukshëm të ndryshme”*¹⁶.

4. OPINION

- 4.1** Për sa më sipër, Komisioneri vlerëson se praktika e ndjekur nga Drejtoria e Konvikteve të Shkollave të Mesme, duke i trajtuar të gjithë punonjëset e pastrimit, në konviktin e Mjeshtërisë Sportive në Kamëz, njëlloj pa marrë parasysh kushtet e ndryshme që mund të kishin, përbën diskriminim substantiv (trajtim i barabartë i çështjeve të pabarabarta) në fushën e të mirave dhe shërbimeve, duke cënuar të drejtën e znj. H. H. në punësim, për shkak të pasjes së një djali me aftësi të kufizuara.
- 4.2** Komisioneri konstaton diskriminimin të drejtpërdrejtë, për shkak të shoqërimit, të znj. H. H., nga Drejtori Konvikteve të Shkollave të Mesme, z. I. D., duke e vënë atë në kushte jo të favorshme, në raport me punonjësit e tjerë të Konvikteve të Shkollave të Mesme.

5. REKOMANDIMI

- 5.1** Rekomandim për Drejtorinë e Konvikteve të Shkollave të Mesme, që të rikthejë në pozicionin e mëparshëm të punës znj. H. H..
- 5.2** Detyrimin e Drejtorisë së Konvikteve të Shkollave të Mesme, të informojë brenda 30 (tridhjetë) ditëve dhe të njoftojë Komisionerin lidhur me veprimet e ndërmarra për zbatimin e këtij vendimi, bazuar në nenin 33, pika 11 e Ligjit “Për mbrojtjen nga diskriminimi”.
- 5.3** Në referim të nenit 33, pika 11 e ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2011, moszbatimi i këtij vendimi sjell si pasojë ndëshkimin me gjobë sipas parashikime të bëra në pikën 13 të po këtij neni.

¹⁵ Thlimmenos kundër Greqisë, Kërkesa nr. 34369/97, vendimi me datë 06.04.2000

¹⁶ Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut (Ratifikuar nga Republika e Shqipërisë me Ligjin nr.8137, datë 31.07.1996, hyrë në fuqi në datë 02.08.1996) dhe jurisprudenca e GJEDNJ janë të detyrueshme për tu zbatuar bazuar në nenin 116 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë

III. ÇËSHTJE TË DISKRIMINIMIT PËR SHKAK TË ORIENTIMIT SEKSUAL

ANKESA E Z. V.N., NË TË CILËN PRETENDOHET PËR DISKRIMINIM PËR SHKAK TË ORIENTIMIT SEKSUAL, NGA TELEVISIONET “News-24”, “ABC News” SI DHE GAZETAT “PANORAMA”, “SHQIPTARJA.COM” DHE “KOHA JONË”.

VENDIM Nr. 97/2013

1. PROCEDURA E NDJEKUR

- 1.1** Në shpjegimet e tij z. V.N shkruan: *“Ndjehem i diskriminuar nga mediat “News-24”, “ABC News” dhe gazetat: “Panorama”, “Shqiptarja.Com” dhe “Koha Jonë”, pasi kanë transmetuar lajmin gjithë ditën për 24 orë dhe nuk kanë dhënë vetëm inicialet siç ndodh, por kanë dhënë emër e mbiemër sikur të ishte një krim i rëndë. Kjo ka ndikuar negativisht në jetën time pasi nga ajo ditë jam përjashtuar nga familja, fisi e shoqëria”*. Në mbështetje të ankesës, z. V.N ka bashkëngjitur Vendimin nr. 31, Nr. 217 Akti të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë në të cilin V.N. deklarohet fajtor për veprën penale të “Ushtrimit të Prostitucionit”, të parashikuar nga neni 113 i Kodit Penal, dhe dënimin e tij me gjobë, si dhe fotokopje të gazetave të cilat kanë publikuar lajmin e Drejtorisë së Policisë së Qarkut Tiranë për arrestimin e shtetasit V.N. Subjekti ankues kërkon nga Komisioneri që: *“E drejta ime morale të çohet në vend sepse ndjehem i diskriminuar nga familja për këtë arsye”*.
- 1.2** Me shkresën nr. 272/1, datë 26.04.2013 u njoftua subjekti ankues për fillimin e shqyrtimi të ankesës.
- 1.3** Me shkresa të veçanta, me datë 26.04.2013 u njoftuan për fillimin e procedurave të shqyrtimit të ankesës gazeta “Koha Jonë”, “Panorama”, “Shqiptarja.com” dhe televizioni “ABC News”, “News 24” dhe u kërkuar informacion mbi pretendimet e bëra nga subjekti ankues.
- 1.4** Në përgjigje të kërkesës së Komisionerit, gazeta “Shqiptarja.com” ka dërguar e-mailin datë 02.05.2013 me sqarimin se: *“Informacioni në redaksinë e gazetës është bërë me anë të njoftimit të strukturave të Drejtorisë së Policisë së Qarkut Tiranë, në të cilën janë dhënë dhe emrat përkatës me akuzën për ushtrim prostitucioni në publik”*.
- 1.5** Me shkresat Nr. 382, 383, 384, 385, 386 Prot, datë 05.08.2013 njoftohen palët dhe Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale për realizimin e një seance dëgjimore për të parashtruar dhe argumentuar në mënyrë të

drejtpërdrejtë pretendimet e tyre. Më datë 07.07.2013 në mjediset e zyrës së Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi u zhvillua seanca dëgjimore. Në këtë seancë morën pjesë përfaqësues nga Drejtoria e Policisë e Qarkut Tiranë, subjekti ankues z. V.N dhe përfaqësuesit nga Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale. Në këtë seancë nuk u paraqitën përfaqësues nga gazetatat: “Koha Jonë”, “Panorama”, “Shqiptarja.com” dhe televizionet “ABC News” dhe “News 24”.

- Në këtë seancë, z. V.N deklaroi se për shkak të publikimit të emrit të tij në televizion dhe në gazeta, po refuzohet për tu marrë në punë, familjarët nuk e duan si dhe është sharë dhe ofenduar në mjediset e komisariatit. Subjekti ankues, në mbështetje të pretendimeve të tij se nuk pranohet në punë dhe është përjashtuar nga familja, për shkak të publikimit të orientimit të tij seksual nuk ka vënë në dispozicion të Komisionerit asnjë informacion për të mbështetur këto pretendime.
- Në përgjigje të pretendimeve të ngritura përfaqësuesja e policisë znj. A.K u shpreh se: *“Nëse ankuesi është ofenduar nga punonjësit e policisë kjo çështje duhet të hetohet nga Shërbimi i Kontrollit të Brendshëm. Në lidhje me publikimin e të dhënave policia ka kryer detyrimin ligjor për publikimin e njoftimit për shtyp”.*
- Në vazhdim të hetimit të ankesës, me datë 11.07.2013 iu kërkua Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale një opinion ligjor mbi përgjegjësitë e palëve, mediave dhe Policisë së Tiranës mbi të drejtat e tyre për të publikuar të dhënat personale.

1.6 KMDP me shkresën nr.752/1, datë 05.09.2013 ka dhënë opinionin ligjor duke theksuar se: *“Në cilësinë e kontrolluesit të të dhënave personale dhe sensitive të Z.V.N, televizionet private “News 24”, “ABC News” si dhe gazetatat “Panorama”, “Shqiptarja.Com” dhe “Koha Jonë”, kanë bërë përpunimin e të dhënave personale sensitive të këtij subjekti në kundërshtim me nenin 7 të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”.*

Fakti që kontrolluesit e mësipërm e kanë marrë informacionin mbi të dhënat personale/sensitive të subjektit ankues z.V.N nga një burim tjetër (Ministria e Brendshme) i cili është bërë publik, nuk justifikon kontrolluesit, televizionet “News 24”, “ABC News” si dhe gazetatat “Panorama”, “Shqiptarja.Com” dhe “Koha Jonë” në përpunimin e të dhënave dhe publikimin e tyre, pasi secili prej kontrolluesve vepron në mënyrë individuale, duke qenë të detyruar për të zbatuar në punën e vet ligjin nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”.

2. FAKTE TË KONSTATUARA DHE OPINIONI I KOMISIONERIT MBI TO

2.1 Në njoftimin për shtyp të Drejtorisë së Policisë së Qarkut Tiranë të datës 12.08.2012 është publikuar dhe informacioni mbi z.V.N. Në këtë njoftim në mes të tjerash shkruhet: *“Dje nga komisariati i Policisë nr.3 Tiranë u bë arrestimi në flagrancë i shtetasve: -V.N¹⁷, 27 vjeç, banues në Tiranë, - E.B, 26 vjeç, banues në fshatin Nikël, Fushë*

¹⁷Në njoftimin për shtyp të datës 12.08.2012, të Drejtorisë së Policisë së Qarkut Tiranë emrat e dy shtetasve janë paraqitur të plotë, pa iniciale.

Krujë, - si dhe filloi procedimi penal në gjendje të lirë për shtetasin G.J.B, 20 vjeç, banues në Tiranë. Arrestimi i këtyre shtetasve u bë pasi në rrugën “Bardhok Biba”, ora 00.30, janë kapur në flagrancë nga shërbimet ndërsa ushtronin prostitucion mes njëri-tjetrit për shumën prej 3000 lekë, si dhe u sekuestruan në cilësinë e provës materiale 2 paruke, 20 prezervativ, si dhe shumën prej 8000 lekë. Materialet hetimore i kaluan Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë për konsumim të veprës penale të Prostitucionit parashikuar nga neni 113 i Kodit Penal”.

- 2.2** Gjatë zhvillimit të seancës dëgjimore përfaqësuesi i Drejtorisë së Policisë Qarkut Tiranë deklaroi se: “Drejtoria e Policisë e Qarkut Tiranë, bazuar në ligjin 9749, datë 04.06.2007 “Për Policinë e Shtetit” dhe ligjin nr. 8503, datë 30.06.1999 “Për të drejtën e informimit mbi dokumentet zyrtare”, përpilon në mënyrë sistematike veprimtarinë e punës së saj. Policia si pjesë e administratës, ka përgjegjësinë e saj për informimin e publikut, përgjegjësi të cilën e përmbush krahas të tjerash dhe përmes bashkëpunimit me median. E drejta e informimit si një e drejtë kushtetuese, Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë në nenet 22 dhe 23 të saj garanton lirinë e shprehjes, lirinë e shtypit si dhe të drejtën e informimit. Ndërkohë censura paraprake e mjeteve të komunikimit ndalohej. Në këtë kontekst, Policia në veprimtarinë e përditshme të saj, ka zbatuar me përpikëri të gjitha marrëdhëniet e policisë me komunitetin që përfshijnë një sërë çështjesh, që kanë të bëjnë me përpjekjet e përbashkëta të policisë dhe qytetarëve për zgjidhjen e problemeve të ndryshme që lidhen me çështje të sigurisë dhe bashkëjetesës. Ndër çështjet që përfshijnë marrëdhëniet me komunitetin është dhe parandalimi i krimit, marrëdhëniet me publikun dhe me njerëzit. Në rastin në fjalë policia e shtetit ka cituar veprën penale dhe ka publikuar të dhënat personale për personat e arrestuar në kushtet e flagrancës. Policia nuk publikon të dhënat personale për personat të cilët hetohen në gjendje të lirë dhe në rastet e të miturve”.
- 2.3** Në gazetën “Panorama” të datës 12.08.2012 njoftimi për shtyp i Drejtorisë së Policisë së Qarkut Tiranë është paraqitur në lajmin me titull: “Tiranë, kapen dy meshkuj, kryenin marrëdhënie seksuale me pagesë”. Në mes të tjerash në këtë artikull shkruhet: “ Dy meshkuj që kryenin marrëdhënie homoseksuale kundrejt pagesës, u arrestuan dje së bashku me klientin e tyre në kryeqytet..... Fillimisht policia ka vënë në pranga shtetasin V.N¹⁸, 27 vjeç dhe E.B, 26 vjeç..... Ndërsa pas arrestimit të këtyre dy personave, policia ka identifikuar dhe ka ndaluar edhe klientin e tyre, shtetasin Gj. B, 20 vjeç.....”.
- 2.4** Në gazetën “Koha Jonë” të datës 12.08.2012 njoftimi për shtyp i Drejtorisë së Policisë së Qarkut Tiranë është paraqitur në lajmin me titull: “Kapen për prostitucion 2 djem, klienti: Dukeshin si femra”. Në mes të tjerash në këtë artikull shkruhet: “Homoseksualët dyshohet se kryenin marrëdhënie seksuale me meshkuj të ndryshëm, kundrejt një shume parash. V.N dhe E.B, u arrestuan për veprën penale të ushtrimit të prostitucionit. Në ambientet e komisariatit u shoqërua dhe 20 vjeçari me inicialet G.J.B.....”.

¹⁸ Në njoftimin për shtyp të datës 12.08.2012, të Drejtorisë së Policisë së Qarkut Tiranë emrat e dy shtetasve janë paraqitur të plotë, pa iniciale.

- 2.5 Në gazetën “Shqiptarja.com” të datës 12.08.2012 njoftimi për shtyp i Drejtorisë së Policisë së Qarkut Tiranë është paraqitur në lajmin me titull: *“Pranga, tre homoseksualëve në Tiranë”*. Në mes të tjerash në këtë artikull shkruhet: *“Të ndaluarit quhen V.N dhe E.B, të cilët në bashkëpunim me njëri tjetrin kanë arritur që të shfrytëzojnë për prostitucion homoseksualin Gj.B”*.
- 2.6 Në mediat “ABC News” dhe “News 24” njoftimi për shtyp i Drejtorisë së Policisë së Qarkut Tiranë është paraqitur në datë 12.08.2012 disa herë i shkruar me titra, në të cilën janë shkruar të dhënat personale të personave V.N dhe E.B.

3. BAZA LIGJORE

- 3.1 **Rekomandimi Rec(2003)13 i Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës “Për dhënien e informacionit për median në lidhje me procedimet penale”, miratuar me datë 10.07.2003, në parimin 5 të tij përcakton mënyrën e dhënies së informacionit në media, në të cilën shkruhet: “Kur vetë autoritetet gjyqësore dhe shërbimet e policisë kanë vendosur të japin informacionin për median në kontekstin e një procedimi penal në ecuri e sipër, ky informacion duhet dhënë mbi baza jo diskriminuese dhe aty ku është e mundshme, nëpërmjet deklaratave për shtyp, konferencave për shtyp nga oficerët e autorizuar apo mjeteve të ngjashme”.**
- 3.2 Mbështetur në detyrimet ligjore të parashikuara në nenin 3 të Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë në të cilën shteti merr masa për mbrojtjen e dinjitetit të njeriut dhe respektimin e lirive dhe të drejtave të tij, nenit 14 të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, Ligjin nr. 10021, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, si dhe Rekomandimit CM/Rec(2010)5 të Këshillit të Ministrave për shtetet anëtare lidhur me masat për të luftuar diskriminimin për shkak të orientimit seksual ose identitetit gjinor, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi synon respektimin me rigorozitet të parimit të barazisë përpara ligjit, barazi të shanseve dhe mundësive për të ushtruar të drejtat dhe liritë, si dhe zbatimin e efektshëm të politikave antidiskriminuese, sidomos për sa i përket komunitetit LGBT, në Shqipëri.
- 3.3 Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë garanton të drejtën e informimit në nenin 23 të saj ku parashikohet se: *“E drejta e informimit është e garantuar”*. Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, sanksionon se të drejtat dhe liritë themelore të parashikuara në të mund të kufizohen. Kështu, në nenin 17, të saj sanksionohet se: 1. *“Kufizime të të drejtave dhe lirive të parashikuara në këtë Kushtetutë mund të vendosen vetëm me ligj për një interes publik ose për mbrojtjen e të drejtave të të tjerëve. Kufizimi duhet të jetë në përpjesëtim me gjendjen që e ka diktuar atë”*. Pra, shohim se, Kushtetuta e lidh kufizimin e të drejtave dhe lirive të parashikuara në të, vetëm nëse rregullohet me ligj për një interes publik.
- 3.4 Në ligjin nr 9749, datë 04.06.2007 “Për Policinë e Shtetit”, në nenin 117 përcaktohet veprimtaria informative e Policisë, kështu në pikën 1 të këtij neni shkruhet se: *“Veprimtaria informative e Policisë, në kuptim të këtij ligji, vlerësohet procesi i grumbullimit, sistemit, analizimit, shpërndarjes dhe përdorimit të informacionit për nevoja të mbrojtjes së rendit e të sigurisë publike ose për nevoja të parandalimit e zbulimit të veprave penale”*.

- 3.5 Me urdhrin nr. 2122, datë 22.06.2005 të Ministrit të Rendit Publik janë përcaktuar detyrat funksionale të oficerëve të Marrëdhënieve me Publikun në Drejtoritë e Policisë në Qarqe, në të cilën në pikën 1, është përcaktuar se: *“Ndër detyrat kryesore të marrëdhënieve me publikun përcaktohet informimi i publikut mbi aksionet, strukturat dhe reformat e policisë”*.
- 3.6 Neni 1 i Ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, përcakton se *“Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me gjininë, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzaninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicione gjenetike, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”*. Pra, siç shihet personat për shkak të orientimit seksual gëzojnë mbrojtje nga sjelljet diskriminuese apo që e nxisin atë.
- 3.7 Bazuar në nenin 7 të ligjit nr. 10221/2010, “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, mbrojtja nga diskriminimi garantohet ndaj çdo veprimi ose mosveprim të autoriteteve publike ose të personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe të tjera personash.

4. OPINION

- 4.1 Komisioneri vlerëson së çështja duhet trajtuar dhe në drejtim të së drejtës së personave për tu prezumuar të pafajshëm deri në një vendim gjyqësor të formës së prerë. Kështu në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë në nenin 30 përcaktohet se: *“Kushdo quhet i pafajshëm përderisa nuk i është provuar fajësia me vendim gjyqësor të formës së prerë”*. E drejta për t’u prezumuar i pafajshëm përdoret ndaj të dyshuarve përpara se të paraqiten akuzat penale përpara gjyqimit dhe mbahet në përdorim derisa të konfirmohet gjetja me faj e të akuzuarit, pas apelit përfundimtar. Z.V.N. në kohën e përpunimit dhe publikimit të të dhënave të tij nga Policia e Shtetit, gëzonte të drejtën e prezumimit të pafajësisë,
- 4.2 Bazuar në njoftimin për shtyp të Policisë së Qarkut Tiranë vërejmë se ky njoftim ka qenë korrekt për sa i përket cilësimit të veprës penale dhe të rrethanave të ngjarjes, por në drejtim të përhapjes së të dhënave personale të shtetasve ashtu siç është cilësuar dhe nga Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale ky njoftim është në shkelje të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”.
- 4.3 Në Raport Progresin e BE për Shqipërinë për vitin 2011 dhe 2012, është tërhequr vëmendja mbi një sërë çështjesh dhe problematikash që ka shoqëria shqiptare në trajtimin e komunitetit LGBT. Kështu, në Raport Progresin e BE për Shqipërinë në vitin 2011, theksohet se “janë raportuar disa raste dhune dhe keqtrajtimi që kanë vënë në shënjestër persona të komunitetit transeksual. Homofobia vazhdon të jetë gjerësisht e përhapur, madje edhe në radhët e zyrtarëve të shërbimit publik”. Në Raport Progresin e BE për Shqipërinë në vitin 2012, theksohet se “..... ka ende diskriminim

ndaj grupeve të caktuara të dobëta siç janë LGBT dhe Romët”.

- 4.4** Për sa më sipër vërejmë se dhe gjatë këtyre viteve në opinionin publik në vendin tonë është krijuar stereotipi kundër personave të komunitetit LGBT të cilët portretizohen si kërcënim për traditën dhe vlerat e shoqërisë sonë. Paragjykimi ndaj komunitetit LGBT në Shqipëri është i lidhur me faktin se deri në vitin 2001, homoseksualizmi është konsideruar si veprë penale e parashikuar nga neni 116 i Kodit Penal. Orientimi seksual i referohet kapacitetit të çdo personi ndaj tërheqjeve të thella emocionale, dashurie dhe seksuale, marrëdhënieve intime dhe seksuale me individë të gjinive të ndryshme (heteroseksualë) ose së njëjtës gjini (homoseksual, lezbike, gej), ose më shumë se një gjini (biseksual).
- 4.5** Në Kodin Penal neni 113 përcaktohet se, “Ushtrimi i prostitucionit dënohet me gjobë ose me burgim gjer në tre vjet. Dhënia e shpërblimit për përfitim personal të prostitucionit dënohet me gjobë ose me burgim gjer në tre vjet”. Kjo dispozitë nuk jep një përkufizim për prostitucionin, rrjedhimisht nuk e lidh atë me një karakteristikë personale siç është orientimi seksual. Në këtë kuptim dhe informacioni i dhënë në media duke identifikuar subjektin ankues si homoseksual, mund të nxisë qëndrime negative dhe agresive për shkak të orientimit të tij seksual, si dhe mund të vendosë në pozita diskriminuese të gjithë komunitetin LGBT.
- 4.6** Për të arritur në konkluzionin nëse ky asocim bëhet mes karakteristikës personale dhe veprës penale, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, gjatë periudhës së muajit Mars 2013, ka bërë monitorimin e gazetave të përditshme: “Panorama”, “Shqiptarja.com” dhe “Koha Jonë”. Nga ky monitorim rezultoi se:
- Në gazetën “Panorama” ishin botuar rreth 99 artikuj me cilësime të veprave penale dhe civile si: vrasje, plagosje, shfrytëzim prostitucioni, vjedhje, trafikim i femrave, marrëdhënie seksuale ose homoseksuale me të mitur, trafik të lëndëve narkotike, aksidente, etj në të cilat ishin përdorur të dhënat personale të të arrestuarve, të akuzuarve apo dhe të dënuarve me vendim gjykate. Nga këto në 26 raste janë përdorur initiale si në rastet e të dëmtuarve të mitur, personave të dyshuar apo ato në kërkim. Në informacionet e raportuara në këtë gazetë në **4 raste është raportuar vepra penale shoqëruar me të dhënat personale të të akuzuarve si dhe është shkruar dhe karakteristika personale për këto persona (gjendja shëndetësore dhe raca)**, ndërsa në 69 raste të tjera informacionet janë raportuar së bashku me të dhënat personale të personave.
 - Në gazetën “Shqiptarja.com” ishin botuar rreth 71 artikuj me cilësime të veprave penale dhe civile, në të cilat ishin përdorur të dhënat personale të të arrestuarve, të akuzuarve apo dhe të dënuarve me vendim gjykate. Në informacionet e raportuara në këtë gazetë **në 1 rast është raportuar vepra penale shoqëruar me të dhënat personale të të akuzuarit dhe viktimës si dhe është shkruar dhe karakteristika personale për këto persona (gjendja shëndetësore)**

- Në gazetën “Koha Jonë” ishin botuar rreth 71 artikuj me cilësime të veprave penale dhe civile, në të cilat ishin përdorur të dhënat personale të të arrestuarve, të akuzuarve apo dhe të dënuarve me vendim gjykate. **Në informacionet e raportuara në këtë gazetë nuk kishte raste raportimi të vepra penale të shoqëruara me të dhëna dhe karakteristika personale.**

4.7 Për sa më sipër, vërehet se shtypi i shkruar (gazetat e monitoruara) nuk ka pasur tendencë për të publikuar informacione duke përdorur karakteristika personale vetëm për rastin në shqyrtim por edhe karakteristika të tjera personale si gjendja shëndetësore apo përkatësia në komunitetin Rom.

4.8 Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi vlerëson se liria e shprehjes është një e drejtë Kushtetuese e cila garantohet nga neni 22 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë. Kushtetuta e lidh kufizimin e të drejtave dhe lirive themelore të parashikuara në të, me detyrimin për të mos tejkaluar kufizimet e parashikuara në Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Sipas paragrafit të dytë të nenit 10 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, ushtrimi i kësaj lirie nuk mund të cenojë dinjitetin dhe të drejtat e të tjerëve. Praktika e vendosur nga këto media, përmes lidhjes së veprës penale me karakteristika personale të subjektit që prezumohet apo ka kryer veprën penale, mund të kontribuojë në vendosjen e qëndrimeve negative, agresive dhe diskriminuese për të gjithë individët apo komunitetet në Shqipëri.

4.9 Komisioneri konstaton se: Transmetimi i informacioni mbi veprën penale, duke i lidhur me karakteristika personale të individit që prezumohet apo ka kryer veprën penale edhe kur kjo karakteristikë nuk përcakton cilësimin e veprës penale, vendos një praktikë që në mënyrë të tërthortë diskriminon individët apo komunitetet për shkak të këtyre karakteristikave.

5. REKOMANDIM

5.1 Rekomandohet bazuar në ligjin nr. 9887/2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” të ndryshuar, neni 16, z. V.N ti drejtohet Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

5.2 Rekomandohet që mediat “News 24”, “ABC News”, “Panorama”, “Shqiptarja.Com” dhe “Koha Jonë” të jenë më të kujdesshëm dhe të përgjegjshëm në publikimin e informacioneve duke kapërcyer tendencën e trajtimit të homoseksualitetit si një temë që lidhet me lajme skandaloze.

5.3 Rekomandohet që mediat “News 24”, “ABC News”, “Panorama”, “Shqiptarja.Com” dhe “Koha Jonë” të marrin masa për mospublikimin e karakteristikave personale të individëve, që nuk kanë lidhje me parashikimin ligjor të veprës penale të kryer.

IV. ÇËSHTJE TË DISKRIMINIMIT PËR SHKAK TË ETNISË, RACËS, GJUHËS

ÇËSHTJA EX-OFFICIO “PËR MONITORIMIN E SHPËRNDARJES SË NXËNËSVE ROM NË SHKOLLAT 9-VJEÇARE NË TIRANË”

Çështje e iniciuar nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, mbi bazën e informacionit të marrë se disa nxënës të komunitetit romë janë regjistruar të gjithë së bashku në të njëjtën klasë të parë pranë shkollës 9-vjeçare “Bajram Curri” në Tiranë.

VENDIM Nr. 95/2013

Duke pasur në vëmendje çështjen e komunitetit rom në Shqipëri e sidomos zbatimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në arsim, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi ka nisur me iniciativën e vet monitorimin e shpërndarjes së nxënësve romë në shkollat 9-vjeçare, në Tiranë.

1. PROÇEDURA E NDJEKUR

- 1.1 Pikënisja e fillimit të procedurave hetimore mbi një çështje të tillë e ka burimin tek një çështje e shqyrtuar gjatë vitit 2012, lidhur me rastin e disa nxënësve romë të regjistruar të gjithë së bashku në klasë të parë pranë shkollës 9-vjeçare “Bajram Curri” në Tiranë. Gjatë hetimit dhe shqyrtimit të kësaj çështjeje, u konstatua se përqendrimi i nxënësve romë pranë kësaj shkolle ishte shumë më i madh se në shkolla të tjera 9-vjeçare, pavarësisht vendbanimit¹⁹ të tyre. Kështu, në shkollën “Bajram Curri” aktualisht bëjnë pjesë 860 nxënës, ku 405 prej tyre ose rreth 43% janë romë dhe egjiptianë, ndërsa në klasat e para të kësaj shkolle këto komunitete përbëjnë 63% të nxënësve.
- 1.2 Përsa më sipër dhe bazuar në nenin 32/c, të ligjit nr. 10 22, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, ku sanksionohet se: “Komisioneri ka kompetencë të kryejë hetime administrative pas marrjes së informacionit të besueshëm për shkelje të ligjit dhe në funksion të tij”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, nëpërmjet

¹⁹ Pavarësisht faktit se përgjithësisht familjet romë e ndryshojnë shpesh vendbanimin e tyre, pra nuk kanë një vendbanim permanent, sërish njihen disa vende të caktuara, ku këto familje kanë jetuar dhe jetojnë ende për periudha relativisht të gjata, të tilla si: Bregu i Lumit, liqeni artificial i Tiranës etj.

shkresës nr. 279/1 prot., datë 09.07.2012, i kërkoi Drejtorisë Arsimore Rajonale të Qytetit Tiranë, informacion në lidhje me shpërndarjen e nxënësve të komunitetit rom në shkollat 9-vjeçare të qytetit të Tiranës.

- 1.3** Në përgjigje të shkresës nr. 279/1 prot., datë 09.07.2012, Drejtoria Arsimore Rajonale e Qytetit Tiranë (DARQT), nëpërmjet shkresës nr. 1673 prot, datë 05.12.2012, vuri në dispozicion të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi informacionin e kërkuar, në përmbajtje të të cilit tregoheshin të dhënat e fëmijëve të komunitetit rom për vitin shkollor 2011-2012 për secilën shkollë të qytetit të Tiranës dhe baza ligjore me të cilën rregullohet shpërndarja e fëmijëve në shkolla.
- 1.4** Nëpërmjet shkresës nr. 1055/1 prot., datë 06.09.2013, DARQT informoi Komisionerin në lidhje me regjistrimet e nxënësve në arsimin 9-vjeçar për vitet shkollore 2010-2013, si dhe të dhëna statistikore mbi shpërndarjen e fëmijëve rom në shkollat 9-vjeçare të qytetit të Tiranës.

2. BAZA LIGJORE

- 2.1** Në mbrojtje të parimit të barazisë Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë parashikon në nenin 18 të saj *“1. Të gjithë janë të barabartë përpara ligjit. 2. Askush nuk mund të diskriminohet padrejtësisht për shkaqe të tilla si gjinia, raca, feja, etnia, gjuha, bindjet politike, fetare a filozofike, gjendja ekonomike, arsimore, sociale ose përkatësia prindërore. 3. Askush nuk mund të diskriminohet për shkaqet e përmendura në paragrafin 2, nëse nuk ekziston një përligjje e arsyeshme dhe objektive”*. Në nenin 20 të Kushtetutës parashikohet shprehimisht se *“1. Personat që u përkasin pakicave kombëtare ushtrojnë në barazi të plotë para ligjit të drejtat dhe liritë e tyre.”*.
- 2.2** Konventa Europiane e të Drejtave të Njeriut parashikon në nenin 2, Protokolli nr. 1, parashikon se: *“Askujt nuk mund t’i mohohet e drejta për arsimim. Shteti, në ushtrimin e funksioneve që merr përsipër në fushën e edukimit dhe të arsimit, respekton të drejtën e prindërve për të siguruar këtë edukim dhe arsim në përputhje me bindjet e tyre fetare dhe filozofike”*.
- 2.3** Komisioneri gjatë shqyrtimit të çështjes i është referuar edhe jurisprudencës së GJEDNJ-së. Në shqyrtimin e çështjes Lavida dhe të tjerët kundër Greqisë, nga Gjykata Europiane e të Drejtave të Njeriut, e cila doli në përfundimin se: ***“vendosja e nxënësve rom në një shkollë të veçantë, i mënjanon ata nga pjesa tjetër e shoqërisë dhe nuk i lejon fëmijët e këtij komuniteti të integrohen në jetën sociale”***.
- 2.4** Sipas legjislacionit shqiptar (e pasqyruar edhe në përgjigjen e DARQT-së), regjistrimi i nxënësve në shkollat 9-vjeçare bëhet bazuar në Dispozitat Normative të Arsimit Para universitar, të Ministrit të Arsimit dhe Shkencës. Në analizë të Kreut III, nenit 12, pika 1, në të cilën citohet se: *“Regjistrimi i fëmijëve në kopësht dhe i nxënësit në shkollën 8-vjeçare apo në shkollën e mesme të përgjithshme, si rregull, bëhet në kopshtin dhe në shkollën e përcaktuar nga ndarja territoriale e vendbanimit e vendosur nga pushteti vendor me propozim të Drejtorisë Arsimore”*, pika 2 *“Nxënësi, me miratimin e drejtorit të shkollës, mund të regjistrohet në shkollat 8-vjeçare jashtë ndarjes territoriale të vendbanimit të tij, kur këtë gjë e lejojnë kushtet e kapacitetet e lokaleve”*,

regjistrimi i nxënësve dhe shpërndarja e tyre në shkollat 9-vjeçare, bëhet në shkollën që i përket njësisë administrative në të cilën jetojnë nxënësit.

- 2.5** Neni 28/3 të ligjit 69/2012 “Për sistemin arsimor para universitar në Republikën e Shqipërisë”, citon se: *“Njësia bazë e qeverisjes vendore, në bashkëpunim me njësinë përkatëse arsimore vendore dhe institucionet arsimore publike, është përgjegjëse për regjistrimin e nxënësve në shkollat publike të arsimit të detyrueshëm me kohë të plotë”*, ndërkohë që Udhëzimi nr. 16, datë 24.07.2012 “Për vitin shkollor 2012-2013 në sistemin arsimor para universitar”, të Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Kreu VII, pika 2 shprehet se: *“Drejtoritë Arsimore Rajonale dhe Zyrat Arsimore, në bashkëpunim me pushtetin vendor, të sigurojë regjistrimin e nxënësve në përshtatje me vendbanimin e tyre.”*.
- 2.6** Bazuar në udhëzimin e Ministrit të Arsimit Nr. 6, datë 29.03.2006 *“Për regjistrimin në shkollë të nxënësve romë që nuk janë të pajisur me certifikatë lindje”*, drejtoritë e shkollave, kanë detyrim ligjor identifikimin dhe regjistrimin e nxënësve rom në shkollat 9 – vjeçare në zonën përkatëse ku ata jetojnë, pa nevojën e certifikatës së lindjes.

3. FAKTE TË KONSTATUARA DHE OPINIONI I KOMISIONERIT MBI TO

- 3.1** Siç shihet nga legjislacioni i zbatuar, por edhe informacioni i grumbulluar, nuk ka një ligj, akt nënligjor apo udhëzim që sanksionon apo synon vendosjen e nxënësve romë në një shkollë të veçantë.
- 3.2** Duke marrë parasysh përsa më lart, nëse në të njëjtën njësi administrative të pushtetit vendor ekziston më shumë se një shkollë 9-vjeçare, atëherë nxënësi ka mundësinë e zgjedhjes ndërmjet tyre.
- 3.3** Gjatë hetimit administrativ, të kryer për evidentimin e pozicionit gjeografik të vendndodhjes së shkollave 9-vjeçare me numrin më të madh të nxënësve të komunitetit rom, u konstatua se në shkollat të cilat ishin të pozicionuara më pranë vendbanimeve të komunitetit rom, kishte edhe një numër më të madh nxënësish të këtij komuniteti. Specifikisht shkollat 9-vjeçare me numrin më të madh të nxënësve të komunitetit rom janë Shkolla “Bajram Curri”, që kishte edhe numrin më të madh të nxënësve të këtij komuniteti, Shkolla “26 Nëntori”, Shkolla “Kol Jakova” dhe Shkolla “Ramazan Jarani”.
- 3.2** Një problem që u evidentua gjatë hetimit, ishte përqendrimi i madh i numrit të nxënësve të komunitetit rom në shkollën 9-vjeçare “Bajram Curri”, në krahasim me shkollën 9-vjeçare “Ramazan Jarani”, të cilat i përkisnin të njëjtës njësi administrative dhe ishin pranë njëra-tjetrës.
- 3.3** Shteti shqiptar është angazhuar për të respektuar të drejtat e minoriteteve kombëtare, duke formalizuar vullnetin e vet përmes miratimit të Strategjisë Kombëtare “Për përmirësimin e kushteve të jetesës së pakicës rome” (e miratuar me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 633 datë 18.09.2003). Në kapitullin I të Strategjisë Kombëtare “Për përmirësimin e kushteve të jetesës së pakicës rome”, parashikohen politika mbështetëse në edukimin dhe arsimimin e fëmijëve të komunitetit rom.
- 3.4** Referuar rastit të shkollës “Bajram Curri”, nuk mund të themi se fakti që në këtë shkollë janë përqendruar numri më i madh i nxënësve të komunitetit rom të kësaj njësie vendore, përbën sjellje diskriminuese, pasi fëmijëve të këtij

komuniteti ja lejon ligji dhe udhëzimi i sipërcituar që të regjistrohen në përshtatje me vendbanimin e tyre. Duhet theksuar se, shkolla “Bajram Curri” dhe shkolla “Ramazan Jarani” edhe pse bëjnë pjesë në të njëjtën njësi administrative, nuk kanë të njëjtën largësi nga vendbanimet e komunitetit rom. Gjatë procedurës hetimore, u vu re se shkolla “Bajram Curri”, është shumë më pranë vendbanimeve të komunitetit rom, krahasuar me shkollën “Ramazan Jarani”.

- 3.5 Një tjetër fakt që duhet theksuar është se, ***në shkollën “Bajram Curri” nuk konstatohet ndonjë tendencë në rritje të numrit të fëmijëve të komunitetit rom.*** Në krahasim me numrin e përgjithshëm të nxënësve (për vitet shkollore 2010-2011 ishte 869, për vitin shkollore 2011-2012 ishte 860 dhe për vitin 2012-2013 ishte 835), evidentohet fakti se numri i fëmijëve të komunitetit jo rom të regjistruar në këtë shkollë në këto vite (për vitin shkollore 2010-2011 ishte 540, për vitin 2011-2012 ishte 531 dhe për vitin shkollore 2012-2013 ishte 512) ishte më i madh krahasuar me numrin e fëmijëve të komunitetit rom (për vitin shkollore 2010-2011 në ishte 329, për vitin 2011-2012 ishte në të njëjtat shifra, për vitin shkollore 2012-2013 ishte 323). ***Vihet re një rënie e numrit të përgjithshëm të nxënësve për të dyja komunitetet.***
- 3.6 Referuar rastit të shkollës 9-vjeçare “26 Nëntori”, e cila i përket një njësie tjetër vendore, por që është fare pranë një vendbanimi tjetër të komunitetit rom, vihet re e njëjta situatë, ku numri i fëmijëve jo rom është më i madh se numri i fëmijëve rom, për të tre vitet shkollore që u analizuan.
- 3.7 Në përfundim, për sa më sipër, Komisioneri, konstaton se ***nuk ka një tendencë të veçimit apo përqendrimit të fëmijëve rom në një shkollë të vetme***, por duke qenë se vendbanimet e komunitetit rom janë të përqendruara më pranë shkollës “Bajram Curri”, rrjedhimisht edhe numri i fëmijëve rom të regjistruar në këtë shkollë është më i madh.

4. REKOMANDIMET

- 4.1 Konstatimin e mosdiskriminimit, për shkak të racës, përkatësisë etnike dhe ngjyrës, ndaj nxënësve të komunitetit rom në shkollat 9-vjeçare të Tiranës.
- 4.2 Bazuar në nenin 35, të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, “Përgjegjësia individuale nuk e përjashton përgjegjësinë e shtetit ose personit juridik privat”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi ***rekomandon*** që:
Drejtoria Arsimore Rajonale e Qarkut Tiranë, të ndjekë në vazhdimësi frekuentimin e fëmijëve të komunitetit rom në shkollat 9 – vjeçare dhe ndryshimin e raportit mes nxënësve të komunitetit rom dhe jo rom në shkollat që kanë numër më të madh të fëmijëve të komunitetit rom.

V. ÇËSHTJE TË DISKRIMINIMIT PËR SHKAK TË BINDJEVE POLITIKE

ANKESA PARAQITUR NGA SUBJEKTIT V.M KUNDËR SUBJEKTIT PUBLIK DREJTORIA E SHËNDETIT PUBLIK MAT, NË TË CILËN PRETENDOHEË PËR DISKRIMINIM PËR SHKAK TË “BINDJES POLITIKE” NË FUSHËN E PUNËSIMIT.

VENDIMI NR. 140 / 2014

1. PROÇEDURA E NDJEKUR

- 1.1 Shtetasja V.M në ankesë shpjegon: “Që nga data 14.11.2012 deri më datë 20.05.2014 ka qenë e punësuar pranë Drejtorisë së Shëndetit Publik Mat, në detyrën si Specialiste Finance. Me shkresën nr. 167, datë 20.05.2014 është urdhëruar nga Drejtori i DSHP Mat, për “largimin e menjëhershëm politikisht nga puna”.
- 1.2 Në zbatim të parashikimeve ligjore, të përcaktuara në nenet 32 dhe 33, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, më datë 03.07.2014, me shkresën nr. 600/1 prot, është bërë njoftimi dhe kërkesa për informacion për Drejtorinë e Shëndetit Publik Mat në lidhje me ankesën, ndërkohë që në të njëjtën datë me shkresën nr. 600/2 Prot, është kërkuar informacion shtesë nga subjekti ankues në lidhje me ankesën e bërë.
- 1.3 Me shkresën datë 09.07.2014 subjekti ankues në mbështetje të ankesës së bërë ndërmjet të tjerave ka dorëzuar pranë zyrës së Komisionerit dokumentacionin që zotëron²⁰

2. FAKTE TË KONSTATUAR

- 2.1 V.M me shkresën Vendim-Emërimi, nr. 2, datë 14.11.2012 ka qenë e punësuar pranë subjektit, Drejtorinë e Shëndetit Publik Mat, në detyrën e Shefit të Financës për një periudhë 3-mujore. Me shkresën, Vendim-Emërimi, nr. 1, datë 15.01.2013, V.M është emëruar në një afat të pacaktuar.

²⁰ - Vërtetim nr.42, datë 05.06.2014 lëshuar nga subjekti, Partia Demokratike Dega Mat në të cilën vërtetohet se V.M që nga viti 1992 është anëtare e Partisë Demokratike, Dega Mat.

- Autorizim për vëzhguesit për subjektet zgjedhore, lëshuar nga KZAZ Qarku Dibër, për V.M në cilësinë e vëzhgueses për subjektin zgjedhor, Partia Demokratike pranë KQV nr. 0936, datë 23.06.2013.
- Raport për paaftësi të përkohshme në punë, nr i regjistrimit 726, nr. modulari 033624, nga data 19.05.2014 deri më datë 02.06.2014.

- 2.2 Me shkresën nr. 167, datë 20.05.2014, Drejtoria e Shëndetit Publik Mat urdhëron: **“Largimin e menjëhershëm të V. M politikisht nga Drejtoria e Shëndetit Publik Mat. Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë”**.
- 2.3 Njohja me veprimtarinë politike të subjektit ankues vërtetohet me anë të dokumenteve të paraqitura nga V.M që janë: Vërtetimi si anëtar i subjektit politik Partia Demokratike dhe autorizimi në cilësinë e vëzhgueses për subjektin Partia Demokratike gjatë procesit zgjedhor për zgjedhjet për kuvend të datës 23.06.2013.

3. BAZA LIGJORE

- 3.1 Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, sanksionon në nenin 18/2 se: “Askush nuk mund të diskriminohet padrejtësisht për shkaqe të tilla si gjinia, raca, feja, etnia, gjuha, **bindjet politike**, fetare a filozofike, gjendja ekonomike, arsimore, sociale ose përkatësia prindërore.
- 3.2 Në nenin 1 të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, parashikohet objekti i këtij ligji, duke u sanksionuar se: “Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me gjininë, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, **bindjet politike**, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzaninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicione gjenetike, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”. *Bindja politike, është shkak për të cilin ligji 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi” ofron mbrojtje dhe bazuar në nenin 32/1/c të ligjit, Komisioneri ka kompetencë për të shqyrtuar shkelje, që i bëhen zbatimit dhe respektimit të parimit të barazisë në lidhje me bindjen politike.*
- 3.3 Bazuar në nenin 7 të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, mbrojtja nga diskriminimi garantohet ndaj çdo veprimi ose mosveprim të autoriteteve publike ose të personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe të tjera personash.
- 3.4 Ligji nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi” ndalon diskriminimin e personave në lidhje me të drejtën e tyre për punësim. Kështu në nenin 12, pika 1, përcaktohet se ndalohet diskriminimi për shkak të bindjes politike dhe që ka lidhje me: c) “trajtimin e punëmarrësve në vendin e punës, duke përfshirë trajtimin e tyre gjatë vendosjes ose ndryshimit të kushteve të punës, shpërblimin, përfitimet dhe mjedisin e punës, trajtimin lidhur me trajnimet profesionale ose gjatë procesit disiplinor apo lidhur me pushimin nga puna ose zgjidhjen e kontratës së punës”.

4. OPINION

- 4.1 Bazuar në ligjin nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, neni 32, pika 2 “Të gjitha institucionet publike dhe subjektet private janë të detyruara të mbështesin Komisionerin në përmbushjen e detyrave të tij, veçanërisht duke i dhënë informacionin që i nevojitet atij”. Drejtoria e Shëndetit Publik Mat, me gjithë afatin kohor që kishte në dispozicion,

- nuk përmbushi kërkesat ligjore për dërgimin e informacionit të kërkuar nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi.
- 4.2** Komisioneri vlerëson se tendenca për lirim e menjëhershëm nga puna të V.M pa respektuar procedurat ligjore për lirim e punonjësve nga puna bie ndesh me Urdhrin nr. 506, datë 18.09.2013 të Ministrit të Shëndetësisë, i cili në pikën 1, Urdhëron: “Pezullimin, deri në një urdher të dytë, të procedurave të marrjes dhe largimit nga puna, të punonjësve në institucionet shëndetësore”.
- 4.3** Gjithashtu, fakt rëndues i largimit të padrejtë nga puna të V.M është dhe largimi i saj nga puna në kohën kur punonjësja ka qenë me raport mjekësor për paaftësi të përkohshme në punë.
- 4.4** Punëdhënësi, Drejtoria e Shëndetit Publik Mat nuk ka sjellë asnjë fakt që të hedhë poshtë pretendimet e subjektit ankuesit dhe të vërtetojë se trajtimi ndryshe i saj ka ardhur për shkaqe të arsyeshme dhe jo për shkak të bindjes politike të V.M. Përkundrazi, në shkresën e largimit nga detyra, vullneti i autoritetit publik është shprehur hapur duke theksuar **“Largimin e menjëhershëm të V.M politikisht nga Drejtoria e Shëndetit Publik Mat. Ky urdher hyn në fuqi menjëherë”**.
- 4.5** Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi bazuar në provat e administruara vlerëson se, Urdhri nr. 167, datë 20.05.2014 për largimin nga puna të V.M për shkak të bindjes politike është një rast flagrant i shkeljes së dinjitetit, të drejtave dhe lirive themelore të individit të sanksionuara në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë dhe Ligjin nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi” dhe mosndëshkimi i një sjellje diskriminuese kaq të hapur, do të minonte rëndë arsyen e vetë ekzistencës së ligjit “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”.
- 4.6** Drejtoria e Shëndetit Publik Mat, në cilësinë e punëdhënësit ka shkelur nenin 12, pika 1/c të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”. Për këtë arsye mbështetur në nenin 12, pika 1/c, nenin 21/1, nenin 32, pika 1/a, si dhe nenin 33, pika 10, 11, të Ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, konstaton diskriminimin e V.M, nga ana e Drejtorisë së Shëndetit Publik Mat, për shkak të bindjes politike në fushën e punësimit.

5. REKOMANDIM

- 5.1** Drejtoria e Shëndetit Publik Mat, si subjekt që ka konsumuar sjelljen diskriminuese, të bëjë rikthimin e V.M në vendin e mëparshëm të punës.
- 5.2** Bazuar në nenin 33 pika 11, të ligjit “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Drejtori i Drejtorisë së Shëndetit Publik Mat, detyrohet që brenda 30 (tridhjetë) ditëve të njoftojë Komisionerin, lidhur me veprimet e ndërmarra për zbatimin e këtij vendimi.
- 5.3** Në referim të nenit 33, pika 11 e ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, moszbatimi i këtij vendimi sjell si pasojë ndëshkimin me gjobë sipas parashikimeve të bëra në pikën 13 të po këtij neni.
- 5.4** Kujtojmë se bazuar në nenin 35 të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi” çdo person mban përgjegjësi për veprimet ose mosveprimet e tij por kjo nuk e përjashton përgjegjësinë e institucionit.

VI. ÇËSHTJE TË DISKRIMINIMIT PËR SHKAK TË BINDJEVE FETARE

ÇËSHTJE EX-OFFICIO, INCIUAR NGA KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI, MBI BAZËN E PUBLIKIMEVE TË BËRA NË GAZETËN SHQIPTARE, TË DATËS 06.06.2013, NË ARTIKULLIN ME TITULL “MJEKJA REFUZON TË PUNOJË ME INFERMIEREN ME SHAMI NË KOKË”.

VENDIM Nr. 86/2013

Mbështetur në informacionin e marrë në “Gazeta Shqiptare”, në artikullin me titull “Mjekja refuzon të punojë me infermieren me shami në kokë”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi urdhëroi fillimin e procedurave për ndjekjen “ex-officio” të çështjes.

1. PROÇEDURA E NDJEKUR

- 1.1 Gazeta Shqiptare, në datën 06.06.2013, në artikullin me titull “Mjekja refuzon të punojë me infermieren me shami në kokë”, shkruar nga gazetarët E. D. dhe T. V. informon se: “një incident me kontekst fetar ka ndodhur në Burrel”, pasi mjekja e spitalit të qytetit nuk ka pranuar të punojë me infermieren që mbante shami. Në artikull raportohet gjithashtu se është ushtruar dhunë fizike ndaj drejtorit të spitalit nga një i afërm i mjekes dhe se vetë infermierja Znj. I. H. ka konfirmuar për gazetarët se mjekja Znj. F. Gj. është shprehur se: “Ti je e mbuluar me shami. Ky është institucion laik e jo fetar dhe shteti është laik, ndaj shko e puno në ato institucione ku lejohet të mbash shami”.
- 1.2 Pavarësisht hetimit të çështjes kryesisht, znj. I.H., ka shprehur aprovimin e saj për shqyrtimin dhe trajtimin e çështjes duke bërë plotësimin e formularit të ankesës.
- 1.3 Me shkresën Nr 354/1, datë 11.06.2013, Komisioneri ka njoftuar për fillimin e procedimit administrativ lidhur me ngjarjen, z. B. S., Drejtor i Qendrës Spitalore “Xhavit Mara” Burrel, dhe ka kërkuar informacion më të zgjeruar në lidhje me situatën konkrete në funksion të shqyrtimit të çështjes. Me shkresën Nr.235/1 datë 17.06.2013, z. B.S ka informuar Komisionerin se: “Infermierja I. H. nuk është lejuar të futet në ambjentet e punës nga mjekja F. Gj.

me pretendime personale dhe paragjykitime fetare. Nuk kemi patur rezultat me këto tentative për të përmbyllur qëllimin tonë stabilizimin e infermieres në ambjentet e punës. Ne si drejtori do të mundohemi të gjejmë një zgjedhje të favorshme për të dy palët në konflikt dhe do të ju informojmë në vazhdim në lidhje me ecurinë e ngjarjes”.

- 1.4** Në bazë të urdhërit Nr 53, datë 02.07.2013 “Për kryerjen e inspektimit pranë Drejtorisë së Shërbimit Spitalor Mat”, të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, u realizua në datën 08.07.2013 inspektimi pranë Qendrës Spitalore “Xhavit Mara” Burrel, me qëllim marrjen e informacionit lidhur me ngjarjen e publikuar në Gazetën Shqiptare të datës 06.06.2013. Me shkresën Nr.369/1 datë 02.07.2013 është realizuar komunikimi për palët e interesuar për kryerjen e inspektimit. Gjatë inspektimit ishin prezent Drejtori i Qendrës Spitalore “Xhavit Mara” Burrel, z. B. S. dhe znj. I. H.
- 1.5** z. B.S. komunikoi se me shkresën Nr.249/1 të datës 04.07.2013 ka informuar Znj. F.Gj. për datën dhe orën e inspektimit, por rezulton që kjo e fundit nuk ishte prezent gjatë inspektimit.
- 1.6** Me synimin për të trajtuar rastin në fjalë me objektivitet dhe në respektim të të drejtave të të gjithë subjekteve të përfshira, me datën 08.07.2013, u bënë përpjekje për të kontaktuar dhe komunikuar me mjeken znj. F. Gj., por ajo nuk ishte prezente në ambjentet e punës, pavarësisht informimit për datën dhe orën e takimit. Znj. F.Gj. u kontaktua në datën 16.08.2013 në numrin e telefonit të vënë në dispozicion nga Drejtoria e Shërbimit Spitalor Burrel, por ajo nuk pranoi të jepte asnjë sqarim.

2. FAKTE TË KONSTATUAR

- 2.1** Në bazë të procesverbalit datë 08.07.2013 të mbajtur gjatë këtij inspektimi, z. B.S. theksoi se: “Jam vënë në dijeni se gjatë kohës që znj. F.Gj. ka qenë me leje të zakonshme nuk ka lenë çelësin e dhomës së mjekut dhe nuk ka lejuar znj. I.H. të punojë në dhomën e mjekut”²¹. Nga Drejtori është dhënë një kopje e Vendimit Nr 20, datë 03.06.2013 përmes të cilit emëron znj. I. H. në detyrën e Infermieres pranë Mjekut Endokrinolog në Repartin e Poliklinikës (e papunësuar më parë) në vend të infermieres M.B, e cila del në pension.
- 2.2** Znj. I.H. sqaroi se incidenti kishte nisur më datën 03.06.2013 kur pas paraqitjes tek mjekja për t’i komunikuar emërimin, ajo nuk kishte shprehur konsiderata, por vetëm i kishte thënë që të largohej në shtëpi, se ajo (mjekja) do të bisedonte me drejtorin për emërimin e saj²². Ajo ishte paraqitur çdo ditë, por qëndrimi i mjekes kishte qenë i njëjtë. Theksojmë se sipas vendimit të emërimit marrëdhëniet financiare do të fillonin me datë 13.06.2013 me paraqitjen në punë të Znj.I.H. Sipas Znj. I.H. në periudhën pas konfliktit, rreth datës 10.06.2013, znj. Gj. kishte qenë me leje të zakonshme dhe kishte mbyllur me çelës dhomën e mjekut dhe nuk e kishte lejuar që të qëndronte edhe gjatë kohës që ajo vete (mjekja) nuk kishte qenë aty. Këto thënie përputhen edhe me sqarimet e dhëna nga Drejtori i Qendrës Spitalore “Xhavit Mara” Burrel, z. B. S.

²¹ Proces verbal i inspektimit administrative në prani të përfaqësuesit të Shërbimit Spitalor Burrel (z. B. S.-Drejtor), datë 08.07.2013.

²² Proces verbal i inspektimit administrative në prani të përfaqësuesit të Shërbimit Spitalor Burrel (znj. I. H.-Infermiere), datë 08.07.2013.

3. BAZA LIGJORE

- 3.1** Në nenin 1 të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010, parashikohet objekti i këtij ligji, duke u sanksionuar se: “Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me gjininë, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, **bindjet politike, fetare** ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzaninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicione gjenetike, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër.”
- 3.2** **Bindjet fetare**, është shkak për të cilin ligji ofron mbrojtje dhe bazuar në nenin 32/c të ligjit, Komisioneri ka kompetencë për të shqyrtuar shkelje që i bëhen zbatimit dhe respektimit të parimit të barazisë në lidhje me bindjet fetare.
- 3.3** Neni 18 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë sanksionon se të gjithë janë të barabartë përpara ligjit dhe ndalon diskriminimin e kujtdo ndër të tjera edhe për bindjet fetare.
- 3.4** Liria për të zgjedhur dhe shprehur individualisht apo kolektivisht, në publik ose në jetën private besimin fetar garantohet nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë në nenet 10 dhe 24 të saj. Kështu në nenin 10 të Kushtetutës parashikohet se: “Shteti është asnjans në çështjet e besimit e të ndërgjegjes dhe garanton lirinë e shprehjes së tyre në jetën publike”, ndërsa në nenin 24, pika 1, përcaktohet se: “Liria e ndërgjegjes dhe e fesë është e garantuar”, ndërkohë që “Secili është i lirë të zgjedhë ose të ndryshojë fenë ose bindjet, si dhe t’i shfaqë ato individualisht ose kolektivisht, në publik ose në jetën private, nëpërmjet kultit, arsimimit, praktikave ose kryerjes së riteve.”
- 3.5** Ligji nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi” ofron mbrojtje nga sjelljet diskriminuese në mënyrë të posaçme në fushën e punësimit. Neni 12, pika 1, gërmat “b” dhe “c” ndalojnë diskriminimin për të gjitha shkaqet e parashikuara në nenin 1 të këtij ligji edhe në “rekrutimin dhe përzgjedhjen e punëmarrësve” apo trajtimin e punëmarrësve në vendin e punës, duke përfshirë trajtimin e tyre gjatë vendosjes ose ndryshimit të kushteve të punës.....”.
- Në bazë të ligjit “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, punëdhënësi është i detyruar të zbatojë, të mbrojë e të nxisë parimin e barazisë dhe të ndalimit të çdo lloj diskriminimi²³; të rrisë ndërgjegjësimin për këtë ligj edhe duke e afishuar atë në mjediset publike të vendit të punës, si dhe të mundësojë kuptimin e plotë të tij me mjetet e veta ose me ndihmën e subjekteve të specializuara²⁴.
 - Në bazë të ligjit “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, punëdhënësi ka detyrimin ligjor “të marrë masat e nevojshme, përfshirë dhe masa disiplinore, për mbrojtjen e punëmarrësve nga diskriminimi dhe viktimizimi, brenda një muaji nga marrja e dijenisë”.
- 3.6** Diskriminimi përkufizohet nga ligji “Për mbrojtjen nga diskriminimi” në nenin 3, pika 1, si “çdo dallim, përjashtim, kufizim apo preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim apo pasojë pengesën apo bërjen e pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive

²³ Ligji nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, neni 13, pika 1/a.

²⁴ Ligji nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, neni 13, pika 2.

themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe me ligjet në fuqi.”

- 3.7** Në nenin 3, pika 5 e ligjit “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, parashikohet se në rastin e një sjelljeje të padëshiruar, kur lidhet me cilindo nga shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji, që ka për qëllim apo efekt cenimin e dinjitetit të personit dhe krijimin e një mjedisi frikësues, armiqësor, përcmues, poshtërues a ofendues për atë person, si dhe në rastin e një trajtimi më pak të favorshëm, i kryer si rezultat i kundërshtimit ose i mosnënshtrimit nga ana e personit të cenuar ndaj një sjelljeje të tillë, kemi të bëjmë me diskriminim të shfaqur në formën e “Shqetësimit”.
- 3.8** Neni 10 i Ligjit “Për mbrojtjen nga diskriminimi” përveçse parashikon shprehimisht si shkak për mbrojtjen nga diskriminimi bindjet fetare, ndalon diskriminimin *“lidhur me ushtrimin e lirisë së ndërgjegjes dhe fesë, veçanërisht kur ka të bëjë me shprehjen e tyre individualisht ose kolektivisht, në publik ose në jetën private, nëpërmjet kultit, arsimimit, praktikave ose kryerjes së riteve”* dhe çdo përjashtim nga ky rregull ligjor *“mund të lejohet vetëm kur ekziston një përligjje e arsyeshme dhe objektive”*.
- 3.9** Në nenin 3, pika 1, e ligjit “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, sanksionohet se kur një person apo grup personash trajtohen në mënyrë më pak të favorshme sesa një person tjetër, apo një grup tjetër personash në një situatë të njëjtë a të ngjashme, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, kjo përbën diskriminim të drejtpërdrejtë.
- 3.10** Bazuar në nenin 7 të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010, mbrojtja nga diskriminimi garantohet ndaj çdo veprimi apo mosveprimi si të një autoriteti publik, ashtu edhe çdo personi fizik apo juridik që merr pjese në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë.
- 3.11** Në proceset e aderimit në institucionet ndërkombëtare, Shqipëria ka nënshkruar një sërë aktesh ndërkombëtare, ndër të cilat është edhe Konventa Europiane e të Drejtave të Njeriut, e cila jo vetëm që është pjesë e e legjislacionit të brendshëm të Republikës së Shqipërisë, por zë një vend të veçantë brenda tij. Konventa njeh dhe parashikon kufizime të përgjithshme dhe kufizime specifike për të drejta të veçanta. Konkretisht, në nenin 9 pika 2 të saj është parashikuar se: *“Liria e shprehjes së fesë ose e bindjeve të tij nuk mund t’u nënshtrohet kufizimeve të tjera përveç atyre të parashikuara nga ligji dhe që përbëjnë masa të nevojshme në një shoqëri demokratike, për sigurimin publik, për mbrojtjen e rendit, të shëndetit ose të moralit publik, ose për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të të tjerëve”*.
- 3.12** Pra, Kushtetuta jo vetëm që mban të njëjtin qëndrim me Konventën, por nga ana tjetër në nenin 17 të Kushtetutës, përcaktohet se: *“Kufizime të të drejtave dhe lirive të parashikuara në këtë Kushtetutë mund të vendosen vetëm me ligj për një interes publik ose për mbrojtjen e të drejtave të të tjerëve. Kufizimi duhet të jetë në përpjesëtim me gjendjen që e ka diktuar atë”*.

4. OPINION

- 4.1** Sjelljet e mjekes në datën 03.06.2013 ndaj znj. I. H. dhe largimi i saj nga zyra, moslejimi i qëndrimit të kësaj të fundit në dhomën e mjekes ku znj. I. H. është emëruar, janë sjellje që në çënojnë dinjitetin e znj. I. H., përcmojnë, poshtërojnë

dhe e ofendojnë atë si person, duke mos lejuar që ajo të ushtrojë në baza të barabarta me të tjerët të drejtën e saj për punësim dhe profesion, për shkak të manifestimit të besimit fetar nga ana e znj. I. H.

- 4.2** Znj. H. është punësuar mbështetur në Kodin e Punës dhe Kontratën e Punës me Drejtorinë e Shërbimit Spitalor Burrel. Neni 9, pika 1 e Kodit të Punës së Republikës së Shqipërisë ndalon “*çdo lloj diskriminimi në fushën e marrjes në punë dhe të profesionit*”, ndërkohë që në pikën e dytë të kësaj dispozite diskriminimi trajtohet si “*çdo dallim, përjashtim ose parapëlqim që bazohet në racë, ngjyrë, seks, moshë, fe, bindje politike, origjinë kombëtare, origjinë shoqërore, lidhje familjare, të meta fizike ose mendore që cenon të drejtën e individit për të qenë i barabartë në punësim dhe trajtim*”. Sjelljet diskriminuese ndalohen nga Kodi i Punës ndër të tjera edhe në aspekte të tilla si “*zënia me punë dhe në profesione të ndryshme, si dhe kushtet e punësimit që lidhen me shpërndarjen e punës, kryerjen e saj, shpërblimin, ndihmën shoqërore, disiplinën ose përfundimin e kontratës së punës*”.
- 4.3** Nga legjislacioni në fuqi që rregullon fushën e marrëdhënieve të punësimit në rastin në fjalë nuk rezultojnë vendosur kufizime të tilla, fakt ky që do të na çonte drejt nevojës për të analizuar nëse për këto kufizime ka apo jo një përligje të arsyeshme dhe objektive. Ky konkluzion përforcohet edhe nga fakti i emërimit të znj. I.H. si infermiere pranë Qendrës Spitalore “Xhavit Mara” Burrel, strukturë e Drejtorisë së Shërbimit Spitalor Burrel.
- 4.4** Në punësim, çdo punëmarrës ka të drejtë të ankohet te punëdhënësi, te Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ose në gjykatë, nëse beson se ka pësuar diskriminim²⁵. Rezulton se znj. I.H. e ka ushtruar të drejtën e saj për t’u ankuar pranë punëmarrësit.
- 4.5** Rezulton se znj. I.H. vazhdon punën si infermiere pranë Poliklinikës, por ajo vazhdon të mos qëndrojë te dhoma e mjekes ku është emëruar, pra tek znj. F. Gj., por në një dhomë tjetër të Poliklinikës, pra ndryshe nga sa ndodh zakonisht që infermieri/ja qëndron në dhomën e mjekut ku ka emërimin.
- 4.6** Pra, punëdhënësi i znj. I.H., **Drejtoria e Shërbimit Spitalor Burrel ka dështuar për të garantuar mbrojtjen e saj nga diskriminimi për shkak të manifestimit të besimit të saj fetar, si dhe ka dështuar për të garantuar të drejtën kushtetuese të shtetases në fjalë për të shprehur dhe manifestuar në publik besimin fetar.**
- 4.7** Rezultoi e provuar se ka një diferencë në trajtimin e znj. I.H., e cila ndryshe nga punonjës të tjerë infermierë, të cilët qëndrojnë në dhomën e mjekut pranë të cilit kanë marrë emërimin, vazhdon të qëndrojë pranë një mjeku tjetër dhe jo pranë mjekes ku ka emërimin. Pavarësisht mungesës të qëllimeve diskriminuese nga ana e punëdhënësit Drejtorisë së Shërbimit Spitalor Burrel ndaj znj. I.H., ky i fundit jo vetëm që ka dështuar për ta mbrojtur këtë të fundit nga sjelljet diskriminuese të punonjësve të tjerë, por mosveprimi nga ana e tij (mungesa e veprimeve efektive), kanë sjellë si pasojë që znj. I.H. të pengohet dhe të mos ushtrojë në mënyrë të barabartë me punonjësit e tjerë infermierë, vetëm për shkak të shfaqjes në publik të besimit të saj fetar.
- 4.8** Për këtë arsye, mosveprimi i Drejtorisë së Shërbimit Spitalor Burrel, për të eliminuar pasojat negative dhe trajtimin ndryshe të punonjës, znj. I.H., përbëjnë diskriminim të drejtpërdrejtë, për shkak të bindjeve të saj fetare.
- 4.9** Edukimi i publikut për respektimin e barazisë dhe mosdiskriminimit mbetet një ndër sfidat kryesore për të cilën duhet

²⁵ Ligji nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, neni 15/1.

të angazhohen të gjithë aktorët që mbartin detyrime ligjore përkatëse sipas Ligjit. Kjo çështje që po shqyrtojmë është tregues që duhet të jemi të vëmendshëm dhe të kujdesshëm në trajtimin e marrëdhënieve të punësimit mbi bazën e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit për shkak të bindjeve fetare. Bashkëjetesa fetare është një vlerë për shoqërinë shqiptare, e cila duhet ruajtur dhe ushqyer si një model i mirë për të ndërtuar raportet mes komuniteteve të ndryshme përmes tolerancës dhe respektimit të të drejtave të çdo individi, pavarësisht cilësive individuale apo përkatësisë në një grup të veçantë që na dallon nga pjesa tjetër e shoqërisë.

4.10 Komisioneri konstaton:

- diskriminimin në formën e “shqetësimit” në fushën e punësimit, për shkak të bindjeve fetare të znj. I. H. me detyrën “infermiere”, nga znj. F. Gj. me detyrë “mjeke endokrinologe” pranë Shërbimit Spitalor Burrel.
- “diskriminimin e drejtpërdrejtë” në fushën e punësimit, për shkak të bindjeve fetare të znj. I. H., nga Drejtoria e Shërbimit Spitalor Burrel.

5 REKOMANDIMET

- 5.1 Detyrimin e znj. F. Gj. për të ndaluar në mënyrë të menjëhershme sjelljet dhe veprimet diskriminuese ndaj znj. I. H. Në zbatim të nenit 33, pika 11, të ligjit nr. 10 221, datë 04. 02. 2010, “*Për mbrojtjen nga diskriminimi*”, detyrohet znj. F. Gj., që brenda 30 (tridhjetë) ditëve të njoftojë Komisionerin, lidhur me veprimet e marra për zbatimin e këtij vendimi.
- 5.2 Detyrimin e Drejtorisë së Shërbimit Spitalor Burrel të marrë masa të menjëhershme për të eliminuar trajtimin ndryshe të znj. I. H. dhe garantimin e ushtrimit në mënyrë të barabartë me të tjerët të detyrës së saj si infermiere.
- 5.3 Detyrimin e Drejtorisë së Shërbimit Spitalor Burrel që në zbatim të nenit 13, germa “b” të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “*Për mbrojtjen nga diskriminimi*” dhe legjislacionit që rregullon marrëdhëniet e punës midis këtij punëdhënësi dhe znj. F. Gj., të marra masa disiplinore ndaj Znj. F. Gj., për shkelje të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “*Për mbrojtjen nga diskriminimi*”.
- 5.4 Në zbatim të nenit 33, pika 11, të ligjit nr. 10 221, datë 04. 02. 2010, “*Për mbrojtjen nga diskriminimi*”, detyrohet Drejtoria e Shërbimit Spitalor Burrel, që brenda 30 (tridhjetë) ditëve të njoftojë Komisionerin, lidhur me veprimet e marra për zbatimin e këtij vendimi.
- 5.5 Në referim të nenit 33, pika 11 e ligjit nr. 10 221, datë 04. 02. 2011, “*Për mbrojtjen nga diskriminimi*”, moszbatimi i këtij vendimi sjell si pasojë ndëshkimin me gjobë sipas parashikime të bëra në pikën 13 të po këtij neni.

VII. ÇËSHTJE TË DISKRIMINIMIT NË FUSHËN E ARSIMIT

ANKESA E PARAQITUR NGA AMBASADA PINK/LGBT PRO SHQIPËRI KUNDËR AUTORËVE TË LIBRIT “MJEKËSIA LIGJORE”, Z. S.M DHE Z. B.Ç, NË TË CILËN PRETENDOHET SE TEKSTET UNIVERSITARE DISKRIMINOJNË DHE PARAGJYKOJNË HAPUR KOMUNITETIN LGBT NË SHQIPËRI.

VENDIM Nr. 27/2012

Diskriminimi i komunitetit LGBT në tekstin e librit “Mjekësia Ligjore”, me autorë: Prof.Dr. S.M. dhe Prof.Dr. B.Ç., ku përdoren terma dhe informacione diskriminuese, jo shkencore dhe fyese për komunitetin LGBT, si dhe studentët e Fakulteteve të Mjekësisë dhe Drejtësisë të Universitetit të Tiranës po marrin njohuri të gabuara të cilat do të ndikojnë në formimin e tyre si mjekë dhe juristë të ardhshëm.

1. PROÇEDURA E NDJEKUR

- 1.1 Me shkresën Nr. 441 Prot, datë 09.11.2012 u njoftuan subjektet ndaj të cilëve është bërë ankesë duke vënë në dijeni palët për fillimin e procedurave të shqyrtimit të ankesës.
- 1.2 Me shkresën Nr. 446 Prot, datë 13.11.2012 subjekteve kundër të cilëve është bërë ankesa ju kërkua që të paraqesin parashtrime me shkrim në përgjigje të ankesës së bërë.
- 1.3 Me shkresën Nr. 1495/4 Prot, datë 19.11.2012, Fakulteti i Drejtësisë i është drejtuar Komisionerit me informacionin e kërkuar në të cilën sqarohet se: “Lënda Mjekësi Ligjore për shkak të specifikës së natyrës mjekësore të saj ofrohet nga Departamenti i Mjekësisë Ligjore pranë Fakultetit të Mjekësisë. Po kështu dhe programi mësimor i kësaj lënde detyrimisht vjen i miratuar prej këtij Fakulteti”. Për verifikimin e pretendimeve të bëra në ankesë, Fakulteti i Drejtësisë i është drejtuar autorit të librit, Prof. S.M në të cilën i ka kërkuar informacion për këtë çështje. Me shkresën Nr. 1495/2, datë 14.11.2012, Prof.Dr.S.M konfirmon se: është e vërtetë që teksti i sipërcituar në faqet 140-141 përmban koncepte aktualisht jo të pranueshme nga Organizata Botërore e Shëndetësisë mbi përdorimin e termit perversion seksual.

- 1.4** Për të vërtetuar pretendimet e ankesës zyra e Komisionerit bëri verifikimet e tekstit “Mjekësia Ligjore”. Në analizën e tekstit mësimor “Mjekësia Ligjore”, Tiranë 2007 me autor Prof. Dr.S. M, si dhe tekstit “Mjekësia Ligjore” botuar nga shtëpia botuese “Arbëria” me autorë Prof. Dr S.M dhe Prof. Dr B. Ç me ISBN: 999 27-796-9-1 ribotim i viteve të fundit, Komisioneri konstatoi:

2. FAKTE TË KONSTATUARA NGA KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

- 2.1** Në tekstin mësimor “Mjekësia Ligjore” Tiranë 2007 në faqe 140 shkruhet:
“Perversionet seksuale janë shmangie nga norma të motivit seksual si pasojë e patologjive organike dhe çrregullimeve psikike dhe psikologjike të një individi të caktuar. Individet që vuajnë nga këto çrregullime janë të prirur të kryejnë krime seksuale apo vepra penale kundër moralit dhe dinjitetit, përmes sjelljeve dhe veprimeve të padenja në shoqëri. Disa nga llojet e perversioneve seksuale që hasen më shpesh në praktikë janë: Homoseksualizmi, fetishizmi, eksibicionizmi, sadizmi dhe mazoshizmi, skoptofilia, zoofilia dhe nekrofilia.
- 2.2** Në tekstin “Mjekësia Ligjore” të shtëpisë botuese “Arbëria” në faqe 141 shkruhet:
“Perversionet seksuale janë shmangie nga norma e instiktit seksual..... Disa nga perversionet seksuale që hasen më shpesh janë: a) Homoseksualizmi është prirja për epsh seksual me persona të të njëjtit seks. Pederastia parashikohet si krim nga Kodi Penal dhe qëndron në kryerjen e bashkimit seksual ndërmjet.....
- 2.3** Në analizimin e teksteve në fjalë në të cilën autorët në parathënie të ribotimit shkruajnë se: *“kanë bërë përpjekje për një azhurnim të kësaj disipline me legjislacionin e ri të 10 viteve të fundit në vendin tonë”.*

3. BAZA LIGJORE

- 3.1** Bazuar në nenin 3 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë shteti garanton mbrojtjen e dinjitetit të njeriut dhe respektimin e lirive dhe të drejtave të tij.
- 3.2** Nenit 14 i Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, parashikon mbrojtjen nga diskriminimi në gëzimin e të drejtave dhe lirive themelore.
- 3.3** Rekomandimi CM/Rec(2010)5 paragrafi 32i Këshillit të Ministrave parashikon detyrimin për shtetet anëtare për marrjen e masave për të luftuar diskriminimin për shkak të orientimit seksual ose identitetit gjinor.
- 3.4** Shqipëria si vend anëtar i Këshillit të Evropës, duhet të marrë masa dhe për zbatimin e pikës VI të Rekomandimit të Këshillit të Ministrave të KiE, CM/REC(2010)5, ku trajtohen çështje mbi arsimin, në të cilin përcaktohet se: *“Duke marrë parasysh mbi të gjitha interesat e fëmijës, duhet të merren masat e duhura për këtë çështje në të gjitha nivelet për të nxitur tolerancën dhe respektin e ndërsjellët në shkolla, pavarësisht orientimit seksual apo identitetit gjinor. Kjo duhet të përfshijë sigurimin e informacionit objektiv në lidhje me orientimin seksual dhe identitetin gjinor, për shembull në kurrikulat shkollore dhe materialeve arsimore, si dhe sigurimin e nxënësve*

dhe studentëve me informacionin e nevojshëm, mbrojtjen dhe mbështetjen për të mundësuar që ata të jetojnë në përputhje me orientimin e tyre seksual dhe identitetin gjinor”.²⁶

- 3.5** Në nenin 1 të ligjit nr. 10221/2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi” parashikohet se: *“Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me gjininë, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzaninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicione gjenetike, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”*. Orientimi seksual dhe identiteti gjinor, janë shkaqe të cilat gëzojnë mbrojtje nga ligji.
- 3.6** Bazuar në nenin 32/1/a të ligjit, Komisioneri ka kompetencë për të shqyrtuar shkelje që i bëhen zbatimit dhe respektimit të parimit të barazisë në lidhje me orientimin seksual dhe identitetin gjinor.
- 3.7** Bazuar në nenin 17/1/c të ligjit nr. 10221/2010 *mbrojtja nga diskriminimi në fushën e arsimit, ndalohej çdo dallim, kufizim ose përjashtim që bazohet në shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji dhe që, ndër të tjera, ka lidhje me: c) përmbajtjen e parimeve dhe kritereve të veprimtarisë arsimore, duke përfshirë programet mësimore dhe metodat e mësimdhënies.*

4. OPINIONI I KOMISIONERIT MBI FAKTET E KONSTATUARA

- 4.1** Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi synon respektimin me rigorozitet të parimit të barazisë përpara ligjit, barazi të shanseve dhe mundësive për të ushtruar të drejtat dhe liritë, si dhe zbatimin e efektshëm të politikave anti-diskriminuese, sidomos për sa i përket komunitetit LGBT, në Shqipëri.
- 4.2** Autorët pavarësisht se theksojnë përditësimin e informacionit shkencor nuk kanë pasqyruar në literaturën në fjalë faktin se homoseksualizmi është dekriminalizuar që nga viti 2001 me ligjin nr.8733, datë 24.01.2001, dhe që prej vitit 1990 Organizata Botërore e Shëndetësisë e ka hequr homoseksualitetin nga Klasifikimi Ndërkombëtar i Statistikave të Sëmundjeve dhe Problemeve lidhur me shëndetin.
- 4.3** Referuar sa më sipër, përcaktime të tilla që homoseksualizmin e përfshijnë në grupin e perversioneve seksuale përbën një përcaktim të gabuar, jo shkencor dhe diskriminues për shkak të orientimit seksual dhe identitetit gjinor. Dhënia e këtyre koncepteve studentëve në auditorë krijon perceptime të gabuara për këtë kategori duke ndikuar pastaj në formimin e këtyre studentëve si mjekë dhe juristë të ardhshëm.
- 4.4** Komisioneri vlerëson se përmbajtja e tekstit në fjalë përbën shqetësim, krijon ndjenjën e fyerjes dhe cënon dinjitetin e këtij komuniteti duke bërë që dhe perceptimi nga personat e tjerë për këtë kategori të jetë diskriminues.

²⁶ Përkthim i Komisionerit

- 4.5** Komisioneri konstaton diskriminimin e komunitetit LGBT përmes përmbajtjes së tekstit “Mjekësia Ligjore” me autorë Prof. Dr. S.M. dhe Prof.Dr. B.Ç., për shkak të orientimit seksual dhe identitetit gjinor.

5. REKOMANDIMI

- 5.1** Detyrimin e autorëve si persona të cilët kanë konsumuar sjelljen diskriminuese si më sipër, që brenda 60 (gjashtëdhjetë) ditëve nga marrja dijeni për këtë vendim të bëjnë modifikimin ose në rastin kur nuk është i mundur të bëjnë heqjen nga tregu dhe nga bibliotekat e institucioneve të këtij libri.
- 5.2** Detyrohen autorët, Prof. Dr. S.M. dhe Prof. Dr. B.Ç., që brenda 30 (tridhjetë) ditëve të njoftojë Komisionerin, lidhur me veprimet e ndërmarra për zbatimin e këtij vendimi duke depozituar dhe një kopje të librit me ndryshimet e bëra.
- 5.3** Në referim të nenit 33/11 të ligjit nr. 10221/2010, “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, moszbatimi i këtij vendimi sjell si pasojë ndëshkimin me gjobë sipas parashikimeve të bëra në pikën 13 të po këtij neni.

VIII. ÇËSHTJE TË DISKRIMINIMIT NË FUSHËN E PUNËSIMIT

ANKESA E ZNJ. F. K ME NR. REGJISTRI 7, DATË 13.03.2012, KUNDËR Z. A.SH, DREJTOR, DREJTORIA RAJONALE SHËNDETËSORE FIER, KU PRETENDOHET PËR DISKRIMINIM NË PUNËSIM PËR SHKAK TË GJENDJES ARSIMORE, GJENDJES SHËNDETËSORE DHE ÇDO SHKAK TJETËR

VENDIM Nr.13/2012

Sipas shpjegimeve të dhëna nga znj. F.K., rezulton se ajo ka qenë e punësuar pranë Drejtorisë Rajonale Shëndetësore (DRSH) Fier që nga viti 1984. Marrëdhëniet e punës kanë vazhduar normalisht deri në kohën kur ka denoncuar shkeljet pranë këtij institucioni. Ankuesja shprehet se ka bërë denoncime në disa institucione për emërim të padrejtë të z. F.Ç., në pozicionin e zv drejtorit ekonomik për këtë shkak ankuesja pretendon se është diskriminuar dhe viktimizuar.

1. PROÇEDURA E NDJEKUR

- 1.1** Më datën 26.03.2012, me shkresën nr. Prot 96, është bërë njoftimi i z. A.Sh. në lidhje me ankesën drejtuar ndaj tij me pretendimin për diskriminim të znj. F.K.
- 1.2** Bazuar në shkresën Nr. 149 Prot, datë 30.04.2012 kryhet inspektimi me datë 03.05.2012²⁷.
- 1.3** Në lidhje me interesimin e grupit të inspektimit për verifikimin e disa dosjeve, procedurat e emërimit tëpunonjësve si dhe shqyrtimit të librit të proces verbaleve të mbledhjeve, N/drejtores znj. Sh.K. u përgjigj se Përgjegjësi i zyrës së burimeve njerëzore, z. S.M., dhe punonjësja e arshivës znj.F.C. nuk janë

²⁷ Objekti i këtij inspektimi ishte:

- Organizimi, funksionimi dhe struktura analitike e DRSh Fier
- Libri i proces verbalit të mbledhjeve për periudhën Qershor 2009 – Qershor 2011
- Procedura e emërimit të Z. F.Ç në pozicionin, zv.Drejtor Ekonomik dhe Përgjegjës i Sektorit të Informacionit Shëndetësor
- Procedura e emërimit dhe kriteret e punësimit në pozicionin infermier
- Hetim pranë sektorit të administratës dhe shërbimeve mbi ecurinë e marrëdhënieve financiare të znj. F. K për periudhën 01.02.2011 deri në përfundim të marrëdhënieve të punës
- Verifikimin e disa dosjeve të punonjësve të DRSh Fier
- Urdhri nr.3, datë 21.03.2011, “Për shkarkimin nga detyra të p/sek të informacionit shëndetësor”,

në punë, sepse janë me leje të zakonshme dhe me raport, por dokumentet e kërkuara do vihen në dispozicion sapo këto punonjës të kthehen në punë. Me shkresën nr. 317, datë 17.05.2012, DRSH Fier dërgoi dokumentet e kërkuara gjatë inspektimit të datës 03.05.2012²⁸.

- 1.5 Me datë 11.07.2012, subjekti ankues znj. F.K u paraqit pranë zyrave të KMD dhe kërkoi që ankesa saj të shqyrtohej vetëm në lidhje me diskriminimin për shkak të gjendjes arsimore dhe mosnjohjes së diplomës së shkollës së lartë.

2. FAKTE TË KONSTATUARA NGA KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

- 2.1 Gjatë inspektimit nga ana e inspektorëve u kërkuar të viheshin në dispozicion faktet dhe provat për thyerjen e etikës në punë nga ana e znj. F. K., si dhe faktet dhe provat për punë të dobët dhe përmirësimi i punës në sektorin e Informacionit Shëndetësor pas shkarkimit të znj. F.K. Në përgjigje të këtij interesimi znj. B.Zh. (juriste e institucionit) informoi se përsa i përket thyerjes së etikës në punë duhet ti adresoheni Ministrisë së Shëndetësisë, sepse ato disponojnë shkresat e paraqitura nga ana e znj. F.K. Në lidhje me përmirësimin e ecurisë në punë pas shkarkimit të znj. F. K. na informoi se nuk kishin pasur më ankesa nga punonjësit e këtij sektori, por nuk kishte prova me shkrim të këtyre ankesave duke shpjeguar se ankesat ishin bërë me gojë. Znj.B.Zh deklaroi se për këto shpjegime që kërkohen ajo do komunikojë me punonjësit e DRSH Fier si dhe me Ministrinë e Shëndetësisë dhe sapo ti disponojnë do ti vinte në dispozicion të KMD-së.²⁹ Drejtori i DRSH Fier, z.A.Sh. na shpjegoi se: *“nuk kemi prova për të argumentuar se znj. F.K. ka thyer etikën”* por sipas dëshmive të punonjësve prezent gjatë inspektimit, na u vu në dijeni se znj. F.K. nuk ka pasur sjellje njerëzore në punë dhe marrëdhënie të mira me punonjësit e tjerë të institucionit³⁰.
- 2.2 DRSH Fier si gjatë inspektimit dhe në vazhdimësi të korrespondencës me to nuk ka arritur të vendosë në dispozicion të Komisionerit prova mbi thyerjen e etikës nga ana e znj. F.K. Prova e vetme së cilës i është referuar drejtori i DRSH Fier për marrjen e vendimit të shkarkimit të punonjësës F.K. është shkresa e dërguar nga Ministria e Shëndetësisë, Drejtoria e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore dhe Edukimit në Vazhdim, me nr.1055, datë 16.03.2011, me lëndë: *“Letër sqaruese, në të cilën vihet në dijeni DRSH Fier se znj. F.K. me shkresat dhe e-maillet e dërguara në drejtim të MSH ka shkelur rregullat e etikës të administratës publike duke cënuar figurën e eprorëve dhe duke tejkaluar kompetencat e saj. Për të faktuar shkeljen e etikës së bërë nga znj. F.K. nuk u paraqit asnjë provë shkresore nga ana e DRSH Fier, si autoriteti që ka marrë dhe masën disiplinore në drejtim të znj. F.K.”*.

²⁸ Dosja e punonjësës znj. F.K

Dosja e punonjësit z. F.C

Dosja e punonjësit z. K.Ki (emëruar Nd/epidemiolog në Qendrën Shëndetësore Portëz

Analiza vjetore e punës për vitin 2010, DRSH Fier

Blloku i proces verbaleve të mbledhjeve të mbajtura për vitin 2010

²⁹ Referuar proces verbalit të inspektimit datë 03.05.2012

³⁰ Referuar proces verbalit të inspektimit datë 03.05.2012

- 2.3** Ndërsa nga ana e subjektit ankues na u vunë në dispozicion këto tre shkresa të cilat faktojnë shqetësimet e ngritura nga znj. F. K për shkeljet e ndodhura³¹: Në të tri këto shkresa denoncohet nga ana e znj. F.K. emërimi pa arsimin përkatës të N/drejtorit ekonomik z.F.Ç., fakt ky i konstatuar dhe nga kontrolli i ushtruar nga KLSH në DRSH Fier, i cili me shkresën nr.2011, datë 26.04.2011 rekomandon Ministrisë së Shëndetësisë marrjen e masës administrative “Largim nga detyra të zëvendës drejtorit ekonomik të DRSH Fier, z. F. Ç. dhe kërkimin në rrugë ligjore të kthimit të dëmit ekonomik të shkaktuar nga pagesa e kundërligjshme”. Faktin e emërimit të padrejtë të z. F. Ç. në pozicionin e nëndrejtorit ekonomik e ka pranuar dhe vetë drejtori z.A.Sh. nëpërmjet Vendimit nr. 279, datë 21.03.2011 duke pranuar rekomandimin e KLSH për lirim të z.F.Ç. nga ky pozicion.
- 2.4** Përsa i përket përmirësimit të ecures së punës në sektorin e informacionit shëndetësor nuk ka prova që të mbështesin vendimin e drejtorit z.A.Sh për përmirësim të punës në këtë sektor. Në dosjen personale të punonjësës. F.K. pranë sektorit të burimeve njerëzore nuk ka asnjë shkresë në të cilën të faktohet se ndaj kësaj punonjëse të ishte marrë ndonjë masë si këshillim apo vërejtje. Po ashtu, dhe gjatë shqyrtimit të bllokut të proces verbaleve të mbledhjeve të mbajtura për vitin 2010, nuk ka prova që të faktohet puna e dobët në këtë sektor dhe nevoja për përmirësime në drejtim të drejtueses së këtij sektori. Gjithashtu dhe në raportin final të auditimit nr. 2928/3 datë 04.10.2011 të hartuar nga Drejtoria e Auditit të Brendshëm të Ministrisë së Shëndetësisë për periudhën qershor 2009 – korrik 2011 nuk ka ndonjë vërejtje në drejtim të znj. F.K. dhe sektorit të informacionit shëndetësor, kështu që dhe pretendimi i ngritur kundër znj. F.K. lidhur me përmirësimin e ecures së punës në sektorin e informacionit shëndetësor ngelet i paprovuar nga DRSH Fier.
- 2.5** Sipas dokumentacionit të dërguar nga DRSH Fier, Urdhrit nr. 733, datë 10.11.2008, znj. F.K rezultoi e diplomuar në Universitetin “Aleksandër Xhuvani”, Elbasan në Fakultetin Ekonomik, dhe pas datës 05.10.2008 ajo është paguar si punonjëse me arsim të lartë. Bazuar në Vërtetimin nr. 442, datë 16.05.2011 të lëshuar nga DRSH Fier, shohim se në pozicionin si N/epidemiologe znj.F.K do trajtohej me një pagë prej 38100 lekë/muaj në diferencë me pagën që përfitonte si p/sektorit të informacionit shëndetësor prej 52000lekë/muaj.
- 2.6** Në përgjigjet e DRSH Fier për këtë rast, referuar shkresës nr.210/1, datë 27.04.2012, argumenti i vetëm që përdor kjo drejtori për emërimin e znj. F.K në pozicionin e ri është *përvoja e punës si infermiere prej 28 vjetësh*, por që nuk i referohet faktit që znj. F.K, nuk ishte e diplomuar si infermiere dhe kishte 5 vite e shkëputur nga ajo përvojë pune, fakt ky i deklaruar nga znj. F.K me anë të shkresës drejtuar drejtorit z. A.Sh me datë 08.04.2011 (vërtetuar me dëftesë postare N. 036797).

³¹ Shkresë drejtuar Kryeministrit, Z. S. B., datë 24.09.2010 (dëftesë posta shqiptare)

Shkresë drejtuar Ministrit të Shëndetësisë, Z. P. V., datë 24.09.2010 (dëftesë posta shqiptare)

Shkresë denoncim e znj. F.K., datë 09.02.2011 drejtuar z. R.C, Kryetar i Kontrollit të Lartë të Shtetit

3. BAZA LIGJORE

- 3.1** Ligji 10221/2010 “*Për mbrojtjen nga diskriminimi*” në Nenin 12, pika c), parashikon ndalimin e diskriminimit që ka lidhje me trajtimin e punëmarrësve në vendin e punës, duke përfshirë trajtimin e tyre gjatë vendosjes ose ndryshimit të kushteve të punës, shpërblimin, përfitimet dhe mjedisin e punës, trajtimin lidhur me trajnimet profesionale ose gjatë procesit disiplinor apo lidhur me pushimin nga puna ose zgjidhjen e kontratës së punës.
- 3.2** Ligji 10221/2010 “*Për mbrojtjen nga diskriminimi*” ka parashikuar në nenin 3/8 se: ***trajtim i disfavorshëm apo pasoja negative, që vjen si reagim ndaj një ankimi a një procedimi që synon zbatimin e parimit të barazisë është “Viktimizim”.***
- 3.3** Ligji 10221/2010, “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*” Kreu II, Mbrojtja nga diskriminimi në punësim, Neni 12/1, pika a) dhe b), Ndalimi i diskriminimit, parashikon shprehimisht se “1. Ndalohet diskriminimi i personit në lidhje me të drejtën e tij për punësim. Diskriminimi përfshin çdo dallim, kufizim ose përjashtim që bazohet në shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji dhe që, ndër të tjera, ka lidhje me: a) shpalljen e vendeve të lira të punës, b) rekrutimin dhe përzgjedhjen e punëmarrësve”.
- 3.4** Ligji ka parashikuar në nenin 3/1 se çdo dallim, përjashtim, kufizim apo preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim apo pasojë pengesën apo bërjen e pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe me ligjet në fuqi, përbën diskriminim.
- 3.5** Gjendja arsimore është një nga shkaqet e mbrojtura nga ligji 10221/2010, (Neni 1), Kreu II, Mbrojtja nga diskriminimi në punësim, Neni 12, Ndalimi i diskriminimit parashikon: “1. Ndalohet diskriminimi i personit në lidhje me të drejtën e tij për punësim. Diskriminimi përfshin çdo dallim, kufizim ose përjashtim që bazohet në shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji dhe që, ndër të tjera, ka lidhje me:
c) trajtimin e punëmarrësve në vendin e punës, duke përfshirë trajtimin e tyre gjatë vendosjes ose ndryshimit të kushteve të punës, shpërblimin, përfitimet dhe mjedisin e punës, trajtimin lidhur me trajnimet profesionale ose gjatë procesit disiplinor apo lidhur me pushimin nga puna ose zgjidhjen e kontratës së punës.
- 3.6** Kriteret e punësimit në pozicionin infermier në DRSh Fier përcaktohen përmes:
- Urdhrit nr. 291, datë 20.07.2007 “*Për kriteret e punësimit në shërbimin shëndetësor publik*”, pika 1, “*punësimi në institucionet shëndetësore të bëhet vetëm nëpërmjet konkurrimit të hapur, bazuar në kritere të unifikuar*”, dhe në vazhdim,
 - Shkresës nr.887/1, datë 17.03.2008, drejtuar, Drejtorisë së Shëndetit Publik Fier nga Ministria e Shëndetësisë, Drejtoria e Shëndetit Publik, me lëndë: Kujtesë për kriteret e punësimit të infermierëve në të cilën në mes të tjerave shkruhet se: *në kriteret e punësimit të personelit infermier duhet të përfshihet diploma e shkollës së lartë në infermieristikë*, si dhe kriteret që duhet të plotësojnë kandidatët të shpallur në buletin e Agjencisë së Prokurimit Publik të datës 06.06.2011, në të cilën shpallet kriteri kryesor: *Të jenë diplomuar në Fakultetin e Infermierisë.*

4. OPINION

- 4.1** Bazuar në rregulloren “Për organizimin dhe funksionimin e drejtorisë shëndetit publik të qarkut” nr. 2752, datë 23.07.2007 të lëshuar nga Ministria e Shëndetësisë, kreu III, Misioni i organeve drejtuese të DSHQP, parashikon se Drejtori, “emëron dhe liron shefat e sektorit dhe punonjësit brenda strukturës organizative të DSHQP duke zbatuar Udhëzimin e Ministrit të Shëndetësisë “Për kriteret e punësimit në shërbimin shëndetësor publik” dhe kodin e punës. Për shkelje të disiplinës në punë, për shkaktarët, aplikon masa administrative mbështetur në “Kontratën kolektive të punës”. Drejtori z.A.Sh i ka kompetencat për të shkarkuar p/sektorit por, duke qenë se znj. F.K kishte ngritur një problematikë për rastin e emërimit të pamerituar (sipas saj) duhej të kishte ndjekur procedurat e parashikuara në Kodin e Punës në Neni 144. Urdhri nr. 3, datë 21.03.2011, përbën një masë ekstreme të marrë në drejtim të punonjës F.K.
- 4.2** Bazuar në Urdhrin nr 291, datë 20.07.2007 “Për kriteret e punësimit në shërbimin shëndetësor publik”, mendojmë se Vendimi nr. 279, datë 21.03.2011 për emërimin e z. F.Ç në pozicionin e P/sektorit të Informacionit Shëndetësor është diskriminues sepse nuk janë zbatuar rregullat mbi punësimin në sistemin shëndetësor: konkurrimi i hapur, njoftimi për vendet e lira të punës dhe kërkesat e detyrueshme për të konkurruar. Duke mos përdorur këto kriteret DRSF Fier ka krijuar mundësinë për të vendosur praktika diskriminuese në lidhje me trajtimin e barabartë të individëve.
- 4.3** Bazuar në VKM nr. 606, datë 08.07.2010 për një ndryshim në vendimin nr.306, datë 27.06.2002 të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e strukturës dhe të nivelit të pagave të punonjësve me arsim të lartë në sistemin e MSH dhe” lidhja 1 (kreu 1.2) pozicioni Shef sektori, paga e grupit 12000 lekë, si dhe sipas shkresës nr. 1086, datë 08.09.2010 “Mbi zbatimin e vendimeve të reja të pagave” në të cilën përcaktohet Grupi I, përputhet me DND ose DIND, mendojmë se Vendimi nr. 279, datë 21.03.2011 për emërimin e z. F.C në pozicionin e P/sektorit të Informacionit Shëndetësor është diskriminues sepse kërkesa për këtë vend pune i përket diplomës së shkollës së lartë DND ose DIND si dhe bazuar në dokumentacionet që ndodhen në dosjet personale të znj. F.K dhe z. F.C vërejmë se diploma e znj. F.K është diplomë e nivelit më të lartë se ajo e z. C dhe mosmarrja parasysh e këtij fakti përbën diskriminim për shkak të gjendjes arsimore.
- 4.4.** Mosnjohja e diplomës së shkollës së lartë dhe trajtimi me pagë më të ulët të punonjës F.K. Urdhri nr. 3, datë 21.03.2011 për shkarkimin e znj. F.K. nga detyra e përgjegjës së informacionit shëndetësor dhe emërimit të saj në pozicionin e N/Epidemiologe pranë Qendrës Shëndetësore Portëz nuk ka marrë parasysh diplomën e shkollës së lartë të znj. F.K. por i është referuar eksperiencës së punës që ka pasur ankuesja më përpara, gjithashtu dhe për trajtimin në pagë nuk është pasur parasysh diferencimi në pagë pasi punonjësja do të trajtohej si punonjëse me arsim të mesëm.
- 4.5** Vërejmë se për emërimin e znj. F.K. në pozicionin nd/epidemiologe, nuk janë respektuar procedurat e punësimit të punonjësve mbi bazën e konkurrimit si dhe janë përdorur kriteret e tjera duke e trajtuar ndryshe nga kandidatët e tjerë. Trajtimi ndryshe vërtetohet dhe nga praktika e punësimit e ndjekur nga DRSF Fier për punësimin e punonjës z. K.K. Mosnjohja e diplomës së shkollës së lartë të znj. F.K. ka sjellë dhe diskriminimin e saj.

- 4.6** Komisioneri konstaton diskriminimin e znj. F.K, nga z. A.Sh, Drejtor i Drejtorisë Rajonale Shëndetësore Fier, në formën e viktimizimit për shkak të denoncimeve të bëra nga ana e saj.

5. REKOMANDIM:

- 5.1** Rekomandojmë kthimin në vendin e punës të znj. F.K.

- 5.2** Bazuar në nenin 33 pika 11, brenda 30 ditëve duhet të raportoni para Komisionerit për masat e marra për zbatimin e këtij vendimi.

IX. ÇËSHTJE TË DISKRIMINIMIT NË FUSHËN E TË MIRAVE DHE SHËRBIMEVE.

ANKESA E PARAQITUR NGA ORGANIZATA “ALEANCA KUNDËR DISKRIMINIMIT LGBT” KUNDËR SUBJEKTIT PRIVAT RESTORANT PIZZERI “K” PËR PRETENDIMIN PËR DISKRIMINIM PËR SHKAK TË ORIENTIMIT SEKSUAL NË FUSHËN E TË MIRAVE DHE SHËRBIMEVE.

VENDIMI Nr. 5 / 2014

1. PROCEDURA E NDJEKUR

- 1.1 Organizata “Aleanca Kundër Diskriminimit LGBT” në emër të dy aktivistëve të kësaj organizate paraqiti ankesën pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi. Organizata “Aleanca Kundër Diskriminimit LGBT” në ankesë shpjegon: “Me datë 18.10.2013, rreth orës 21.40 në mjediset e Restorant Pizzeri “K” i cili frekuentohet nga dy aktiviste femra të organizatës sonë, kamarieri pasi kishte shërbyer porosinë i është drejtuar aktivisteve duke i kërkuar që të dilnin nga lokali duke i ofenduar dhe kërcënuar me hapësen e shisheve të verës dhe telekomandën e televizorit, pasi i kishte parë duke u puthur me njëra tjetrën”.
- 1.2 Në zbatim të parashikimeve ligjore, të përcaktuara në nenet 32 dhe 33, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, me shkresën nr. 534/1, datë 08.11.2013 u bë njoftimi i subjektit Restorant Pizzeri “K” duke i kërkuar dhe informacion mbi ngjarjen.
- 1.3 Në datë 11.11.2013, Posta Shqiptare kthen përgjigjen që zarfi është refuzuar të merret në dorëzim nga marrësi.
- 1.4 Më datë 18.12.2013 nxirret Urdhri nr. 103, “Për kryerjen e inspektimit pranë Restorant-Pizzeri “K”. Objekti i këtij inspektimi ishte marrja e informacionit të kërkuar në shkresën nr. 534/1, datë 08.11.2013, takim me kamarierin që ka qenë në detyrë më datë 18.10.2013 nga ora 21⁰⁰ deri në orën 22³⁰, si dhe verifikimi i fakteve të pretenduara nga subjekti ankues.
- 1.5 Më datë 20.12.2013 inspektorët e Drejtorisë së Hetim-Inspektimit u paraqitën pranë subjektit Restorant-Pizzeri “K”, për kryerjen e inspektimit, i cili nuk u realizua për shkak se pronari i lokalit K.N, refuzoi kryerjen e inspektimit dhe dhënien e informacionit.

2. FAKTE TË KONSTATUARA

- 2.1 Mbështetur në nenin 32, pika 1, gerrat “a” dhe “c”, e pika 3 e këtij neni të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ka ndjekur të gjithë hapat që parashikon procedura e hetimit, për të shqyrtuar ankesën nr. 48, datë 24.10.2013 që organizata “Aleanca Kundër Diskriminimit LGBT”, ka paraqitur pranë zyrës së Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi kundër subjektit Restorant-Pizzeri “K”, për diskriminim për shkak të orientimit seksual.
- 2.2 Nga ana e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi janë marrë të gjitha masat që subjekti kundër të cilit është bërë ankesa të vihet në dijeni për ankesën e bërë dhe i janë ofruar mundësitë që të jepte shpjegime dhe informacion mbi pretendimet e ngritura nga subjekti ankues.
- 2.3 Komisioneri konstaton se subjekti ankues me dijeninë e plotë të tij ka refuzuar që të japë shpjegime mbi pretendimet e ngritura duke refuzuar shkresat e dërguara me postë si dhe duke refuzuar realizimin e inspektimit të datës 20.12.2013.

3. BAZA LIGJORE

- 3.1 Neni 1 i ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, përcakton se qëllimi i tij është “*zbatimi dhe respektimi i parimit të barazisë në lidhje me gjininë, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicione gjenetike, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër*”.
- 3.2 Neni 20/1 i ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, përcakton se: “*Personi fizik ose juridik që ofron të mira apo shërbime për publikun, me pagesë ose jo, ndalohet të diskriminojë një person tjetër, i cili kërkon t’i arrijë ose t’i përdorë ato: a. duke refuzuar t’i japë një personi apo grupi personash të mira apo shërbime për shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji; b. duke refuzuar t’i ofrojë një personi të mira apo shërbime në mënyrë të ngjashme, ose me cilësi të ngjashme, ose në kushte të ngjashme me ato në të cilat këto të mira apo shërbime i ofrohen publikut në përgjithësi*”.
- 3.3 Bazuar në ligjin nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, neni 32, pika 2 “*Të gjitha institucionet publike dhe **subjektet private** janë të detyruara të mbështesin Komisionerin në përmbushjen e detyrave të tij, veçanërisht duke i dhënë informacionin që i nevojitet atij*”.
- 3.4 Neni 33/13 i ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi” përcakton se “*Çdo person që shkel dispozitat e këtij ligji dënohet me gjobë ...*”

4. OPINION

- 4.1** Në përfundim të shqyrtimit të ankesës rezulton e provuar se K.N, në cilësinë e pronarit të lokalit Restorant-Pizzeri “K”, ka shkelur nenin 32/2 të ligjit nr. 10221/2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”. Për këtë arsye mbështetur në nenin 32/1, germa “ç”, neni 33, pikat 10, 12, 13/a dhe 14, të Ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi

V E N D O S I :

1. K.N., të gjobitet me gjobë në vlerën 10.000 (dhjetë mijë) lekë.
2. Gjopa të derdhet në Buxhetin e Shtetit brenda datës 26.02.2014.

ÇËSHITJE EX-OFFICIO, E INCIUAR NGA KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI, MBI BAZËN E PUBLIKIMEVE TË BËRA NË MEDIA, MBI ANKESAT E DISA GRAVE TË STREHUARA NË QENDRËN KOMBËTARE TË TRAJTIMIT TË VIKTIMAVE TË DHUNËS NË FAMILJE

VENDIM Nr. 9/2012

Mbështetur në publikimet e bëra në media, lidhur me ankesat e disa grave, të cilat kanë qenë të strehuara në Qendrën Kombëtare të Trajtimit të Viktimave të Dhunës në Familje,

1. PROÇEDURA E NDJEKUR.

- 1.1** Në zbatim të Urdhërit nr. 21, datë 13.04.2012 *“Për fillimin “ex-officio” të çështjes së publikuar në media, lidhur me gratë e dhunuara psikologjikisht pranë Qendrës së Viktimave të Dhunës në Familje”*, si dhe nisur nga shkresa nr. 13/1, datë 23.04.2012, e Qendrës Kombëtare të Trajtimit të Viktimave të Dhunës në Familje, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, me iniciativën e tij, në datat 26.04.2012 dhe 04.05.2012, ka kryer dy inspekte pranë kësaj Qendre.
- 1.2** Përveç, aspekteve pozitive të kushteve të jetesës së përfitueseve dhe fëmijëve të tyre pranë kësaj Qendre, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi konstatoi edhe disa probleme, të cilat janë konstatuar edhe nga institucione të tjera kompetente dhe që janë bërë të ditura nëpërmjet akteve të tyre zyrtare. Për sa më sipër, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi është ndalur vetëm në shqyrtimin e atyre çështjeve, të cilat mbështetur në ligjin nr. 10 221, datë 04.02.2010 *“Për mbrojtjen nga diskriminimi”*, bëjnë pjesë në kompetencat e tij.

2. FAKTE TË KONSTATUARA

- 2.1** Sipas informacionit të marrë nga Znj. D. K., Drejtoreshë pranë Qendrës Kombëtare të Trajtimit të Viktimave të Dhunës në Familje, rezulton se: Kjo qendër është institucion i krijuar në bazë të Urdhërit të Kryeministrit nr.36, datë 23.03.2010, në mbrojtje të grave të dhunuara dhe pa asnjë përkrahje. Gratë dhe fëmijët akomodohen në këtë institucion, të shoqëruar nga Policia e Shtetit, me urdhër mbrojtje ose urdhër të menjëhershëm mbrojtje të lëshuar nga

gjykatat e rretheve gjyqësore.

- 2.2 Në Qendrën Kombëtare të Trajtimit të Viktimave të Dhunës në Familje, gratë janë të lira të lëvizin gjatë ditës dhe fëmijët frekuentojnë shkollën afër Qendrës. Numri i përfitueseve që frekuentojnë aktualisht Qendrën është 6 gra dhe 14 fëmijë. Gjatë inspektimit u vu re se kushtet, në të cilat jetonin banorët e qendrës ishin të mira. Përfitueset dhe fëmijët e tyre jetonin në ambiente komode, me kushte të mira higjienike.
- 2.3 Në bazë të Urdhërit nr. 36, datë 18.03.2011 të Kryeministrit, stafi i Qendrës Kombëtare të Trajtimit të Viktimave të Dhunës përbëhej nga 1 (një) drejtor dhe 2 (dy) sektorë, përkatësisht Sektori i Shërbimit Social – 7 (shtatë) punonjës dhe Sektori i Administratës – 3 (tre) punonjës, pra gjithsej 11 (njëmbëdhjetë) punonjës. Sektori i Shërbimit Social përbëhet nga: 1 (një) përgjegjës sektori (punonjës social), 1 (një) specialist (punonjës social), 1 (një) specialist (mjek), 2 (dy) specialist (edukatorë) dhe 2 (dy) kujdestarë. Sektori i Administratës përbëhet nga : 1 (një) specialist finance, 1 (një) kuzhinier dhe 1 (një) pastrues.
- 2.4 Deri në datën 26.04.2012, organizimi dhe funksionimi i Qendrës Kombëtare të Trajtimit të Viktimave të Dhunës nuk rregullohej ende nga një rregullore e brendshme. Në mungesë të kësaj rregulloreje, mbështetur në Urdhërin nr. 4, datë 08.08.2011, të Drejtorit të Përgjithshëm të Shërbimit Social Shtetëror, Qendra Kombëtare e Trajtimit të Viktimave të Dhunës funksiononte në bazë të Rregullores së Qendrës Pritëse të Viktimave të Trafikimit. Në pikën 1 të Urdhërit të sipërpërmendur ngarkohej Qendra Kombëtare e Trajtimit të Viktimave të Dhunës në Familje të hartonte rregulloren e brendshme të organizimit dhe funksionimit të institucionit me detyrat përkatëse të punonjësve dhe ta paraqiste për miratim pranë Shërbimit Social Shtetëror.
- 2.5 Në inspektimin e kryer në datën 04.05.2012, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi u vu në dijeni për miratimin e Rregullores së Brendshme për Organizimin dhe Funksionimin e Qendrës Kombëtare e Trajtimit të Viktimave të Dhunës në Familje. Megjithatë, pothuajse që nga momenti i krijimit të Qendrës Kombëtare të Trajtimit të Viktimave të Dhunës në Familje, pra për pothuaj 9 muaj, kjo Qendër ka funksionuar në bazë të Rregullores së Qendrës Pritëse të Viktimave të Trafikimit, duke ndikuar në funksionimin e saj në përputhje me qëllimet për të cilat është krijuar.
- 2.6 Përfitueset pohojnë se u lejohej vetëm një telefonatë në muaj me familjarët, e cila survejohej nga persona të ngarkuar nga drejtuesja e institucionit. Fëmijët kanë filluar të shoqërohen në shkollë më makinë, duke filluar nga data 01.03.2012, sepse vetëm në këtë datë, kësaj Qendre i është vënë në dispozicion një automjet nga Shërbimi Social Shtetëror.
- 2.7 Përfitueseve pranë Qendrës Kombëtare të Trajtimit të Viktimave të Dhunës në Familje nuk u ofrohet ndihmë psikologjike nga ana e një psikologu, pavarësisht se ato e kanë jashtëzakonisht të nevojshme një ndihmë të tillë, si pasojë e dhunës fizike dhe asaj psikologjike që është ushtruar mbi to, nga bashkëshortët e tyre. Shërbimet psikologjike janë parashikuar si shërbime shtesë që mund të ofrohen për këtë Qendër, në bazë të Standartit 1, të Vendimit nr. 505, datë 13.07.2011, të Këshillit të Ministrave *“Për miratimin e standarteve të Shërbimeve të Përkujdesit Shoqëror për viktimat e dhunës në familje, në qendrat rezidenciale, publike dhe jopublike”*.
- 2.8 Shumë prej përfitueseve në këtë qendër janë palë në procese gjyqësore për zgjidhje martesë apo për lëshim urdhër mbrojtjeje nga gjykata, ndërkohë që asistenca ligjore nga Qendra mungon, për vetë faktin se në organikën e kësaj qendre nuk parashikohet pozicioni “jurist”. Pavarësisht gjendjes tepër të rëndë ekonomike të tyre, përfitueset paguajnë avokatë, ndërkohë që ekzistenca e juristit të Qendrës mund t’i shmangte këto vështirësi. Sërish vlen të përmendim

faktin se edhe shërbimet juridike janë parashikuar si shërbime shtesë që mund të ofrohen për këtë Qendër, në bazë të Standartit 1, të Vendimit nr. 505, datë 13.07.2011, të Këshillit të Ministrave *“Për miratimin e standarteve të Shërbimeve të Përkujdesit Shoqëror për viktimat e dhunës në familje, në qendrat rezidenciale, publike dhe jopublike”*.

2.9 Gjatë inspektimeve në ambientet e Qendrës Kombëtare të Trajtimit të Viktimave të Dhunës, u vu re se fëmijët e përfitueseve nuk ishin nën kujdesin e dy edukatoreve të kësaj qendre. Këta fëmijë endeshin këmbadorazi ngado nëpër qendër (sidomos nëpër shkallët e kësaj qendre), pavarësisht moshës së tyre të vogël dhe askush nuk u kushtonte vëmendje dhe kujdes atyre. Pyetjes se ku ndodheshin edukatorët (në inspektimin e kryer në datën 26.04.2012), punonjëset e tjera iu përgjigjën se ato nuk ishin paraqitur në punë.

2.10 Në inspektimin e kryer në datën 04.05.2012, Drejtoresha na informoi lidhur me dy edukatorët M.C. dhe L.C., që janë punësuar në bazë të organikës së kësaj qendre. Sipas saj, njëra prej edukatoreve, përkatësisht Znj. L.C nuk ishte punonjëse permanente pranë Qendrës. Edukatorja ishte emëruar në detyrën e specialistit (edukator) pranë kësaj Qendre me Urdhërin nr. 774, datë 16.06.2011, të Drejtorit të Përgjithshëm të Shërbimit Social Shtetëror, por nuk paraqitej në punë, pavarësisht se emri i saj rezultonte në listë-prezenca dhe ajo paguhej rregullisht nga Qendra. Nga informacioni i marrë prej Drejtoreshës së Qendrës, rezultoi se punonjëset sociale, edukatorët dhe kujdestarët punonin në turne prej 16 ose 24 orësh. Në këtë mënyrë, edukatores së vetme që paraqitej në punë, i takonte të vinte në Qendër, 1 herë në 3-4 ditë. Në mungesë të saj, detyrat dhe plani i punës për fëmijët e përfitueseve zbatoheshin nga punonjësit socialë ose kujdestarët.

3. BAZA LIGJORE

3.1 Në nenin 1 të Ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 *“Për mbrojtjen nga diskriminimi”* përcaktohet se: *“Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me gjininë, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzaninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicione gjenetike, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”*.

3.2 Në bazë të nenit 7, të ligjit *“Për mbrojtjen nga diskriminimi”* sjellja diskriminuese mund të konsumohet si me veprim ashtu edhe me mosveprim.

Ligji nr. 7952, datë 21.6.1995 *“Për sistemin arsimor para universitar”*, i ndryshuar; Vendimit nr. 505, datë 13.07.2011, i Këshillit të Ministrave *“Për miratimin e standarteve të Shërbimeve të Përkujdesit Shoqëror për viktimat e dhunës në familje, në qendrat rezidenciale, publike dhe jopublike”*.

Rregullores së Qendrës Kombëtare të Trajtimit të Viktimave të Dhunës në Familje.

VKM nr. 505, datë 13.07.2011, *“Për miratimin e standarteve të Shërbimeve të Përkujdesit Shoqëror për viktimat e dhunës në familje, në qendrat rezidenciale, publike dhe jopublike”*, standarti nr. 3 citon : *“Ofruesi i shërbimeve t'i trajtojë ata me respekt dhe dinjitet. Të jenë të mbrojtur nga të gjitha format e abuzimit apo diskriminimit”*.

Neni 8, pika 8.3, e Rregullores së Qendrës Pritëse të Viktimave të Trafikimit (rregullore mbi bazën e së cilës Qendra Kombëtare të Trajtimit të Viktimave të Dhunës në Familje ka funksionuar për 9 muaj) parashikon se “*Kohëzgjatja ditore normale e punës është 8 (tetë) orë në ditë*”.

4. OPINION

- 4.1 Për sa më sipër, duhet theksuar fakti se përfitueset që banojnë në Qendrën Pritëse të Viktimave të Trafikimit, kanë status të ndryshëm me përfitueset që priten nga Qendra Kombëtare e Trajtimit të Viktimave të Dhunës në Familje, sepse edhe vetë koncepti i trafikimit, është i ndryshëm nga koncepti i dhunës në familje. Por, pasojat në të dyja rastet janë realisht shumë të rënda, si për viktimat e trafikimit, ashtu edhe për viktimat e dhunës në familje.
- 4.2 Sikurse, rezulton nga Rregullorja e Qendrës Pritëse të Viktimave të Trafikimit dhe Rregullorja e re e Qendrës Kombëtare të Trajtimit të Viktimave të Dhunës në Familje (pavarësisht se kanë përmbajtje pothuajse të njëjtë), shërbimet që ofrohen pranë së parës janë më të veçanta. Këtu, përfitueseve u ofrohet asistencë e specializuar psikologjike, asistencë ligjore, si dhe një nivel i lartë sigurie për vetë rrezikshmërinë që paraqet statusi tyre si viktima trafikimi. Ndërkohë, që shërbime të tilla nuk u janë ofruar kurrë viktimave të dhunës në familje, pavarësisht se rregullorja mbi të cilën funksionoi për 9 muaj Qendra Kombëtare e Trajtimit të Viktimave të Dhunës në Familje ishte e njëjtë.
- 4.3 Për sa më sipër, mendojmë se ekzistenca e një niveli të mjaftueshëm sigurie për përfitueset ka qenë i nevojshëm qysh një vit më parë, kur kjo Qendër ka filluar funksionimin e saj, pavarësisht se ky nivel sigurie mund të mos ishte në një nivel aq të lartë sa në Qendrën Pritëse të Viktimave të Trafikimit, meqenëse edhe vetë statuset e përfitueseve të këtyre Qendrave nuk janë të njëjta. **Pranë kësaj qendre, niveli i sigurisë është konsideruar i mjaftueshëm vetëm në kufizimin e telefonatave me familjen dhe “sekuestrimin” e celularëve të përfitueseve për të mos komunikuar me të afërmit, ndërkohë që ato janë të lira të dalin nga institucioni, të punojnë apo të shoqërojnë fëmijët në shkollë. Në gjykimin e Komisionerit, cenimi i së drejtës për të komunikuar me familjet, nuk është efektiv dhe nuk i shërben sigurimit të realizimit të sigurisë për qendrën dhe përfitueset. Ndërkohë që nuk sigurohet shoqërimi i grave dhe fëmijëve jashtë ambienteve të Qendrës.** Mungesa e nivelit të mjaftueshëm të sigurisë bëri të mundur që përfitueses H.B. t’i nxirrej syri nga bashkëshorti i saj, ndërkohë që shoqëronte fëmijët për në shkollë.
- 4.4 **Bazuar edhe në organikën e qendrës të paraqitur më lart, Komisioneri gjykon se mungon stafi i kualifikuar, që të hartojë një draft rregullore të brendshme, në mungesë të një juristi në strukturën organike të saj.**
- 4.5 **Në rregulloren e re të Qendrës Kombëtare të Trajtimit të Viktimave të Dhunës në Familje është parashikuar vetëm asistencë psiko-sociale, ndërkohë që jemi të mendimit që ndihma e një psikologu të mirëfilltë është shumë e nevojshme për to.** Po t’i referohemi sërish Rregullores së re të Qendrës Kombëtare të Trajtimit të Viktimave të Dhunës në Familje vëmë re se në pjesën e dytë “Struktura e QKTVDHF” parashikohet edhe një psikolog dhe jurist (me kohë të pjesshme), të cilët nuk bëjnë pjesë në strukturën dhe organikën e miratuar me Urdhërin nr. 36, datë 18.03.2011 e Kryeministrit. Në këtë kontekst, mendojmë se roli i juristit dhe psikologut në këtë qendër duhet të jetë permanent, për vetë nevojat që kanë përfitueset në këtë qendër.

- 4.6 Pra, referuar Rregullores së Qendrës Pritëse të Viktimave të Trafikimit (rregullore mbi bazën e së cilës Qendra Kombëtare të Trajtimit të Viktimave të Dhunës në Familje ka funksionuar për 9 muaj), orari që duhet të zbatohet punonjësit e Qendrës Pritëse të Viktimave të Trafikimit e rrjedhimisht edhe punonjësit e Qendrës Kombëtare të Trajtimit të Viktimave të Dhunës është 8 (tetë) orë. Në këtë rregullore nuk parashikohet që edukatorët e fëmijëve, punonjëset sociale apo kujdestaret të punojnë në turne prej 16 ose 24 orësh.
- 4.7 **Sikurse vihet re edhe nga faktet e parashtruara më sipër, fëmijët e përfitueseve pranë Qendrës Kombëtare të Trajtimit të Viktimave të Dhunës, janë përjashtuar nga gëzimi i të drejtave të tyre për t'u trajtuar njëjloj si fëmijë të tjerë jashtë kësaj Qendre, për shkak të gjendjes në të cilën ndodhen nënat e tyre. Edhe pse, nëpërmjet strukturës organike të miratuar me Urdhërin nr. 36, datë 18.03.2011, të Kryeministrit, fëmijëve të kësaj qendre u janë dhënë të gjitha mundësitë që të gëzojnë të njëjtat të drejta me fëmijët e tjerë jashtë Qendrës, duke iu vënë në dispozicion të tyre 2 edukatore, këto të fundit nuk janë të disponueshme për ta, dhe rolin e tyre e luajnë shpesh here punonjësja sociale apo kujdestaret.**
- 4.8 Konstatimi i diskriminimit, për shkak të gjendjes ekonomike dhe shoqërore të përfitueseve që banojnë pranë Qendrës Kombëtare të Trajtimit të Viktimave të Dhunës në Familje, nga Drejtoresha e Qendrës, Znj. D. K.
- 4.9 Konstatimi i diskriminimit, për shkak të shoqërimit, të fëmijëve të përfitueseve që banojnë pranë Qendrës Kombëtare të Trajtimit të Viktimave të Dhunës në Familje, nga Drejtoresha e Qendrës, Znj. D. K..

5. REKOMANDIMET

- 5.1 Rekomandojmë marrjen e masave të menjëhershme nga institucionet kompetente, për t'iu siguruar përfitueseve asistencën ligjore, psikologjike dhe nivelin e mjaftueshëm të sigurisë për jetën dhe shëndetin e tyre.
- 5.2 Rekomandojmë marrjen e masave të menjëhershme nga institucionet kompetente, për t'iu siguruar fëmijëve që banojnë në këtë qendër, trajtim të përshtatshëm edukativ dhe përkujdesjen e mjaftueshme me kohë të plotë, nga ana e personave përgjegjës të ngarkuar për të kryer këtë detyrë.

X. OPINIONE TË BORDIT TË EKSPERTËVE

OPINION I BORDIT TË EKSPERTËVE PËR KËRKESËN E GJK NDAJ KMD PËR NJË KOMENT ME SHKRIM LIDHUR ME KËRKESËN E KKPAAK DHE SHOQATËS SË TË VERBËRVE TË SHQIPËRISË ME OBJEKT: “DEKLARIMIN SI TË PAPAJTUESHËM ME KUSHTETUTËN, KONVENTËN E OKB PËR TË DREJTAT E PERSONAVE ME AFTËSI TË KUFIZUARA, KEDNJ DHE KARTËN SOCIALE EUROPIANE I PIKAVE 7 DHE 9 TË NENIT 3 TË LIGJIT NR. 10221/04.02.2010 “PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI”

I. KONSIDERATA TË PËRGJITHSHME

Diskriminimi për çfarëdo shkak/qëllimi nga kushdo e për këdo është cenim i të drejtave dhe lirive themelore të njeriut. Janë të pamohueshme hapat e bërë në kuadrin ligjor shqiptar lidhur me mbrojtjen nga diskriminimi dhe standardet e barazisë gjinore. Pa dyshim, mosdiskriminimi ka procesin e tij të absorbimit dhe precipitimit nga individët, shoqëria, institucionet shtetërore dhe sistemi i drejtësisë. Që standardet e përcaktuara në ligj të bëhen realisht të aplikueshme kërkohet dedikim gjithëpërfshirës.

Përvoja ndërkombëtare na tregon vështirësitë dhe barrierat shumë dimensionale që hasen në procesin e konsolidimit të këtyre standardeve. Në gjykatat e vendeve anëtare të BE janë paraqitur dhe vazhdojnë të paraqiten në rritje, pretendime mbi diskriminimin³². Shpesh herë, këto gjykata i kërkojnë GJED, interpretime të dispozitave të legjislacionit të tyre dhe koherencën me standardet e BE³³ për shkak të thellësisë, delikatesës dhe rreziqeve të reja që i shfaqen parimeve të mosdiskriminimit. Gjithashtu, jurisprudenca e GJEDNJ, ka njohur zhvillime të vrullshme kohët e fundit lidhur me implikime të drejtpërdrejta që lidhen me nenin 14 të KEDNJ.

Përvoja ligjore dhe praktike, kryesisht jurisprudenca e gjykatave të sipërpërmendura, evidenton dinamikën e konceptimeve mbi diskriminimin dhe dinamikën e përpjekjeve për mosdiskriminimin si dhe ndërgjegjësimin e mbarë shoqërisë dhe individëve.

³³ Shih: *Chacon Navas v Eurest Colectividades SA* (C-13/05) [2006]; *C-335/11 & C-337/11, HK Danmark v. Dansk almennyttigt Boligselskab* (11 Prill, 2013).

Kjo do të thotë, që edhe termat e referencës [përkufizimet] e një ligji, duhet të trajtohen në harmoni dhe koherencë me zhvillimet sociale, ekonomike, teknologjike³⁴, etj të cilat ndryshojnë nga njëra kohë në tjetrën e nga njëri vend në tjetrin. Kjo bën që edhe trajtimet rast pas rasti të përshtatshmërisë së arsyeshme dhe barrës së tepruar të shihen përmes një procesi analize dhe sinteze konkrete të rastit në shqyrtim dhe në disa dimensione. Për me tepër kuptimi i azhurnimit të tyre me situatat faktike bëhet përmes një ushtrimi që quhet “rast pas rasti”. Kjo bën që zgjidhjet e ofruara në një rast, ose formulat statike për zgjidhjen e çështjeve të deritanishme të mos kenë të njëjtën vlerë për një rast tjetër ose në një kohë tjetër apo për një shërbim. Herë të tjera, ka disa variante të përshtatjes ku njëri shkakton barrë të tepërt dhe një tjetër jo. Kjo e bën procesin e vlerësimit një sfidë. Kjo bën që termat ndërsa mbartin vlerën e parimeve që mishërohen në to, duhet të vlerësohen nën efektin dhe mundësinë më të mirë që japin në një rast konkret.

Për vendin tonë, një hap përpara përbën ratifikimi i instrumenteve ndërkombëtare, përfshi këtu edhe Konventën e OKB për të drejtat e personave me aftësi të kufizuara [në vijim konventa]. Por jo vetëm kaq. Ka kohë që klauzola anti-diskriminim gjendet thuajse në çdo akt ligjor të miratuar nga Kuvendi sikurse në gjithë instrumentet ndërkombëtar me fokus të drejtat e njeriut në fusha të ndryshme. Në çështjet e bashkuara C-335/11 & C-337/11, *HK Danmark v. Dansk almennyttigt Boligselskab* GJED bën analizën e Direktivës 2000/78 të Trajtimit të Barabartë nisur nga Konventa e OKB. Pra, duke na dhënë shembullin e vet, GJED, për të interpretuar Direktivën e BE përdor Konventën e OKB. Konventa e OKB përmban definicione lehtësisht të ndryshme sa i përket “paaftësisë” dhe “përshtatjes së arsyeshme” kundrejt Direktivës. Ky vendim dhe mesazh njëkohësisht lidhur me standardin e parimeve dhe të vlerave në një evolucion pozitiv, dhënë nga GJED, pa dyshim do të sjellë impakt në gjykatat e vendeve respektive të BE kur këto do të duhet të zbatojnë dispozitat e Direktivës së barazisë. Nga ana tjetër, për institucionet dhe gjykatat shqiptare, është tregues i dinamikës dhe evolucionit të perceptimeve lidhur me diskriminimin dhe i kuptimit më të drejtë të termave e parimeve.

Ligji shqiptar për mbrojtjen nga diskriminimi, është hartuar në përqasje me direktivat e ‘barazisë’ të BE³⁵

34 GJED në rastin e sipërpërmendur C-335/11 & C-337/11 zgjeron kuptimin e termit “paaftësi” kundrejt Direktivës për Trajtim të Barabartë 2000/78/EC si dhe të kuptimit të “përshtatjes së arsyeshme”. Për këtë, GJED është mbështetur në Konventën e OKB për të drejtat e personave me aftësi të kufizuara e cila është e detyrueshme për të.

35 Përafshuar plotësisht me:

1. Direktivën e Këshillit 2004/43/KE të 29 qershorit 2000 për “Zbatimin e parimit të trajtimit të barabartë ndërmjet personave pavarësisht prejardhjes racore apo etnike”;
2. Direktivën e Këshillit 2000/78/KE të 27 nëntorit 2000 për “Përcaktimin e një kuadri të përgjithshëm për trajtimin e barabartë në punësim dhe marrëdhëniet gjatë punës”;
3. Direktivën e Këshillit 2004/113/KE të 13 dhjetorit 2004 për “Zbatimin e parimit të trajtimit të barabartë ndërmjet burrave dhe grave në mundësinë për të pasur dhe për t’u furnizuar me mallra dhe shërbime”;
4. Direktivën e Parlamentit Europian dhe të Këshillit 2006/54/KE të 5 korrikut 2006 për “Zbatimin e parimit të mundësive të barabarta dhe të trajtimit të barabartë të burrave dhe grave në çështjet e punësimit dhe marrëdhëniet gjatë punës”.

Ligji daton përpara ratifikimit të Konventës së OKB. Ndaj, siç tregon jurisprudenca e përmendur e GJED, është shumë e rëndësishme që sikurse direktivat përkatëse, edhe ligji shqiptar, të interpretohet dhe kuptohet nën dritën e Konventës.

2. KËRKESA PËR OPINION PARAQITUR KMD NGA GJYKATA KUSHTETUESE

Më 16.04.2013, Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, i është kërkuar nga ana e GJK, një koment me shkrim lidhur me argumentet e mundshme kundrejt kërkesës së KKPAAK dhe Shoqatës së të Verbërve të Shqipërisë me objekt: “Deklarimin si të papajtueshëm me Kushtetutën, Konventën e OKB Për të drejtat e personave me aftësi të kufizuara, KEDNJ dhe Kartën Sociale Europiane i pikave 7 dhe 9 të nenit 3 të Ligjit nr. 10221/04.02.2010 “Për mbrojtjen nga Diskriminimi”.

Përmbajta konkrete e dispozitave të atakueshme për antikushtetueshmëri

Neni 3/7. “*Mohim i një përshtatjeje të arsyeshme*” është ajo formë diskriminimi që ndodh kurdoherë kur ka një mohim ose kundërshtim për të kryer ndryshime ose rregullime të domosdoshme e të përshtatshme *që nevojiten në një rast të veçantë* dhe nuk imponojnë një barrë të tepruar, me qëllim që të sigurohet gëzimi dhe ushtrimi në baza të barabarta i të drejtave dhe lirive themelore për personat me aftësi të kufizuara, ose të ndodhur në kushtet e tjera të përmendura në nenin 1 të këtij ligji.

Termet/shprehja e konsideruar si diskriminuese: organizata që kanë si objekt të deklaruar të veprimtarisë mbrojtjen e të drejtave të njeriut.

Neni 3/9. “*Organizatat me interesa legjitime*” janë ato organizata, të cilat janë të regjistruara në Republikën e Shqipërisë dhe kanë si objekt të deklaruar të veprimtarisë së tyre mbrojtjen e të drejtave të njeriut, ose u ofrojnë ndihmë viktimave të diskriminimit.

3. TRAJTIMI I PRETENDIMIT NË KËNDVËSHTRIMIN E TEKNIKËS LEGJISLATIVE

Qëllimi i Ligjit për mbrojtjen nga Diskriminimi, siç përcaktohet në mënyrë eksplicite në nenin 2 të tij, “*është të sigurojë të drejtën e çdo personi për: ... b) barazi të shanseve dhe mundësive për të ushtruar të drejtat, për të gëzuar liritë dhe për të marrë pjesë në jetën publike...*”. Në këtë aspekt edhe në dispozitat që përshkojnë ligjin në fjalë dhe detyrimet e

institucioneve garante të parimit të barazisë, është, ndër të tjera, jo vetëm ndalimi i diskriminimit por edhe marrja e masave pozitive (ose nxitja e institucioneve kompetente për marrjen e këtyre masave) me synimin e përshejtit të vendosjes reale të barazisë.

Në lidhje me këtë dëshirojmë të nënvizojmë një aspekt të rëndësishëm që ka të bëjë me interpretimin literal të fjalës “përkufizim” dhe të kuptimit që ai ka edhe në doktrinën juridike të teknikës legjislative. Duhet theksuar se pjesa e përkufizimeve në tekstet normative, sipas manualëve të teknikës legjislative, për secilin nocion të listuar tek “përkufizimet” jep kuptimin përkatës se si duhet marrë apo kuptuar çdo herë që përdoret në dispozitat e ligjit në analizë³⁶

Qëllimi i nenit 3 në tërësi është dhënia e kuptimit në të cilin duhen marrë termat e dhëna për qëllimet e interpretimit të dispozitave të ligjit nr. 10221 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”. Dispozitat e përkufizimeve përgjithësisht kanë karakter deklarativ dhe nuk vendosin detyrime për subjektet të cilëve u drejtohen. Në këtë aspekt të analizës edhe pikat 7 e 9 të nenit 3 të ligjit “Për mbrojtjen nga diskriminimi” nuk u imponojnë subjekteve detyrim për sjellje të caktuar, por orientojnë për kuptimin që kanë togfjalëshat “mohim i një përshtatjeje të arsyeshme” dhe “organizatat me interesat legjitime” nëpër dispozitat vijuese të këtij ligji dhe nuk japin përkufizimin p.sh. të OJF-ve në çdo tekst tjetër ligjor por vetëm tek ky ligj.

Përsa i përket pretendimeve konkrete të subjektit kërkues, lidhur me terminologjinë e përdorur dhe kuptimet e dhëna në përmbajtje të pikave 7 e 9 të nenit 3, vërejmë se:

Shprehja e përdorur në pikën 7 “*nuk imponojnë një barrë të tepruar*” prezumon në radhë të pare, “barrën” që i vendoset subjekteve publike dhe private në kuadër të detyrimit të tyre për marrjen e masave pozitive për subjektet që nuk janë në kushtet e barazisë. Qëllimi i ligjvënësit tek pika 7 e nenit 3 i referohet “tepricës”, meqenëse “barra” është e nënkuptuar. Gjithashtu, mendojmë edhe termi “barrë” nuk ka konotacion fyes dhe nuk i duhet bërë referim gjuhës apo terminologjisë që përdorim në zhargonin e përditshëm, por duhet parë në kontekstin e terminologjisë juridike të rastit, në kuadër të së cilës për shembull, edhe termi “diskriminim pozitiv” nuk i referohet “diskriminimit” si nocion negativ.

Përkufizimi i dhënë në pikën 9 të nenit 3 ka konotacion të përgjithshëm dhe nuk i referohet kategorive të veçanta apo specifike të OJF-ve; gjithashtu nuk vendos detyrimin për t’u mbrojtur në një proces ligjor me organizatat e përcaktuara në përkufizimin përkatës dhe as kufizon mundësinë e përfaqësimit direkt. Në kërkesën drejtuar Gjykatës Kushtetuese pretendohet e drejta ekskluzive e përfaqësimit të PAK vetëm nga organizatat e veta (shih paragrafi i fundit në fq.9 të kërkesës përkatëse), ndërkohë që edhe Konventa përkatëse e OKB-së lejon përfaqësimin nga organizatat e veta, duke lënë mundësinë e lirë të zgjedhjes për përfaqësuesin apo mbrojtësin, por nuk vendos detyrim për përfaqësim ekskluziv.

³⁶ Shih: <http://WWW.regione.puglia.it/index.php?page=prg&opz=display&id=1205> ; Direttive di tecnica legislativa (DTL), Edizione 2003 aggiornata, Edite dalla Cancelleria federale svizzera, fq.19.

4. TERMAT E PËRDORURA NGA KONVENTA E OKB

Si gjenden termat në Konventën e OKB (ratifikuar me ligjin Nr. 108/2012) në variantin shqip dhe anglisht?

Versioni shqip i Konventës përdor shprehjen “*barrë disproporcionale*”. Versioni anglisht për këtë institut përmban shprehjen “*disproportionate or undue burden*” që sipas fjalorit përkthehet në “barrë disproporcionale ose e tepërt”.

Barra disproporcionale/ “*disproportionate or undue burden*” nuk gjen një përkufizim të veçantë në Konventë. Ky institut gjendet brenda përkufizimit dhënë për “*akomodim i arsyeshëm*”. Në tekstin e Konventës “*undue burden*” përdoret vetëm një herë përkatësisht në nenin 2 ku renditen gjithë përkufizimet.

“*Reasonable accommodation*”/ “*akomodim i arsyeshëm*” gjendet e përdorur përkatësisht në nenet 5 paragrafi 3; neni 14 paragrafi 2; neni 24 paragrafi 2/c dhe neni 24 paragrafi 5 lidhur me fushën e arsimit; neni 27 paragrafi 1/i lidhur me punësimin. Konkretisht përmbajtja në shqip dhe anglisht e përkufizimit dhënë në nenin 2 është:

Versioni shqip: “*Akomodim i arsyeshëm*” do të thotë modifikim dhe rregullim i nevojshëm dhe i përshtatshëm që nuk krijojnë një barrë disproporcionale, që është i nevojshëm në raste të veçanta, për t’u siguruar personave me aftësi të kufizuara gëzimin dhe ushtrimin e të gjitha të drejtave dhe lirive themelore të njeriut me baza të barabarta me të tjerët (neni 2).

Versioni anglisht: “*Reasonable accommodation*” means necessary and appropriate modification and adjustments not imposing a disproportionate or undue burden, where needed in a particular case, to ensure to persons with disabilities the enjoyment or exercise on an equal basis with others of all human rights and fundamental freedoms”.

5. TERMAT E PËRDORUR NË LIGJIN “PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI”

Është në objektin e ligjit “*Për mbrojtjen nga diskriminimi*” (në vijim LMD) zbatimi dhe respektimi i parimit të barazisë në lidhje me aftësinë e kufizuar (neni 1). Ligji është i përafëruar plotësisht me direktivat e BE në këtë fushë.

Sipas nenit 5 pika 2 të LMD: “*Mohimi i modifikimeve dhe përshtatjeve të duhura e të nevojshme për personat me aftësi të kufizuara përbën diskriminim*”. Lidhur me termin “*përshtatje*”, LMD përdor termat: “*përshtatje e arsyeshme*” (neni 3&7); “*përshtatje të duhura dhe të nevojshme*” (neni 5&2); “*përshtatje të nevojshme dhe të duhura*” (neni 20&3).

Nuk ka një përkufizim më vete në LMD lidhur me “*barrë e tepruar*”. “*Barrë e tepruar*” gjendet brenda kontekstit të përkufizimit dhënë për “*Mohim i një përshtatjeje të arsyeshme*” përkatësisht në nenin 3 & 7 të ligjit.

Lidhur me termin “*barrë*” dhe etiketimet përkatëse, LMD përdor shprehjet: “*barrë e tepruar*” (neni 3 & 7); “*barrë të shpërpjesëtuar ose të paligjshme*” (neni 20 & 3).

6. Konkluzione mbi koherencën/krahasimin e termave

Tabela e termave na lehtëson për të analizuar dhe krahasuar termat e ligjit kundrejt Konventës.

Termet sipas neneve përkatëse	Konventa	OKB	Ligji për mbrojtjen nga diskriminimi
	Anglisht	Shqip	
“Barrë”	“disproportionate or undue burden” [neni 2]	“barrë disproporcionale”	“barrë e tepruar” [neni 3 &7]; “barrë të shpërpjesëtuar ose të paligjshme” [neni 20 &3];
“Përshtatje”	Reasonable accommodation”	“akomodim/përshtatje e arsyeshme”	“përshtatje e arsyeshme” [neni 3&7]; “përshtatje të duhura dhe të nevojshme”[neni 5&2]; “përshtatje të nevojshme dhe të duhura” [neni 20&3],

Nga pasqyra mësipërme e termave mund të konkludojmë se “barrë e tepruar” është përkthimi në shqip i “undue burden”, përdorur nga Konventa. Një nga problemet që hasin juristët në punën me instrumentet ndërkombëtare është përkthimi jo plotësisht i saktë i tyre.

7. PËRFUNDIME DHE/ OSE REKOMANDIME

1. Mungesa e akteve nënligjore dhe udhëzimeve

Rekomandohet: nxjerrja e akteve nënligjore dhe udhëzuesve mbi indikatorë a tregues që ndihmojnë në përcaktimin përshtatjes së arsyeshme dhe barrës së tepruar.

Përgatitja e udhëzuesve praktikë me shembuj nga fusha të ndryshme dhe kuptimin që ka psh: barrë e tepruar; barrë e shpërpjesëtuar ose e paligjshme në harmoni me Konventën dhe ligjin shqiptar.

2. Nga leximi në tërësi i Ligjit, konstatojmë se:

- “Mohim i një përshtatjeje të arsyeshme” e për rrjedhojë edhe “**barra e tepruar**” nuk është përdorur vetëm për aftësinë e kufizuar por për të gjithë kategorinë e mbrojtur nga neni 1 i Ligjit (shih neni 3)
- analiza qoftë edhe e një rasti të veçantë, përfshin kujdes prioritar dhe është në harmoni me jurisprudencën e GJEDNJ lidhur me situatat që kur kufizimi është i pashmangshëm, ky grupim të jetë i fundit që do të preket.
- ligji ka një sistem ankimi administrativ dhe gjyqësor që mbron personat e diskriminuar nga veprimet arbitrare apo justifikimet që çojnë në mohimin e përshtatjes së arsyeshme.

REKOMANDOHET:

- Përpunimi dhe detajimi i strukturave të ankimit në aspektin administrativ dhe ndërgjegjësimi i të gjithë aktorëve të përfshirë në këtë provë.
- Krijimi i një këshilli apo bordi vlerësues lidhur me mundësitë dhe alternativat rast pas rasti të “*përshtatjes së arsyeshme*” dhe analizën rast pas rasti nëse kemi situata të një pretendimit që çon në “*barrë të tepruar*”.

3. ROLI I AUTORITETEVE DHE SISTEMIT GJYQËSOR

Interpretimi i “përshtatjes së arsyeshme” mbetet një çështje që jo vetëm duhet të trajtohet rast pas rasti, individualisht, por edhe që mund të shoqërohet me shumë paqartësi. Ndaj mbetet i veçantë roli dhe kontributi i gjykatës në zhvillimin e kësaj praktike nëse vendoset në rastet e shqyrtuara ndonjë barë disproporcionale për punëdhënësin.

Për një kuptim sa më të plotë të termave “*barrë e tepruar*” dhe “*përshtatje e arsyeshme*” duhet të drejtohem nga doktrina dhe praktika gjyqësore. Për këtë një vend të veçantë zë jurisprudenca e GJEDNJ³⁷ dhe GJED³⁸.

Sipas dokumenteve të konsultuara³⁹, përshtatja e arsyeshme është një *listë e pafund* mundësish me qëllim që të sigurohet gëzimi dhe ushtrimi në baza të barabarta i të drejtave dhe lirive themelore për personat me aftësi të kufizuar, ose të ndodhur në kushtet e tjera të përmendura në nenin 1 të Ligjit. Kjo listë varion rast pas rasti përderisa kjo përshtatje është ose gjendet se është adekuate për një rast të veçantë.

³⁷ Z.H. kundër . Hungarisë; Jasinskis kundër Latvisë; Eweida dhe të tjerë kundër Mbretërisë së Bashkuar; R.P dhe të tjerë kundër MB.

³⁸ Chacon Navas v Eures Colectividades SA (C-13/05)³ (2006); HK Danmark v. Dansk almennyttigt Boligselskab C-335/11&C-337/11, (11 Prill, 2013); Case C411/05 Palacios de la Villa (2007).

³⁹ <http://www.eeoc.gov/policy/docs/accommodation.html>; <http://ëëë.eeoc.gov/policy/docs/accommodation.html#requesting>

Pra, analiza e “*përshtatje e arsyeshme*” kërkon që çdo kërkesë për përshtatje të arsyeshme duhet të trajtohet në mënyrë individuale. Kjo do të thotë që institucioni që efektohet bën vlerësimin nëse ka mundësi të bëjë përshtatjen për këtë rast. Në këtë mënyrë, përshtatja e arsyeshme vendoset përballë pyetjes nëse kjo përbën “barrë të tepruar”

Bazuar në gjithë sa argumentohet përmbledhtas më sipër, shprehim mendimin tonë që pikat 7 e 9 të nenit 3 të Ligjit “*Për mbrojtjen nga diskriminimi*” nuk kanë karakter diskriminues dhe as janë të papajtueshme me Kushtetutën.

**OPINION I BORDIT TË EKSPERTËVE PËR TRAJTIMIN E ANKESËS SË SHTETASES A.Ç, KUNDËR
CEZ SHPËRNDARJE SH.A NË TË CILËN PRETENDOHEJ DISKRIMINIM PËR SHKAK TË GJINISË,
SHTATZËNISË, GJENDJES MARTESORE DHE GJENDJES CIVILE**

VIII. KONSIDERATA TË PËRGJITHSHME

Të drejtat nuk janë të izoluara. Ato herë kanë lidhje direkte herë periferike me njëra tjetrën dhe kështu ndikojnë në cilësinë e gëzimit të njëra tjetrës. I tillë është raporti midis të drejtës për shërbime dhe gëzimit të së drejtës për strehim adekuat. Nëse ka diskriminim në shërbime që lidhen me banesën atëherë automatikisht është cënuar e drejta e banimit. Banesa bëhet e pabanueshme dhe e papërshtatshme.

Çështjet që lidhen me diskriminimin në të mira dhe në shërbime duket se qëndrojnë jo evidente edhe në praktikën ndërkombëtare. Përgjithësisht ka një mungesë të ndërgjegjësimit dhe të statistikave lidhur me to. Për më tepër në lidhje me të mirat dhe shërbimet me sektorin publik ka një tendencë, prej juristëve, që të marrin në konsideratë më shumë mjetet juridike mbrojtëse në të drejtën publike sa ti konsiderojnë ato si çështje që kanë të bëjnë me legjislacionin anti diskriminim.

Në shumë raste, konsumatorët nuk e perceptojnë si një gjë të gabuar dhe që ka të bëjë me trajtimin e ndryshëm mes burrave dhe grave por kanë tendencë të shohin këtë si një shembull të shërbimit të dobët në vend të diskriminimit të padrejtë. Si pasojë, në të ardhmen, mund të ndodhë që ata, konsumatorët, do të tentojnë thjesht të vendosin marrëdhënie me një shërbim tjetër që ofron të njëjtin produkt dhe jo të kërkojnë mbrojtje ligjore të duhur në kontekstin e antidiskriminimit. *Kështu ka rrezik që diskriminimi të instalohet më fortë.*

Numri i ulët i rasteve do të thotë se *ka shumë pak raste të raportuara* diskriminimi midis burrave e grave në të mira dhe shërbime⁴⁰.

⁴⁰ Në jurisprudencën e GJED nënvizojmë rastin C-236/09 Association belge des Consommateurs Test-Achats ASBL and Others kundër Conseil des ministres.

Kështu në jurisprudencën e Mbretërisë së Bashkuar rasti më i njohur është James v Eastleigh Borough Council i cili lidhet me autoritetet lokale që ofrojnë tarifën koncesionare për pishina në bazë të moshës së pensionit. Rasti tjetër është Fill v Le Çino që ka të bëjë me refuzimin për tu shërbyer grave në një bar nëse ato nuk uleshin në tavolina por qëndronin në banak.

E drejta për strehim dhe për të pasur një banesë të përshtatshme hyn tek të drejtat themelore për një standard adekuat dhe njerëzor jetese. “E drejta e njeriut për strehim të përshtatshëm... ka një rëndësi shumë të madhe për të gëzuar të gjitha të drejtat ekonomike, sociale dhe kulturore”⁴¹. Shtëpia është vendi që kushdo duhet të ndihet i/e sigurt, i/e mbrojtur dhe komod.

Strehimi adekuat nënkupton të përfshirë edhe furnizimin me energji elektrike dhe ujë të pijshëm⁴². Këto janë shërbime jetike. Pra e drejta e banimit dhe strehimit nuk mund të kuptohet e veçuar nga furnizimi me ujë dhe energji. Këto konsiderohen si standarde bazike të domosdoshme për të gëzuar një jetesë njerëzore normale. Nuk mund të flitet për këto shërbime si aksesore të sendit kryesor, banesës si të tillë. Kufizimi apo heqja e tyre automatikisht çënon të drejtën e banimit apo të strehimit adekuat duke e bërë shtëpinë “de facto” të pabanueshme. Në një farë mënyrë privimi nga shërbime të tilla bazike është një lloj detyrimi për nxjerrjen e banorëve jashtë banesës duke përdorur jo shtrëngimin dhe forcën direkte por atë indirekte. Në rastin konkret edhe duke përdorur “klauzolat e kontratave tip”. Është detyrë e autoriteteve publike për të siguruar që strehimi të jetë adekuat. Këtu përfshihen masat e ndryshme të tilla si mos kufizimi dhe mosndërprerja e shërbimeve esenciale të tilla si ujë, energji elektrike dhe shërbimi telefonik.

Kur një martesë mbaron me zgjidhje, vijnë dhe renditen një sërë pasojash personale dhe pasurore mbi ishbashkëshortët. Studime të ndryshme pasqyrojnë se pasojat ekonomike/pasurore të zgjidhjes së martesës variojnë, janë të ndryshme, në varësi të gjinisë. Pasojat ekonomike, sociale, të strehimit, punësimi, etj të një gruaje janë të ndryshme kundrejt ato të një burri. Të ndryshme do të thotë në këtë kontekst, të përqësuar. Ndërkohë duhet nënvizuar se, duhen bërë të gjitha përpjekjet ligjore dhe jo vetëm, që ndryshimi i statusit marital të mos deformat disa të drejta të cilat pavarësisht zgjidhjes së martesës duhet të garantohen plotësisht sepse kanë të bëjnë me thelbin e lirive dhe të drejtave themelore të njeriut. Ndër to edhe e drejta e strehimit e drejta për furnizimin me ujë dhe energji elektrike.

Pra, ndryshimi në statusin marital të bashkëshortëve nuk mund të çënojë të drejtën për strehim adekuat dhe për rrjedhojë të lidhur ngushtësisht me të edhe furnizimi me ujë dhe energji elektrike. Pikërisht nisur nga rëndësia që ka kjo e drejtë Kodi i Familjes në disa dispozita i ka kushtuar vëmendje dhe mbrojtje të veçantë banesës familjare, pavarësisht se në pronësi të kujt është, duke e trajtuar këtë herë në funksion të interesit të fëmijëve, herë në interes të bashkëshortit që ka instaluar aty pajisje me vlerë për ushtrimin e profesionit e herë në varësi të llojit të zgjidhjes së martesës, siç është rasti i ndërprerjes së jetës së përbashkët⁴³.

Ligje të tjera trajtojnë në mënyrë pozitive kategori të caktuara kundrejt të drejtës për strehim, përfshi këtu gratë që kanë zgjidhur martesë e që janë kryefamiljare⁴⁴.

⁴¹ Komiteti i OKB-së për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore, Koment i Përgjithshëm 4.

⁴² Lidhur me të drejtën për strehim të përshtatshëm dhe gjendjen në nivelin e OKB shih: **UN SPECIAL RAPPORTEUR HOUSING REPORT 2012 - WOMEN & ADEQUATE HOUSING** në http://www.ohchr.org/Documents/HRBodies/HRCouncil/RegularSession/Session19/A-HRC-19-53_en.pdf

⁴³ Shih nenin 153 KF 2003 Neni 153

⁴⁴ Ligji nr.9232/13.5.2004 “Për programet sociale të strehimit të banorëve të zonave urbane”, ndryshuar së fundmi edhe me ligjin 54/2012 dhe që i referohet jo vetëm zonave urbane por të gjithë territorit të Shqipërisë, ka për qëllim krijimin e mundësive për strehim të përshtatshëm dhe të përbalueshëm, duke u mbështetur në aftësitë paguese të familjeve që kanë nevojë për strehim dhe për ndihmën e shtetit.

Strehimi adekuat mbetet një çështje problematike në rastet e grave pa mjete ekonomike, atyre të papuna, grave që kanë zgjidhur martesën dhe të dhunuara si dhe të kategorive të tjera vulnerabël si jetimë, etj⁴⁵.

IX. Rrethanat e çështjes së paraqitur përpara KMD

Rasti, në emër të shtetas A.Ç. i është bërë prezent KMD, përmes një kërkesë të paraqitur nga QNLQ, një organizatë jo fitimprurëse aktive në çështjet e mbrojtjes së të drejtave të grave nga dhuna e diskriminimi.

Shtetasja A.Ç., me gjendje civile e divorcuar⁴⁶ prej 20.05.2011, aktualisht shtatzënë dhe nënë e dy fëmijëve lënë asaj për kujdes me vendim gjyqësor, fëmijë që vijnë nga martesa e mëparshme, raporton se ka ndërprerje të herëpashershme të shërbimit të furnizimit me ujë dhe energji elektrike duke filluar nga data 15 mars 2013. Shtetasja A.Ç. ka jetuar vazhdimisht në banesën familjare dhe nuk është larguar asnjë herë prej saj. Nga viti 2007 ish-bashkëshorti është larguar nga banesa dhe zgjidhja e martesës është bërë në vitin 2011. Kërkesat e përsëritura të shtetas A.Ç. për furnizimin me ujë dhe energji elektrike duket se nuk gjejnë përgjigje pozitive ose nuk kanë gjetur përgjigje në kohë duke e kthyer banesën në një vend të papërshtatshëm për funksione banimi.

Kërkuesja ka pretenduar trajtim diskriminues nga ana e CEZ Shpërndarje SH.A Tiranë, dhe Ndërmarrja e Ujësjellës Kanalizimeve, Tiranë në lidhje me ndërprerjen e furnizimit me energji dhe ujë, pas kërkesës së bërë këtyre dy subjekteve nga ana e ish bashkëshortit, i cili është lidhës i kontratave me ta në cilësinë “klient familjar”. CEZ Shpërndarje sh.a dhe Ndërmarrja e Ujësjellës – Kanalizime me marrjen e kësaj kërkesë për pezullim furnizimi me ujë dhe energji ka ndërprerë automatikisht shërbimin. Pjestimi i pasurisë bashkëshortore, raportohet të jetë ende në proces gjyqësor, ndërkohë që kërkesa e ish bashkëshortes për lidhje të kontratave për furnizimin me energji dhe ujë në emër të saj është refuzuar nga subjekti.

Pra, në ndihmë të këtyre çështjeve duket se vijnë dhe shërbejnë edhe klauzolat ligjore apo nënligjore ose praktikatat e krijuara nga institucionet që ofrojnë shërbime përmes kontratave tip, të cilat herë pas here nuk i përgjigjen në mënyrë adekuate çështjeve të ndryshme, situatave të reja dhe dimensioneve e dinamikës së mbrojtjes së familjes, grave e fëmijëve, siç është rasti i sipërpërmendur.

⁴⁵ Shih raportin e Amnesty International [AI] të vitit 2012, pjesën për Shqipërinë lidhur me të drejtën për strehim [fq 60 e raportit] <http://www.amnesty.org/en/region/albania/report-2012#section-2-10>

⁴⁶ Vendimi nr 4184/ 20.05.2011 i Gj.Rr.Gj Tiranë.

X. Kuadri ligjor në fuqi

Kushtetuta, e cila garanton mbrojtje të veçantë për familjen, fëmijët dhe gratë shtatzëna [neni 53 dhe 54] dhe sanksionon parimin e mosdiskriminimit [neni 18]

Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut në nenin 25 e përfshin të drejtën për strehim si pjesë të së drejtës për një standard adekuat jetese⁴⁷;

Konventa e OKB për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore në nenin 11 (1) garanton të drejtën për strehim gjithashtu si pjesë e të drejtës për një standard adekuat jetese, ndërsa në nenin 12 çështje të standardeve lidhur me shëndetin. Kundrejt të drejtës për ujë vend ka edhe komenti i përgjithshëm nr.15 i kësaj Konvente.

Konventa e OKB për të Drejtat e Fëmijës [CRC] në nenin 24/2/c parashikon sigurimin e ujit të pijshëm në kuadër të kujdesit për shëndetin.

Konventa e OKB për eliminimin e diskriminimit ndaj grave **CEDAW**:

- **në nenin 2** parashikon detyrimin e shteteve palë për shmangien e praktikave diskriminuese dhe marrjen e masave për eliminimin e sjelljeve diskriminuese dhe shfuqizimin e legjislacionit diskriminues (përfshirë edhe rregulloret, zakonet dhe praktikat);
